



PROGRAMI I STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026



PROGRAMI I STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026



PROGRAMI I STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026

Drejtor botimi: Dr. Elsa Dhuli

© Copyright INSTAT 2022

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi
i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me
shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

LIGJ
NR. 30/2022

PËR MIRATIMIN E

PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,
me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet programi i statistikave zyrtare 2022–2026 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe
është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 24.3.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13556, datë 13.4.2022,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.**

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE

HYRJE

- I. Sfidat dhe risitë e Programit
- II. Objektivat zhvillimore të Sistemit Kombëtar Statistikor
- III. Përshkrimi i aktiviteteve 2022-2026

1. STATISTIKAT SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE

- 1.1 Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj
- 1.2 Puna dhe Kostot e Punës
- 1.3 Arsimi dhe trajnimet
- 1.4 Shëndetësia
- 1.5 Të ardhurat dhe shpenzimet e konsumit
- 1.6 Mbrojtja sociale
- 1.7 Drejtësia dhe krimi
- 1.8 Kultura

2. STATISTIKAT EKONOMIKE

- 2.1 Statistikat Makroekonomike
- 2.2 Statistikat Financiare të Qeverisë, Fiskale dhe të Sektorit Publik
- 2.3. Statistikat e Biznesit

3. STATISTIKAT SEKTORIALE

- 3.1 Bujqësia Pyjet dhe Peshkimi
- 3.2 Energjia
- 3.3 Transporti
- 3.4 Turizmi
- 3.5 Tregtia e jashtme
- 3.6 Bilanci i Pagesave
- 3.7. Çmimet⁶⁷
- 3.8. Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni

4. STATISTIKAT E MJEDISIT DHE MULTIDOMAIN

- 4.1 Mjedi
- 4.2 Informacioni Statistikor Rajonal dhe Gjeohapsinor

IV. Statistikat Rajonale

V. Agjencitë statistikore

VI. Kuadri Ligjor Kombëtar dhe Ndërkombëtar

VII. Sistemi i menaxhimit të cilësisë

VIII. Burimet financiare dhe njerëzore

IX. Analiza SWOT

X. Analiza e risqeve dhe problemeve të pritshme

LISTA E SHKURTIMEVE

ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
AES	Anketa e Arsimit të të Rriturve
AFP	Anketa e Forcave të Punës
ANJ	Anketa e Nivelit të Jetesës
APK	Anketa e Përdorimit të Kohës
ASN	Anketa e Strukturës së Ndërmarrjeve
CAPI	Intervistë me Kompjuter (Computer Assisted Personal Interview)
CATI	Intervistë me telefon (Computer-Assisted Telephone Interviewing)
CAWI	Intervistë me link (Computer Assisted Web Interview)
CPA	Klasifikimi i produkteve të aktiviteteve (Statistical classification of products by activity)
ECB	Banka Qëndrore Evropiane (European Central Bank)
EDP	Procedura e Deficitit të Tejkualuar (Excessive Deficit Procedure)
EHIS	Anketa Evropiane e Shëndetit (European Health Interview Survey)
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (European system of national and regional accounts)
ESSPROS	Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (European system of integrated social protection statistics)
FAO	Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin (Food and Agriculture Organization)
FSS	Anketa e Strukturës së Fermave (Farm Structure Survey)
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto (Gross Domestic Product)
GFS	Statistikat Financiare të Qeverisë (Government Finance Statistics)
GFSM	Manuali për Statistikat Financiare të Qeverisë (Government Finance Statistics Manual)
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik (Geographic information system)
GNI	Të ardhurat Kombëtare Bruto (Gross national income)
GSBPM	Manuali për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (Generic Statistical Business Process Model)
HETUS	Anketa e Harmonizuar Evropiane për Përdorimin e Kohës (Harmonised European Time Use Surveys)
HMS	Anketa e Migrimit të Familjeve (Household Migration Survey)
ICCS	Klasifikimi Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (International Classification of Crime for Statistical Purposes)
ICD	Klasifikimi ndërkombëtar për Sëmundjet (International Statistical Classification of Diseases)
ICP	Indeksi i Çmimeve të Produkteve
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHÇK	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
IKN	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (International Organization for Migration)
IPA	Instrumenti i paraanëtarësimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare për Llogaritë e sektorit Publik (International Public Sector Accounting Standards)
ISCO	Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Profesioneve (International Standard Classification of Occupations)
MICS	Anketat e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (Multiple Indicator Cluster Surveys)
NST	Klasifikimi Standard për Transportin e Mallrave (Standard Goods Classification for Transport Statistics)
NUTS	Nomenklatura e Njësiwe Territoriale për Statistikat (Nomenclature of Territorial Units for Statistics)
NJEF	Njësi Ekonomike Familjare
OECD	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (Organisation for Economic Co-operation and Development)
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPP	Matja e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parities)
PRODCOM	Statistikat e Produkteve Industriale (Production Communautaire)
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor
SNA	Sistemi i Llogarive Kombëtare (System of National Accounts)
SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet (Strengths, Weaknesses, Opportunities, and Threats)
TERCET	Tipologjia Territoriale (Territorial typologies)
UNDOC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (United Nations Office on Drugs and Crime)

HYRJE

Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026, i përmendur në vazhdim, PSZ, hartohet në zbatim të neneve 7 dhe 8 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Sipas këtyre dispozitave, PSZ duhet të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare dhe duhet të përmbajë aktivitetet statistikore kryesore të cilat duhet të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, PSZ duhet të specifikojë institucionet e ngarkuara për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucionet furnizuese me të dhëna administrative.

Ligji për statistikat zyrtare ngarkon INSTAT të përgatisë projekt-programin, në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesuara për statistika zyrtare. Pas marrjes së mendimit të Këshillit të Statistikave dhe nëpërmjet Këshillit të Ministrave, i paraqitet Kuvendit për miratim përfundimtar.

Duke patur parasysh strukturën e kërkuar nga legjislacioni kombëtar dhe rregulloret e BE-së për statistikat zyrtare, si dhe duke u bazuar në eksperiencën 30 vjeçare të tij, INSTAT ka arritur të ndërtojë një program, i cili do të jetë pranë përdoruesve dhe publikut përsa i takon të kuptuarit të veprimtarisë statistikore në vend. Nga ana tjetër, meqenëse përmban për herë të parë indikatorë konkretë performance, dokumenti i strukturuar në mënyrë të tillë do të lehtësojë proceset e monitorimit dhe raportimit të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor.

Sipas parashikimeve të ligjit për statistikat zyrtare, statistikat e paparashikuara, por të kërkuara për tu prodhuar në periudhën e Programit, do të konsiderohen si statistika zyrtare në rast se ato përfshihen në Planin Vjetor të radhës. Në lidhje me zbatimin e Programit deri në vitin 2026, statistikat e identifikuara për tu prodhuar nga agjencitë e tjera do të konsiderohen si statistika zyrtare.

Përmbajtja e kapitujve

Kapitulli I i kushtohet paraqitjes së informacionit mbi sfidat e Programit të ri 2022-2026, si dhe qasjes krahasimore me programin 2017-2021 lidhur me aktivitetet përmirësuese në aspektin e metodologjisë, metodave të mbledhjes së të dhënave, afateve kohore, transmetimit të të dhënave në Eurostat si dhe treguesve të rinj apo publikimeve të reja.

Kapitulli II fokusohet në atë çfarë kërkohet konkretisht nga ligji për statistikat zyrtare: objektivat zhvillimore të SKS, masat për arritjen e tyre dhe indikatorët e monitorimit të performancës. Për shkak të natyrës strategjike të dokumentit, me synimin që ai të integrohet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar IPSIS, INSTAT ka përshtatur këtë kapitull pjesërisht në përputhje me formatet e kërkuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Kryeministri.

Kapitulli III përshkruan aktivitetet statistikore që do të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë pesë viteve, të ndara sipas fushave statistikore të përcaktuara në Shtojcën 1 të ligjit për statistikat zyrtare. Aktivitetet shoqërohen edhe me informacionin mbi nivelin e përputhshmërisë me *acquis communautaires*, burimet e të dhënave administrative dhe nevojat për burime njerëzore të cilat do të mundësojnë arritjen e këtyre aktiviteteve.

Kapitulli IV përmban një informacion mbi situatën e statistikave të nivelit vendor dhe vizionin e INSTAT për shtimin e treguesve të këtij niveli me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave të institucioneve të vetqeverisjes vendore.

Kapitulli V liston institucionet e ngarkuara nga programi për prodhimin e statistikave zyrtare si dhe numrin e aktiviteteve që do të kryejnë përkatësisht.

Kapitulli VI pasqyron kuadrin rregullator mbi të cilin mbështetet veprimtaria statistikore në vend.

Kapitulli VII jep informacionin mbi Sistemin e menaxhimit të cilësisë për të garantuar prodhimin e statistikave cilësore në vend.

Kapitulli VIII jep parashikimet e burimeve financiare dhe njerëzore të INSTAT-it, të nevojshme për zbatimin e programit.

Kapitujt IX dhe X kanë të bëjnë me analizën *SWOT* dhe menaxhimit të risqeve dhe problemeve të pritshme, të cilat kërkojnë marrjen e masave përkatëse parandaluese për të siguruar suksesin e zbatimit të programit.

Masat në kuadër të forcave madhore

Si asnjëherë më parë, gjatë periudhës 2019-2020 Sistemi Kombëtar Statistikor dhe INSTAT, në veçanti, u përballën me situata përtej kufijëve natyrorë, si pasojë e tërmeteve të Nëntorit 2019 dhe pandemisë globale Covid-19. Situata e shkaktuar nga tërmetet e vitit 2019 detyruan INSTAT-in të rimernte në konsideratë planin e veprimit të vitit 2019 për t'iu përshtatur gjendjes së re të krijuar në zonat e dëmtuara, si dhe përfshirjen e stafit të tij në proceset e prodhimit të treguesve për matjen e këtyre pasojave në terren. Ndërtesat e vrojtuar gjatë proceseve të përditësimit të hartave për Zonat e Censit, iu nënshtruan edhe një herë proceseve të përditësimit, për të evidentuar më saktë ndërtesat e dëmtuara dhe ato të cilat nuk mund të ofronin më karakteristikat e një banese.

Përsa i takon pandemisë, në kushtet e reja të distancimit social, INSTAT përcaktoi objektiva afat-shkurtër në zbatim të misionit të tij dhe parimeve të statistikave evropiane, baza në të cilën mbështetemi për të patur statistika të besueshme, cilësore, në kohë dhe eficiente. Gjithashtu, INSTAT mori në konsideratë përshtatjen e metodave dhe metodologjive, si përdorimi i intervistave telefonike në vend të metodës tradicionale të grumbullimit të informacionit dhe shfrytëzimi me efikasitet i burimeve ekzistuese apo ndjekja me rigoroze të rekomandimeve të Eurostat dhe institucioneve ndërkombëtare.

Hartimi i planeve të vazhdimësisë për çdo aktivitet statistikor ishte një risi nëpërmjet së cilës i jep mundësi këtij institucioni të marrë masa paraprake dhe në kohën e duhur për përballimin e situatave të ngjashme, duke garantuar mos ndërprerjen e prodhimit statistikor. Për arsye të distancimit social, INSTAT arriti të sigurojë kushtet e nevojshme për punën online nëpërmjet telepunës, duke krijuar dhe zbatuar platforma të reja për komunikimin online ndërmjet stafit, si dhe duke zhvilluar programe të reja kompjuterike për monitorim të situatës shëndetësore të stafit, ndjekje dhe monitorim të detyrave.

Për të ardhur sa më pranë përdoruesit me informacion, INSTAT krijoi një seksion të veçantë në faqen web, dedikuar Covid-19, ku publikoi të dhënat më frekvente, të cilat ndihmuan hartuesit e politikave, analistët, studiuesit për analiza të mëtejshme ekonomiko-sociale lidhur me situatën e krijuar në vend.

Një regjistër i detajuar risku është hartuar dhe është në zbatim për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë prodhuese dhe minimizimin e dëmeve në rastet e përballjes së situatave të ngjashme.

I. SFIDAT DHE RISITË E PROGRAMIT

Programi i parë i këtij lloji (2007-2011) ka shërbyer jo vetëm si dokument planifikimi për statistikat zyrtare gjatë kësaj periudhe, por edhe si dokument bazë për orientimin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor sipas standardeve të parashikuara nga *Acquis Communautaire*. Me Programin e dytë (2012-2016), u krijuan standardet kombëtare të cilësisë, u zgjerua gama e përdorimit të burimeve administrative, u shtuan databaza statistikore. Elementi i cilësisë në statistikat zyrtare u nxor në pah së bashku me metadatat e produkteve statistikore. Programi i periudhës 2017-2021, u përgatit me angazhimin e veçantë të të gjithë aktorëve të përfshirë, bazuar në plotësimin e nevojave të përdoruesve dhe kërkesave të Eurostat-it për statistika zyrtare cilësore, në kohë dhe të besueshme, me mbulim të gjithë Sistemin Kombëtar Statistikor.

Programi Statistikor Zyrtar, 2022-2026, do të sjellë një qasje të re të objektivave strategjikë, gjithëpërfshirjen e Sistemit Kombëtar Statistikor, pasi është përgatitur me angazhimin e plotë të agjencive statistikore dhe të gjithë aktorëve kontribues në prodhimin e statistikave. Ky program do të shërbejë për një fuqizim të mëtejshëm të sistemit, me ide inovatore, duke rritur besimin e përdoruesve në statistika, duke bashkëpunuar me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke zhvilluar kapacitetet për një nivel të lartë profesional, ku shkenca e statistikës të gjejë zbatim në praktikë, duke zbatuar standardet për një qasje sa më të shpejtë në familjen Evropiane dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, për një qëllim të përbashkët, ku askush të mos mbetet pas.

Për arritjen e objektivave strategjikë dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi, sfidat kryesore për periudhën pesëvjeçare parashikohet të jenë:

- 1. Sigurimi i Vazhdimësisë:** Pandemia Covid-19 ka impaktuar vazhdueshmërinë e punës gjatë fazave të prodhimit statistikor. Për këtë arsye, institucionet prodhuese do të fokusohen në sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore duke ruajtur vlerat e statistikave zyrtare që riskohen nga kjo situatë, nëpërmjet zbatimit të planeve të vazhdimësisë dhe aplikimit të metodave të reja shkencore për fazat e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave.
- 2. Kultura e ndryshimit dhe e zhvillimit:** INSTAT dhe agjencitë e tjera do të përdorin instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet dhe forcohet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion. Vlen për tu përmendur në këtë drejtim angazhimi i INSTAT për artikuj shkencorë cilësorë në revistat shkencore “Kërkimi” dhe “Infostat” si edhe për rritjen e edukimit statistikor nëpërmjet zhvillimit të takimeve formale dhe informale me median. Zhvillimet e takimeve shpjeguese e informuese me studentët, përfshirja edhe e grupeve të tjera të interesit, pasurimi me tema statistikore të seksionit “Statistika në Shkollë” është një tjetër risi në këtë drejtim.
- 3. Politika dhe strategji efikase:** Sistemi Kombëtar Statistikor do të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të orientojnë institucionet publike drejt arritjes së objektivave të Programit, ku synohet përafrimi me rregulloret, udhëzimet dhe manualet e BE-së dhe Eurostat-it në kuadër të Kapitullit 18 të *acquis*.
- 4. Niveli organizativ e institucional:** INSTAT parashikon forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet rritjes së rolit të Këshillit të Statistikave, Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, Grupit të Botës Akademike për Statistikat Zyrtare dhe grupeve të përdoruesve në as-

pektet e planifikimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së Programit. Gjithashtu, INSTAT do të modernizojë procesin duke ndërtuar sisteme menaxheriale adekuata, për ndërveprimin vertikal dhe horizontal për arritjen e qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Programit, duke përdorur në mënyrën më të mirë të mundshme burimet që disponon institucioni, nëpërmjet prodhimit dhe monitorimit të indikatorëve që shërbejnë për matjen e Performancës së institucionit.


- 5. Komunikimi me përdoruesit:** Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të Sistemit. INSTAT, si koordinator i sistemit, do të punojë për t'iu përafruar gjithnjë e më shumë pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare. Në kuadër të censeve apo aktiviteteve të tjera statistikore, INSTAT parashikon zhvillimin e takimeve me grupet e përdoruesve për të diskutuar më tej mbi pritshmëritë e tyre për prodhim statistikor. Nga ana tjetër, në kuadër të zbatimit të objektivave strategjikë, module të veçanta trajnimi do t'i kushtohen kryesisht përfaqësuesve të medias për të rritur shkallën e kuptueshmërisë dhe interpretimit të statistikave zyrtare në vend.

Aktivitetet statistikore përmirësuese

Në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Eurostat-it për standardizimin e prodhimit statistikor, gjatë pesë viteve të këtij programi, Sistemi Kombëtar Statistikor do të fokusohet në:

- Përmirësimin e metodologjisë statistikore;
- Modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave;
- Reduktimin e afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave;
- Rritjen e të dhënave të transmetuara në Eurostat.


Figura nr. 1. Numri i aktiviteteve statistikore përmirësuese PSZ 2017-2021 krahasuar me PSZ 2022-2026



Përsa i takon fushave statistikore, institucionet prodhuese të statistikave zyrtare do të angazhohen në aktivitete statistikore përmirësuese në aspektet si më poshtë:


Fusha e Statistikave Sociale dhe Demografike: përmirësime në metodologji, mbledhjen e të dhënave, transmetimet në Eurostat dhe publikime të reja.

Figura nr. 2. Numri i aktiviteteve statistikore përmirësuese në Fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike krahasuar me PSZ 2017-2021




Fusha e Statistikave Ekonomike: përmirësime në metodologji, afate kohore dhe tregues të rinj.

Figura nr. 3. Numri i aktiviteteve statistikore përmirësuese në Fushën e Statistikave Ekonomike krahasuar me PSZ 2017-2021




Fusha e Statistikave Sektoriale: përmirësime në metodologji, metodat e mbledhjes së të dhënave, afate kohore dhe transmetime në Eurostat

Figura nr. 4. Numri i aktiviteteve statistikore përmirësuese në Fushën e Statistikave Sektoriale krahasuar me PSZ 2017-2021



Fusha e Statistikave të Mjedisit dhe Multodomain: përmirësime në metodologji dhe transmetime në Eurostat

Figura nr. 5. Numri i aktiviteteve statistikore përmirësuese në Fushën e Statistikave Mjedisit dhe Multidomain krahasuar me PSZ 2017-2021



Instrumentet monitoruese

Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimin të aktiviteteve statistikore të kërkuara në të. Ligji nr.17/2018 “Për statistikatat zyrtare” parashikon disa instrumente raportues e monitorues, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre për të krijuar një panoramë të qartë të ecurisë së programit, evidentimit të problematikave dhe marrjes së masave për përmirësimin e aktiviteteve statistikore. Sipas ligjit, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT është i ngarkuar t’i paraqesë Këshillit të Statistikave raporte 4-mujore për ecurinë e programit. Në këtë mënyrë, Këshilli i Statistikave vlerëson efciencën e zbatimit dhe përputhshmërinë e produkteve me kërkesat ndërkombëtare. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i paraqet Kuvendit të Shqipërisë raportin vjetor të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it në veçanti. Mbi bazën e këtij raporti, Kuvendi miraton rezolutën përkatëse e cila përmban edhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Marrëveshjet e ndryshme të mirëkuptimit, nënshkruar mes INSTAT dhe agjencive statistikore ose me institucionet e tjera publike/jopublike, parashikojnë ngritjen e grupeve të përbashkëta për të diskutuar mbi zbatimin e aktiviteteve statistikore, programet për të ardhmen, etj. Këto struktura ndikojnë në ndërgjegjësimin e agjencive përkatëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky Program, si në aspektin prodhues të statistikave, ashtu dhe në atë të dhënies së informacionit. Së

bashku me prodhuesit e statistikave zyrtare, ata sigurojnë harmonizimin maksimal të prioriteteve të dhëna në programin pesëvjeçar me ato të programeve vjetore, gjatë gjithë kohës që është në fuqi ky program.

Ndërkohë, rolin monitorues të veprimtarisë statistikore të gjithë sistemit në vend e ka Instituti i Statistikave. Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve për përafrimin me *acquis communautaire* sipas Kapitulli 18 “Statistikat”, INSTAT përpiqet të krijojë një kulturë në rritje statistikore midis agjencive të tjera, duke ndjekur shkallën e përpjekjeve për të realizuar detyrimet e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian nga këto agjenci.

II. OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR

Strategjia për zhvillim të Sistemit Kombëtar Statistikor paraqet një kuadër gjithëpërfshirës dhe të unifikuar për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave dhe prioriteteve të përdoruesve në zhvillim të statistikave dhe për forcimin e kapaciteteve të nevojshme për të përmbushur këto nevoja në mënyrë më të koordinuar, sinergjike dhe efikase. Ajo gjithashtu siguron një kornizë për angazhimin e agjencive statistikore dhe kontribuesve në të dhëna, për shfrytëzimin e burimeve (të brendshme dhe të jashtme) dhe një bazë për një drejtim strategjik të SKS-së, efektiv dhe të orientuar drejt rezultateve.

VIZIONI

Një Sistem Statistikor Kombëtar që të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për të përfutur statistika dhe tregues, të cilët janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.

MISIONI

Sigurimi i statistikave transparente, neutrale dhe në kohën e duhur, të cilat ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë zhvillimin dhe proceset transformuese në fushën e ekonomisë, demografisë, shoqërisë dhe mjedisit, brenda vendit.

PSZ 2022-2026 parashikon 6 objektiva strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor sipas këtyre drejtimeve:

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian

Objektivat specifike janë:

1. Të përcaktojë kërkesat prioritare që do të mundësojnë progresin drejt *acquis*
2. Të sigurojë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare dhe zbatimin e parimeve statistikore
3. Prodhimi i indikatorëve përkatës sipas specifikimeve të përcaktuara nga Eurostat-i

Objektivi strategjik 2: Plotësimi i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare

Objektivat specifike janë:

1. Rritja e përdorimit të të dhënave dhe rekordeve administrative për qëllime statistikore
2. Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve të statistikave brenda vendit
3. Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve ndërkombëtarë të statistikave
4. Të ofrohet qasje e lehtësuar në statistikat zyrtare për të gjithë përdoruesit në një gamë të përshatshme formatesh dhe sipas praktikave ndërkombëtare

Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare

Objektivat specifikë janë:

1. Përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruara nga institucionet përkatëse
2. Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS-në

Objektivi strategjik 4: Rritja e numrit të institucioneve pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor

Objektivat specifikë janë:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve për përfitimet si rezultati i funksionimit brenda PSZ
2. Vendosja dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe partneritetit mes institucioneve prodhuese të statistikave
3. Miratimi i akteve rregullatore nga ana e institucioneve të tjera prodhuese statistikore që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore zyrtare
4. Përafrimi dhe zbatimi i mekanizmave që nxisin ndarjen efikase dhe transparente të fondeve publike

Objektivi strategjik 5: Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare.

Objektivat specifikë janë:

1. Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për grumbullimin e të dhënave
2. Zgjerimi i përdorimit të burimeve jotradicionale të të dhënave të papërpunuara
3. Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen
4. Fuqizimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore
5. Zhvillimi i sistemeve të informacionit për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore

Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur

SKS synon të rrisë numrin e marrëveshjeve ndërinstitucionale për bashkëpunim, për të nxitur besimin te institucionet prodhuese të statistikave dhe produktet e tyre. Besimi mbështetet gjithashtu nga proceset e planifikimit dhe raportimit të INSTAT-it. Publikimi i dokumenteve zyrtare në faqen e internetit të INSTAT-it ofron informacion të rëndësishëm për përdoruesit dhe palë të treta. Gjith-

thashtu, publikimi i veprimtarisë së institucioneve dhe akteve të prodhuara për qëllime statistikore, nëpërmjet shkallës së rëndësishme të transparencës, mundëson që përdoruesit dhe palët e treta të mbështesin besimin te institucionet prodhuese të statistikave zyrtare.

Objektivat specifikë janë:

1. Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statistikore të SKS-së
2. Fuqizimi dhe promovimi i rolit të INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare
3. Zbatimi i plotë i dispozitave ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor

Tabela nr. 1 Lidhja e Objektivave strategjike me objektivat specifike

VIZIONI – MISIONI – OBJEKTIVAT STRATEGJIKE – OBJEKTIVAT SPECIFIKË					
VIZIONI					
Një Sistem Statistikor Kombëtar që të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për të përfutur statistika dhe tregues, të cilët janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.					
MISIONI					
Sigurimi i Statistikave transparente, neutrale dhe në kohën e duhur, të cilat ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë zhvillimin dhe proceset transformuese në fushën e ekonomisë, demografisë, shoqërisë dhe mjedisit, brenda vendit					
Objektivi strategjik 1:	Objektivi strategjik 2:	Objektivi strategjik 3:	Objektivi strategjik 4:	Objektivi strategjik 5:	Objektivi strategjik 6:
Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikatat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian	Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare	Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur
Objektivat Specifikë					
1.1 Të përcaktojë kërkesat prioritare që do të mundësojnë progresin drejt acquis	2.1 Rritja e përdorimit të të dhënave dhe rekordeve administrative për qëllime statistikore	3.1.Përmirësimi i cilësisë të të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruar nga institucionet përkatëse	4.1 Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve për përfitimet si rezultati i funksionimit brenda PKSZ	5.1 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për grumbullimin e të dhënave	6.1 Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statistikore të SKS-së
1.2 Të sigurojë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare dhe zbatimin e parimeve statistikore	2.2 Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve të statistikave brenda vendit	3.2 Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS-në	4.2 Vendorsja dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe partneriteti mes institucioneve prodhues të statistikave	5.2 Zgjerimi i përdorimit të burimeve jotradicionale të të dhënave të papërpunuara	6.2 Fuqizimi dhe promovimi i rolit të INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare
1.3 Prodhimi i indikatorëve përkatës sipas specifikimeve të përcaktuara nga Eurostat-i	2.3 Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve ndërkombëtarë të statistikave		4.3 Miratimi i akteve rregullatore nga ana e institucioneve të tjera prodhuese statistikore që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore zyrtare	5.3 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen	6.3 Zbatimi i plotë i dispozitave ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor
	2.4 Të ofrohet qasje e lehtësuar në statistikatat zyrtare për të gjithë përdoruesit në një gamë të përshtatshme formatesh dhe sipas praktikave ndërkombëtare		4.4 Përafrimi dhe zbatimi i mekanizmave që nxisin ndarjen efikase dhe transparente të fondeve publike.	5.4 Fuqizimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore	
			4.5 Përfshirja në strukturat organizative të institucioneve publike struktura të veçanta të dedikuara vetëm për prodhimin statistikor	5.5 Zhvillimi i sistemeve të informacionit për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore	

Gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, Sistemi Kombëtar Statistikor do të performojë hapa të mëtejshëm drejt modernizimit dhe cilësisë statistikore, krahasuar me pesë vitet e kaluara. Tabela e mëposhtme paraqet disa aspekte përmirësuese që do të rrisin performancën e institucioneve prodhuese.

Tabela nr.2 Aspektet përmirësuese

Aspekte përmirësuese	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Vlera deri në vitin 2026	Progresi (në %)
Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën statistikore të Eurostat-it për Shqipërinë	2.989.437	3.100.000	3
Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën e INSTAT (në %)	124.920	144.653	15
Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	3.285.976	5.292.095	61
Numri i takimeve me përdoruesit (mbledhjet me grupin e përdoruesve, etj.)	2	5	150
Numri treguesve të OZHQ-së të prodhuar nga SKS	56	62	10,7
Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT	77,30%	77,50%	0,3
Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetatat ditore kryesore ose në televizione	2.500	3.200	28

Tabelat e mëposhtme paraqesin objektivat strategjike të zhvillimit të SKS, të lidhura me aktivitetet statistikore të parashikuara për secilën fushë dhe indikatorët e performancës, ecuria e të cilave do të paraqitet nga INSTAT-i në Këshillin e Statistikave dhe do të raportohet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë.

Tabela nr. 3 Objektivi Strategjik 1, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
						2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian	1.1 Të përcaktojnë kërkesat prioritarë që do të mundësojnë progresin drejt acquis 1.2 Të sigurojnë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare dhe zbatimin e parimeve statistikore 1.3 Prodhimi i indikatorëve përkatës sipas specifikimeve të përcaktuara nga Eurostat-i	-4 aktivitete në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike; -6 aktivitete në fushën e Statistikave Ekonomike -30 aktivitete në fushën e statistikave Sektoriale -1 aktivitet në fushën e statistikave të Mjedisit dhe Multidomain	1.1 Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën statistikore të Eurostat-it për Shqipërinë	2.989.437	3.000.000	3.000.000	3.050.000	3.100.000	3.100.000
			1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafuara me acquis (Sipas PKIE)	2	1	4	0	0	1
			1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti Peer Review 2018), të zbatuara (në %)	74 %	85%	100%	100%		

Tabela nr. 4 Objektivi Strategjik 2, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
					2022	2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	2.1- Rritja e përdorimit të të dhënave dhe re- kordeve administrative për qëllime statistikore 2.2 Prodhi- mi i treg- uesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve të statisti- kave bren- da vendit	-33 aktiv- itete në fushën e statistikave Sociale dhe Demo- grafike -18 aktiv- itete në fushën e Statistikave Ekonomike -45 aktiv- itete në fushën e Statistikave Sektoriale -9 aktivitete në fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multid- omain	2.1 Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në data- bazën e INSTAT (në %)	124.920	1%	3%	3%	7%	0,10%
			2.2 Numri i vizitave në faqen e in- ternetit të INSTAT-it	3.285.976	10%	10%	10%	10%	10%
			2.3 Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statis- tikave të prodhuara nga INSTAT	3,87 (-77,3%)	0,01%	0,01%	0,01%	0,01%	0,01%
			2.4 Numri i takimeve me përdoruesit (mbledhjet me grupin e përdoruesve, etj.)	2	5	5	5	5	5
			2.5 Numri treguesve të OZHQ-së të prod- huar nga SKS	56	56	58	60	62	62
			2.6 Numri i aktiviteteve statistikore të disa- greguara në nivel minimal vendor	11	11	11	11	12	12

Tabela nr. 5 Objektivi Strategjik 3, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
						2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare	3.1. Përmirësimi i cilësisë të të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruara nga institucionet përkatëse	-26 aktivitete në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike; -20 aktivitete në fushën e Statistikave Ekonomike	3.1 Numri i klasifikimeve statistikore ndërkombëtare të reja të adoptuara në vend		2	2	1	1	1
	3.2 Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS	-35 aktivitete në fushën e statistikave Sektoriale -2 aktivitete në fushën e statistikave të Mjedisit dhe Multidomain	3.2 Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	42	40	42	43	41	40

Tabela nr. 6 Objektivi Strategjik 4, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
						2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	4.1 Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve për përfitimet si rezultati i funksionimit brenda PKSZ		4.1 Numri i agjencive statistikore në PSZ	3	4	4	5	6	6
	4.2 Vendosja dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe partneritetit mes institucioneve prodhues të statistikave		4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	5	4	4	4	4	4
	4.3 Miratimi i akteve rregullatore nga ana e institucioneve të tjera prodhuese statistikore që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore zyrtare		4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT	12	12	12	13	14	15
	4.4 Përafrimi dhe zbatimi i mekanizmave që nxisin ndarjen efikase dhe transparente të fondeve publike		4.4 Numri i regjistrave administrativë të përdorur për prodhim statistikor (skedarët mikro që merr INSTAT nga institucionet e tjera)	15	15	15	16	16	17
	4.4 Përfshirja në strukturat organizative të institucioneve publike struktura të veçanta të dedikuara vetëm për prodhimin statistikor								

Tabela nr. 7 Objektivi Strategjik 5, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
						2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	5.1 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për grumbullimin e të dhënave 5.2 Zgjerimi i përdorimit të burimeve jotradicionale të të dhënave të papërpunuara 5.3 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen 5.4 Fuqizimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore 5.5 Zhvillimi i sistemeve të informacionit për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore	-6 aktivitete në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike; -9 aktivitete në fushën e Statistikave Ekonomike -23 aktivitete në fushën e statistikave Sektoriale	5.1 Number of applications built/ upd5.1 Numri i aplikacioneve të ndërtuara/ përditësuara për grumbullimin e të dhënave me CATI/CAWI	3	4	4	5	5	5
			5.2 Numri i aplikacioneve të ndërtuara/ përditësuara me CAPI	8	8	8	9	9	9
			5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat do të përdoren software	96 (sipas definicionit në PSZ 2017-2021)	96	99	104	108	108

Tabela nr. 8 Objektivi Strategjik 6, aktivitetet statistikore dhe Indikatorët e Performancës

Objektivat strategjikë	Objektiva specifike	Lidhja me fushat statistikore/ nr i aktiviteteve statistikore	Indikatorët e performancës	Vlerat për vitin bazë 2020/2021	Afat-shkurtër		Afat-mesëm		
						2023	2024	2025	2026
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur	6.1 Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statistikore të SKS-së 6.2 Fuqizimi dhe promovimi i rolit të INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare 6.3 Zbatimi i plotë i dispozitave ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor	-3 aktivitete në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike; -1 aktivitet në fushën e statistikave Sektoriale	6.1 Përqindja e përdoruesve që shprehin besim/ besueshmëri në statistikat kombëtare (në një Anketë)	77,60%	77,70%	77,80%	78%	78,50%	79%
			6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetat ditore kryesore ose në televizione	2.500	3.000	3.000	3.000	3.200	3.200
			6.3 Numri i eventeve të kryera për ndërgjegjësimin e statistikave	5	15	10	10	10	10

III. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE 2022-2026

Në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 është planifikuar realizimi i 118 aktiviteteve statistikore. Aktivitetet statistikore të ndara sipas fushave të mbulimit dhe kompetencës së agjencive statistikore rezultojnë si më poshtë:

INSTAT - Përgjegjës për 107 aktivitete statistikore

Banka e Shqipërisë - Përgjegjës për 9 aktivitete statistikore

Ministria e Financave dhe Ekonomisë - Përgjegjës për 2 aktivitete statistikore

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten aktivitetet statistikore sipas fushave statistikore:




Tabela më poshtë paraqet aktivitetet statistikore të shpërndara gjatë harkut kohor 2022-2026:

Fusha statistikore	2022	2023	2024	2025	2026	Agjencia
Statistikat Sociale dhe Demografike	27	26	31	29	30	INSTAT
Statistikat Ekonomike	19	20	19	19	19	INSTAT, BSH, MFE
Statistikat Sektoriale	39	40	42	45	44	INSTAT, BSH
Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	11	13	12	15	15	INSTAT
Totali	96	99	104	108	108	

Në mënyrë të detajuar aktivitetet paraqiten në seksionet e mëposhtme sipas fushave statistikore si dhe dhe në aneksin nr. 2 të dokumentit, në të cilin aktivitetet statistikore janë shoqëruar me kategori informacioni si: Periodiciteti; Viti i realizimit; Përshkrimi; Afati i publikimit; Niveli minimal i Publikimit të të dhënave; Agjencia Statistikore; Ofruesi i të dhënave.

1. STATISTIKAT SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE

Statistikat sociale përfshijnë fushat që lidhen me statistikat e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës dhe përdorimit të kohës.

1.1 POPULLSIA ME VENDBANIM TË ZAKONSHËM NË SHQIPËRI DHE JASHTË SAJ

Përshkrimi

Kjo temë ka në fokus statistikat demografike të Shqipërisë. Informacioni statistikor i INSTAT-it mbi zhvillimet demografike në vendin tonë gjenerohet nga përpunimi i të dhënave nga burimet administrative dhe anketat periodike.

Censi i Popullsisë dhe Banesave pritet të ketë një impakt të rëndësishëm sa i takon mundësisë së krijimit të një regjistri kombëtar statistikor të popullsisë dhe banesave, si dhe përmirësimit të informacionit statistikor në vend.

Aspekti gjinor është një dimension çelës për të gjithë fushat e statistikave në nivel individual. Promovimi i perspektivës gjinore në fusha të ndryshme statistikore mbetet prioritet i kësaj fushe të Programit.

Situata aktuale

Statistikat demografike, të migracionit, popullsisë dhe projeksioneve të saj janë pjesërisht në linjë me rregulloren Nr. 1260/2013 dhe 862/2007 të KE, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar, si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Lindjet dhe vdekjet janë dy ndër tre komponentët kryesorë që ndikojnë në ndryshimin e popullsisë së një vendi dhe si rrjedhojë, ato janë tepër të rëndësishme për llogaritjen e numrit të popullsisë. INSTAT i siguron të dhënat vitale në mënyrë elektronike nga regjistrat e gjendjes civile. Forcimi i bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile mbetet prioritet për përmirësimin nga ana sasiore dhe cilësore e të dhënave demografike, si dhe përafrimin e tyre me modelet dhe kërkesat e parashikuara nga Eurostat, duke përmirësuar databazën statistikore dhe shtuar treguesit demografikë.

Lëvizja e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi (Migracioni Ndërkombëtar), është komponenti më i vështirë për tu matur, duke qenë se Shqipëria nuk ka ende një regjistër statistikor të popullsisë. Në këtë mënyrë, për vlerësimin e migracionit përdoren të dhëna kryesisht të mbledhura nga moduli i migracionit nëpërmjet anketës së forcave të punës, kombinuar me koeficientët e projeksioneve të popullsisë 2011-2031. Sipas parashikimeve të Ligjit nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, INSTAT planifikon të formalizojë Regjistrin Statistikor të Popullsisë dhe Regjistrin e Ndërtesave dhe Banesave nëpërmjet të dhënave të mbledhura gjatë censit dhe burimeve administrative të ardhura periodikisht.

Përsa i takon *statistikave të Azilkërkuesve dhe të Huajve*, që prej vitit 2017 u publikuan për herë të parë statistikat mbi azilkërkuesit dhe të huajt në Shqipëri me leje qëndrimi, të cilat do të vazhdojnë të publikohen me frekuencë vjetore.

“Diaspora Shqiptare” mbetet publikim me rëndësi sa i takon evidentimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, krahasuar me popullsinë rezidente në vend.

Lidhur me Censin e radhës të Popullsisë dhe Banesave, progres i rëndësishëm është kryer në kuadër të fazës përgatitore të tij. Ligji i ri i Censit nr. 140/2020 u miratua nga Parlamenti i Shqipërisë në Nëntor të vitit 2020 së bashku me aktet nënligjore. Ndërkohë, po kryhen të gjitha testimet/pilotimet e nevojshme për të gjitha çështjet metodologjike, teknologjike, hartografike, logjistike, burime njerëzore, në mënyrë që të sigurohet realizimi i suksesshëm i tij në Tetor 2022.

Statistikat për Fëmijët, Adoleshentët dhe të Rinjtë kanë patur një përmirësim të dukshëm, duke u konkretizuar me një publikim të dedikuar, për herë të parë në vitin 2020, i cili do të ketë një periodicitet vjetor në vazhdimësi, duke siguruar një përmirësim në seritë kohore dhe treguesit respektivë për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri.

Lidhur me *Statistikat Gjinore*, në kuadër të këtyre statistikave, INSTAT prodhon një publikim të dedikuar *“Gratë dhe Burrat në Shqipëri”*, si dhe llogarit tregues të përbërë, të cilët matin barazinë ose pabarazinë midis burrave dhe grave. Risi përbën llogaritja dhe publikimi për herë të parë i Indeksit të Barazisë Gjinore. Gjithashtu, në vitin 2018, përfundoi me sukses Studimi i Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave. Lidhur me treguesit e aksesit/qasjes në drejtësi, INSTAT ka filluar bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, për ta shtrirë më tej bashkëpunimin me institucionet e tjera të pavarura të të drejtave të njeriut.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme për statistikën demografike paraqiten në vijim:

Për statistikën vitale:

- Publikimi i treguesve demografikë për lindjet dhe vdekjet me periodicitet tremujor/mujor;
- Përmirësimi nga ana cilësore i variablave ekzistues, si dhe shtimi sasior i variablave të rinj për: lindjet, vdekjet dhe martesat.
- Rritja e cilësisë së të dhënave gjatë procesit të mbledhjes, regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore;

Për migracionin:

- Publikimi i treguesve për migracionin ndërkombëtar, lëvizjet e brendshme si dhe statistikën mbi të huajt dhe azilkërkuesit, me periodicitet vjetor;
- Përmirësimi nga ana cilësore e variablave si dhe shtimi sasior i variablave të rinj për lëvizjet e brendshme të popullsisë;
- Përmirësimi i statistikave të migracionit të mbledhura nga AFP;
- Harmonizimi i definicioneve statistikore të migracionit me ato të Eurostat;
- Përmirësimi nga ana sasimore dhe cilësore e informacioneve statistikore mbi të huajt, azilkërkuesit dhe personat që marrin dhe lënë shtetësinë, për t'i përafëruar me kërkesat e Eurostat.

Për popullsinë:

- Llogaritja e popullsisë më 1 Janar të çdo viti dhe mesatarja vjetore sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve/bashkive me periodicitet vjetor;
- Për Censin e Popullsisë dhe Banesave;
- Kryerja e suksesshme e Censit të Popullsisë dhe Banesave si dhe tabulimi i të dhënave në kohë;
- Përgatitja e analizave të thelluara me bazë të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave në nivel kombëtar dhe rajonal.

Për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë:

- Përgatitja e publikimit të dedikuar me treguesit respektiv, me periodicitet vjetor, dhe shpërndarja tek të gjithë grupet e interesit, përmes instrumentave të përshtatshëm të komunikimit dhe vizualizimit të treguesve;
- Hartëzimi i nevojave për tregues dhe zgjerimi i gamës së treguesve për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri, treguesve të Eurostat, OZHQ, dhe atyre sipas ndarjes administrative në nivel bashkie apo qarku;
- Përmirësimi i cilësisë së treguesve, përmes mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve të sistemeve të të dhënave administrative; Raportimi i përvitshëm i treguesve të fëmijëve në databazat rajonale.

Për statistikat mbi të moshuarit:

- Përmirësimi i statistikave për të moshuarit në Shqipëri, krahas atyre ekzistues; publikim i treguesve respektivë, me periodicitet vjetor.

Kryerja e anketës së Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS)

- Planifikimi i anketës në bashkëpunim me të gjithë aktorët e fushës dhe bazuar në nevojat e identifikuar, në veçanti lidhur me raportimin e treguesve të OZHQ;
- Kryerja e suksesshme e anketës, si dhe tabulimi i të dhënave në kohë;
- Përgatitja e analizave të thelluara për popullatën rome dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Për statistikat gjinore:

- Publikimi i treguesve gjinorë në fusha të ndryshme të jetës, me periodicitet vjetor;
- Përmirësimi i statistikave gjinore në Shqipëri, krahas atyre ekzistues; publikimi i treguesve respektivë, me periodicitet vjetor;
- Llogaritja e indekseve gjinore.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat demografike, të migracionit dhe popullsisë janë pjesërisht të përputhshme me Rregulloren e Bashkimit Evropian Nr. 1260/2013 “Mbi Statistikat demografike evropiane”. Nga kjo rregullore lind nevoja për të prodhuar tabela më të detajuara për popullsinë me vendbanim të zakonshëm, lindjet e gjalla dhe vdekjet. Të dhënat demografike të siguruar nga INSTAT bazohen në përkufizimin e popullsisë banuese, nivelin rajonal NUTS dhe përkufizimet e ngjarjeve vitale që janë plotësisht në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Evropian Nr. 1260/2013.

Statistikat e Azilkërkuesve, Lejeve të qëndrimit, dhe shtetësisë janë përfshirë për herë të parë në PSZ 2017-2021. INSTAT do të rrisë numrin e treguesve të transmetuar në Eurostat. Harmonizimi i metodologjisë për monitorimin e migracionit dhe azilkërkuesve do të merret në konsideratë në mënyrë që të arrihet një përputhshmëri e një niveli më të lartë me rregulloret e BE. Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM) ka mbështetur hartimin e Udhërrëfyesit të Statistikave të Migracionit në Shqipëri, që synon të shërbejë si një udhëzues drejt përafrimit të plotë me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 862/2007 mbi “Statistikat komuntare të migracionit”.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e BE Nr. 1260/2013 “Mbi Statistikat demografike evropiane”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e BE Nr. 862/2007 mbi “Statistikat e Komunitetit mbi migracionin”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

1.1 Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat e Popullsisë	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT
Projeksionet e Popullsisë			x			VS+BA	INSTAT
Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT
Statistikat e Diasporës Shqiptare				x		BA	INSTAT
Statistikat Vitale	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Anketa MICS			x			VS	INSTAT
Censi i Popullsisë dhe Banesave	x					CENS	INSTAT
Statistikat e Azilit dhe të Huajve	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat Gjinore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Indeksi i Barazisë Gjinore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Anketa e Dhunës në Familje					x	VS	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burime Administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- Ministria e Brendshme
- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
- Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë

Vrojtime Statistikore:

- Anketa e Forcave të Punës
- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës

PUNA DHE KOSTOT E PUNËS

Përshkrimi

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikat zyrtare të punësimit dhe papunësisë, fitimeve dhe kostos së punës nëpërmjet vrojtimeve statistikore pranë familjeve dhe ndërmarrjeve. Tregues të tjerë të punësimit dhe papunësisë së regjistruar, si dhe pagat llogariten për nevoja kombëtare, bazuar në të dhënat administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi.

Situata aktuale

Anketa e Forcave të Punës (AFP) kryhet me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues, duke përdorur sistemin CAPI (me tablet). Statistikat përfshijnë të gjithë popullsinë e moshës 15 vjeç e lart, e cila jeton në njësitë ekonomike familjare me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, të përfaqësuar nga një kampion me bazë popullatën në banesat e regjistruara në censin më të fundit të popullsisë dhe banesave. Njësitë ekonomike familjare (NjEF) që përbëjnë kampionin, zgjidhen me dy hapa, duke zgjedhur më parë njësitë primare të kampionit proporcionalisht me madhësinë e qarqeve përkatëse, dhe më pas duke zgjedhur një numër të caktuar NjEF për secilën nga ato. Vrojtimi përmban të dhëna mbi karakteristikat ekonomike dhe demografike të individëve brenda familjeve të përzgjedhura.

Të dhënat e AFP dhe të dhënat administrative përpunohen dhe analizohen për çdo tremujor, ndërsa rezultatet publikohen 70 ditë pas tremujorit të referencës, nëpërmjet njoftimit për shtyp dhe përditësimit të faqes zyrtare të INSTAT. Të dhënat vjetore publikohen 40 ditë pas vitit të referencës dhe përmbajnë analiza më të zgjeruara mbi punësimin dhe papunësinë, duke gjetur pasqyrim në publikimin vjetor të veçantë “*Tregu i Punës*”, si dhe në faqen zyrtare të INSTAT. Nga viti 2017, INSTAT kryen transmetimin në Eurostat të të dhënave mikro me bazë tremujore.

Statistikat e kostos dhe fitimeve nga puna bazohen në vrojtimet statistikore të strukturës së të ardhurave dhe kostos së punës. Këto vrojtime kryhen pranë ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore çdo 4 vjet, me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Statistikat përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, për të gjitha format legale, me mbi 10 të punësuar. Popullata është bazuar në ndërmarrjet, të cilat sipas regjistrit statistikor të ndërmarrjeve, ishin aktive në Dhjetor të vitit të referencës. Vrojtmet përmbajnë të dhëna mbi ngjarjet demografike, aktivitetet ekonomike, punësimin, të ardhurat nga puna dhe koston e punës. Të dhënat publikohen 16 muaj pas vitit të referencës në botimin e

veçantë “Rezultate të Përgjithshme të Anketës së Kostos së Punës” dhe në “Rezultate të Përgjithshme të Anketës së të Ardhurave nga puna”. INSTAT kryen transmetimin në Eurostat të të dhënave mikro të secilës anketë, 18 muaj pas vitit të referencës.

Rezultatet e pritshme

- Zbatimi i rregullores së re të statistikave evropiane për punësimin dhe papunësinë, me mbështetjen e projektit pilot të IPA shumë-përfituese 2019.
- Përputhshmëria e plotë me Rregulloren (BE) 2019/1700;
- Përmirësimi në aspekte të tjera metodologjike si kërkesat mbi cilësinë statistikore të treguesve, karakteristikat e kampionit, përkufizimet, afati kohor dhe cilësia e transmetimit të të dhënave, prodhimi i raporteve të cilësisë, përfshirja e teknikave të tjera të anketimit (CATI) në mënyrë që mbledhja e të dhënave të jetë më efektive etj.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e forcave të punës lidhur me punësimin dhe papunësinë bazohen në Rregulloren (KE) Nr. 577/98 “Mbi organizimin e Anketës së Forcave të Punës në Komunitet”. Përkufizimet mbi të cilat bazohet përpunimi i të dhënave janë në përputhje me rregulloren dhe klasifikimet e përdorura: ISCO-08 për profesionet dhe NVE Rev2 për aktivitetet ekonomike.

Statistikat strukturore mbi koston e punës dhe të ardhurave nga puna bazohen në Rregulloret e (KE) Nr. 530/1999 “Mbi statistikatat strukturore në lidhje me të ardhurat dhe kostot e punës”, Nr. 1916/2000 (ndryshuar) “Lidhur me statistikatat strukturore mbi të fitimet dhe forcat e punës si dhe përcaktimin dhe transmetimin e informacionit mbi strukturën e fitimeve” dhe Nr. 1738/2005 “Mbi përcaktimin dhe transmetimin e informacionit mbi strukturën e fitimeve”. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me këto rregullore.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr.577/98 “Mbi organizimin e Anketës së Forcave të Punës në Komunitet”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 530/1999 “Mbi statistikatat strukturore në lidhje me të ardhurat dhe kostot e punës”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 1916/2000 (ndryshuar) “Lidhur me statistikatat strukturore mbi të fitimet dhe forcat e punës si dhe përcaktimin dhe transmetimin e informacionit mbi strukturën e fitimeve”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 1738/2005 “Mbi përcaktimin dhe transmetimin e informacionit mbi strukturën e fitimeve”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

1.2 Labor and labor costs	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Statistika të Forcave të Punës	x	x	x	x	X	VS	INSTAT
Statistika të Tregut të Punës	x	x	x	x	X	BA	INSTAT
Statistika të Fitimeve dhe Kostos së Punës	x		x			VS	INSTAT
Statistika mbi Pagat	x	x	x	x	X	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Vrojtimet Statistikore:

- Anketa e Forcave të Punës
- Anketa e Kostos së Punës
- Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna

ARSIMI DHE TRAJNIMET

Përshkrimi

Statistikat e arsimit pasqyrojnë statistika cilësore dhe të krahasueshme mbi arsimin zyrtar në Shqipëri, publik dhe privat, si dhe statistika të detajuara lidhur me regjistrimet dhe diplomimet sipas nivele arsimore, dhe programeve të studimit në arsimin e lartë.

Situata aktuale

Mbledhja dhe analizimi i statistikave të arsimit kryhet sipas klasifikimit ndërkombëtar të arsimit ISCED-2011. Risi gjatë periudhës 2017-2021 përbën rritja e gamës së treguesve dhe prodhimi i dy botimeve të dedikuara: “*Statistikat e regjistrimeve në arsim*” dhe “*Statistikat e diplomimeve*”. Është realizuar në vazhdimësi prodhimi i treguesve për të larguarit herët nga shkollimi dhe niveli arsimor i popullatës, bazuar në të dhënat nga AFP. INSTAT, për ndërtimin e statistikave të krahasueshme dhe të qëndrueshme, synon zhvillimin e raundit të dytë të anketës së Arsimit të të Rriturve (AES), me periodicitet 5 vjeçar. Për herë të parë, kjo anketë u zhvillua në vitin 2017.

Rezultatet e pritshme

- Prodhimi i treguesve cilësorë në fushën e arsimit dhe trajnimit;
- Zhvillimi i anketës së Arsimit të Rritur (AES);
- Zhvillimi i statistikave të formimit profesional të vazhdueshëm;
- Harmonizimi i metodologjisë dhe treguesve të arsimit dhe dërgimi i statistikave në Eurostat.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e formimit profesional dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës nuk janë zhvilluar plotësisht siç rregulloret përkatëse të Eurostat parashikojnë. Këto statistika bazohen në vrojtime si Anketa për Arsimin e Rritur, Anketa e Vazhdueshme e Trajnimit Profesional dhe Anketa e Forcës së Punës. Referuar Rregullores (KE) Nr. 452/2008 “Lidhur me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të arsimit dhe të mësuarit gjatë jetës”, statistikave të arsimit janë pjesërisht në përputhje me statistikave evropiane të kësaj fushe.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 452/2008 “Lidhur me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të arsimit dhe të mësuarit gjatë jetës”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

1.3 Arsimi dhe trajnimet	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Instutucionet Përgjegjës
Statistika të Regjistrimeve sipas Niveleve Arsimore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Diplomimeve sipas Niveleve Arsimore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Arsimit sipas Fushave të Studimit në Arsimin e Lartë	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Anketa e Arsimit të Rritur		x				VS	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burime administrative:

- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim

Vrojtmet Statistikore:

- Anketa e Forcës së Punës (LFS)
- Anketa e Arsimit të Rritur (AES)

1.4 SHËNDETËSIA

Përshkrimi

Statistikat e shëndetësisë përmbajnë të dhëna mbi shëndetin publik, shkaqet e vdekjeve, shpenzimet qeveritare në shëndetësi, si dhe statistika mbi shëndetin dhe sigurinë në punë. Objektivi kryesor i kësaj teme statistikore është të sigurojë të dhëna cilësore, të plota dhe të krahasueshme në fushën e shëndetësisë.

Situata aktuale

Plotshmëria e të dhënave shëndetësore sigurohet jo vetëm nga burimet administrative, por edhe nga anketat që INSTAT zhvillon, duke kontribuar me tregues në fushën e shëndetësisë. Zhvillimi i Anketës mbi Shëndetin dhe Demografinë në vitin 2018, pasuroi treguesit në këtë fushë.

Për të siguruar një kornizë të integruar, të qëndrueshme dhe të krahasueshme, për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore mbi shkaqet e vdekjeve sipas grupsëmundjeve kryesore, në vitin 2019, me propozim të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, Këshilli i Ministrave miratoi Klasifikimin Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe Problemeve të Lidhura me Shëndetin (ICD -10).

Në 2020 u zhvillua për herë të parë në kuadër të projekteve pilot, Anketa Evropiane e Shëndetit (EHIS) sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Eurostatit. Ky vërtetim do të bëjë të mundur sigurimin e të dhënave të krahasueshme për shëndetin publik, duke mbuluar elementë kryesorë si: statusin në shëndet, sëmundshmërinë, paaftësinë, përcaktuesit e shëndetit, kujdesin shëndetësor etj. Kjo anketë do të jetë tashmë pjesë e programit të ri 2022-2026 dhe do të kryhet sipas periodicitetit të përcaktuar nga Eurostat. Një fushë e cila mund të zhvillohet nëpërmjet programit të ri janë statistikat mbi ushqyerjen.

Rezultatet e pritshme

- Prodhimi i treguesve cilësorë në fushën e shëndetësisë;
- Zbatimi i klasifikimit ICD 10 për statistikën e shkaqeve të vdekjeve;
- Zhvillimi i statistikave mbi shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Vazhdimi i implementimit të anketave të dedikuara në fushën e shëndetësisë, si EHIS me periodicitet 6 vjeçar, MICS me periodicitet 6 vjeçar.

Përputhshmëria me *acquis*

INSTAT synon prodhimin e statistikave mbi shëndetin publik nëpërmjet anketës EHIS, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1338/2008 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi shëndetin publik si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë”.

Përafrimi i statistikave të shkaqeve të vdekjeve është pjesërisht në linjë me Rregulloren (KE) Nr. 328/2011 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi mbi shëndetin publik si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, të lidhura me shkaqet e vdekjeve”, pasi INSTAT ende përdor klasifikimin ndërkombëtar ICD-9. Klasifikimi ICD -10 është miratuar, por ende nuk është zbatuar. Kjo edhe për arsye të pandemisë, gjë që ka penguar zhvillimin e trajnimeve për personelin e institucioneve publike të përfshira. PSZ 2022-2026 parashikon zbatimin e plotë të ICD-10 gjatë kësaj periudhe.

Lidhur me statistikën e shpenzimeve në shëndetësi, mund të themi se ato nuk janë ende në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 2015/359 “Lidhur me shpenzimet dhe financimin e kujdesit shëndetësor”. Përafrimi i rregullores është parashikuar gjatë këtij pesëvjeçari.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 1338/2008 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi shëndetin publik si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 328/2011 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi mbi shëndetin publik si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, të lidhura me shkaqet e vdekjeve”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 2015/359 “Lidhur me shpenzimet dhe financimin e kujdesit shëndetësor”	I papërputhshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

1.4 Shëndetësia	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistika të shëndetit publik	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika mbi shkaqet e vdekjeve	x	x	x	x	x	BA	NSTAT
Statistika nga Anketa EHIS					x	VS	NSTAT
Statistika të shëndetit dhe sigurisë në punë			x	x	x	BA	NSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burime administrative:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Instituti i Shëndetit Publik
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Vrojtimet Statistikore:

- Anketa e Grupeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS)
- Anketa Evropiane e Shëndetit (EHIS)

1.5 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E KONSUMIT

Përshkrimi

Statistikat e Konsumit dhe statistikat e përdorimit të kohës sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri, si dhe të treguesve të tjerë bazuar në shpenzimet e konsumit. Të dhënat e konsumit llogariten bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF), e cila është një vërtetim statistikor që kryhet pranë NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jep një panoramë të qartë të situatës socio-ekonomike të tyre. Anketa është e harmonizuar me rekomandimet e Eurostat përsa i përket metodologjisë, përkufizimeve dhe klasifikimeve. Struktura e konsumit të NjEF bazohet në Klasifikimin e Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP).

Të dhënat e ABF përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve, si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Gjithashtu të dhënat e ABF përdoren për të pasuruar në mënyrë të vazhdueshme treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (6,7 dhe 11).

Statistikat mbi Përdorimin e Kohës (APK) ofrojnë informacione të detajuara mbi mënyrën e shpenzimit të kohës nga individët. Ajo mundëson dhënien e informacionit mbi punën e papaguar, aktivitetet jashtë vendit të punës dhe çështjet që lidhen me përshtatjen e punës dhe jetës familjare.

INSTAT synon të krijojë dhe të vendosë një traditë të re në kryerjen e vërtetimeve për përdorimin e kohës në nivel kombëtar në një perspektivë afatgjatë; të ndërtojë një grup treguesish standardë, në mënyrë që të vlerësojë se si shqiptarët shpenzojnë kohën e tyre.

Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës. Për herë të parë në Shqipëri matja e mirëqenies dhe treguesve të nivelit të jetesës dhe varfërisë me metodën e të ardhurave është kryer në vitin 2017. Burimi kryesor për prodhimin e statistikave mbi të ardhurat, përfshirjen sociale dhe nivelin e jetesës janë të dhënat e grumbulluara nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës. Metodologjia e përdorur për zhvillimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, si dhe për prodhimin e treguesve kryesorë bazohet në rregulloret dhe rekomandimet e Eurostatit. Në këtë mënyrë sigurohet ruajtja e krahasueshmërisë së indikatorëve me vendet e Evropës dhe vendet e tjera që së fundmi janë duke aplikuar anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC.

Ky aktivitet përfshin katër çështje kryesore:

- Rreziku për të qënë i varfër ose përjashtimi social;
- Shpërndarja e të ardhurave dhe varfëria monetare;
- Niveli i jetesës;
- Privimi material.

Situata aktuale

Statistikat e Konsumit dhe statistikat e Përdorimit të Kohës

Sa i përket *Statistikave të Konsumit*, në vitin 2018, u testua një ndryshim në metodologjinë e mbledhjes së të dhënave në ABF, me anë të së cilës u studiua efekti i ndryshimit të metodës së mbledhjes

së të dhënave nga 2 në 1 javë në ditarin e blerjeve/fletoren e vetëkonsumit. Gjatë ABF 2018 u mbledhën të dhëna me periudhë reference 1 javë për gjysmën e familjeve të kampionit dhe 2 javë për gjysmën tjetër. Për sa i përket ABF 2019, për të gjithë kampionin informacioni u mbledh në ditar me periudhë mbledhjeje të të dhënave 1 javore, rezultatet e së cilës u publikuan në Tetor 2020 së bashku me të dhënat e revizionuara të ABF 2018 pas zbatimit të metodologjisë së re. Në vitet në vijim, kampioni i ABF është rritur krahasuar me vitet e mëparshme, për shkak se do të studiohen dhe analizohen treguesit kryesorë të konsumit për bashkitë kryesore. Mbledhja e të dhënave realizohet me metodën PAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë.

Anketa mbi Përdorimin e Kohës (APK) aplikon udhëzimet e Eurostat-it për Studimet e Harmonizuara Europiane për Përdorimin e Kohës (HETUS). Informacioni për përdorimin e kohës mbledhet nëpërmjet një ditari me intervale kohore fikse (10 minutëshe), në të cilin personat e intervistuar vetëregjistrojnë përdorimin e kohës së tyre për dy ditë ditari, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Në ditar regjistrohet një aktivitet kryesor, një aktivitet paralel ose i njëkohshëm, vendi ku kryhet aktiviteti, mjetet e transportit dhe prania e personave të tjerë. Në vijim të procesit po përditësohen dhe përshtaten pyetësorët dhe materialet mbështetëse sipas rekomandimeve më të fundit të Eurostat.

Qëllimi kryesor i anketës mbi përdorimin e kohës është që të zhvillojë vlerësime përfaqësuese në rang kombëtar për mënyrën se si e ndajnë njerëzit kohën e tyre për aktivitetet e ndryshme të jetës, në publikime periodike me qëllim pasurimin e treguesve të kësaj fushe si dhe të OZHQ-ve.

Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, INSTAT ka publikuar rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Gjithashtu, të dhënat e këtyre viteve janë transmetuar, validuar dhe publikuar në Eurostat. Rezultatet e anketës janë publikuar në nivel kombëtar. Të dhënat e prodhuara janë të dhëna që i përkasin një viti (*cross-sectional*) dhe në vitin pasardhës ndryshon $\frac{1}{4}$ e kampionit. Duke përdorur të dhënat e kësaj ankete, është matur dhe vlerësuar indeksi i privimit material të fëmijëve, duke sjellë një risi në rajon në raportimin e këtij treguesi të rëndësishëm.

Rezultatet e pritshme

Statistikat e Konsumit dhe statistikat e Përdorimit të Kohës

- Kryerja një herë në dhjetë vjet e anketës për përdorimin e kohës;
- Krijimi i një baze të dhënash të dokumentuar në një format të aksesueshëm për gjenerimin e tabelave me rezultate të anketës sipas nevojave të përdoruesve;
- Shtesë treguesish statistikore gjinore;
- Publikimi, 279 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 279 ditë) i të dhënave përfundimtare/finale të ABF-së.

Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës

- Rindërtimi i të dhënave mikro bazuar në legjislacionin e ri dhe rekomandimet e Eurostatit për zhvillimin e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2021 e në vazhdim.
- Prodhimi i treguesve të rinj (longitudinal) që ka të bëjë me ndryshimet në nivel individual me kalimin e kohës, të vëzhguara në mënyrë periodike gjatë një periudhe 4 vjeçare.
- Publikimi i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të jetesës dhe në nivel 3 Rajonesh (NUTS 2).

- Analiza e treguesve që i përkasin një viti (cross-sectional) dhe treguesve longitudinal të vëzhguara gjatë një periudhe 4 vjeçare;
- Matja dhe raportimi i indeksit të privimit material të fëmijët;
- Ruajtja e krahasueshmërisë me vendet e BE-së dhe përditësimi me ndryshimet metodologjike të Eurostatit.
- Ndërtimi i një fushe të re të quajtur “Cilësia e Jetës” ku të përfshihen një sërë treguesish, si një kornizë gjithëpërfshirëse për matjen e mirëqenies nga Anketat Sociale dhe të dhënat Administrative;
- Botimi i një publikimi të veçantë me tregues që përshkruajnë cilësinë e jetës dhe situatën socio-ekonomike të popullsisë në vend.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e Konsumit dhe statistikat e Përdorimit të Kohës

Anketa e Buxhetit të Familjes kryhet bazuar në Marrëveshje Mirëkuptimi (gentlemen's agreement), ku secili shtet anëtar vendos objektivat, metodologjinë dhe frekuencën e kryerjes së vrojtimit. Bazuar në këtë marrëveshje, plotshmëria e të dhënave të ABF është në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara nga INSTAT.

Anketa e Përdorimit të Kohës kryhet bazuar në Marrëveshje Mirëkuptimi (gentlemen's agreement), ku secili shtet anëtar vendos objektivat dhe metodologjinë. Bazuar në këtë marrëveshje, plotshmëria e të dhënave të AKP është në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara nga INSTAT. APK bazohet në udhëzimet e Eurostat-it për Studimet e Harmonizuara Evropiane për Përdorimin e Kohës (HETUS). Në udhëzime janë përshkruar tërësisht konceptet e HETUS-it.

Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës Shqipëria

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës kryhet bazuar në rregulloren bazë të Komisionit Evropian Nr. 1177/2003 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës (EU-SILC)”, si dhe rregulloret shtesë që ndihmojnë në zbatimin e përvitshëm të kësaj ankete.

Plotshmëria e të dhënave të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në vendin tonë është në përputhje të plotë me rregulloret dhe rekomandimet e Eurostatit.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 1177/2003 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës (EU-SILC)”	I pjesshëm	I plotë

Aktivitetet statistikore

1.5 Të ardhurat dhe shpenzimet e konsumit	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistika nga Anketa e Nivelit të Jetesës	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistika mbi Cilësinë e Jetës				x	x	VS	INSTAT
Statistika nga Anketa e Buxhetit të Familjes	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistika nga Anketa e Përdorimit të Kohës			x			BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Vrojtime statistikore:

- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC);
- Anketa e Buxhetit të Familjes;
- Anketa e Përdorimit të Kohës

1.6 MBROJTJA SOCIALE

Përshkrimi

Mbrojtja Sociale përfshin të gjitha ndërhyrjet që bëjnë organet publike ose private për lehtësimin e familjeve dhe individëve nga barra e një grupi të caktuar rreziqesh ose nevojash me kusht që të mos ketë një marrëveshje individuale dhe as reciproke të njëkohshme midis tyre dhe familjeve ose individëve. Lista e rreziqeve dhe nevojave që mund të çojë në mbrojtje sociale me konvencion, është si vijon: kujdes për sëmundje/shëndet, paafësi, moshë e vjetër, të mbijetuarit, familje/fëmijë, papunësi, strehim, përjashtim social jo i klasifikuar diku tjetër.

Situata aktuale

INSTAT prodhon të dhëna në nivel vendi për përfituesit në skemën e sigurimeve shoqërore, përfituesit në skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar, përfituesit në pagesë papunësie si dhe përfituesit në kujdesin rezidencial dhe atë ditor në qendrat e kujdesit social. Gjithashtu INSTAT prodhon të dhëna të mbrojtjes sociale në nivel qarku me të dhëna kryesore të pensioneve, ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, të cilat publikohen çdo vit në Vjetarin Rajonal. Prodhimi dhe publikimi i statistikave të mbrojtjes sociale në faqen zyrtare të INSTAT është me periodicitet tremujor dhe vjetor, të organizuara në “Statistikat e Mbrojtjes Sociale”, “Vjetari Statistikor Rajonal”, “Burra dhe Gra në Shqipëri”.

Prej vitit 2019, u përfshi në planet vjetore të PSZ-së edhe sistemi ESSPROS (Statistikat e Integruara Evropiane të Mbrojtjes Sociale), i cili përbëhet nga një sistem bazë dhe nga 2 module:

Sistemi bazë përfshin të dhëna vjetore mbi të ardhurat, shpenzimet dhe përfitimet në fushën e mbrojtjes sociale sipas skemave të ESSPROS dhe gjithsej, të cilat shërbejnë si instrument për të analizuar dhe krahasuar flukset financiare në fushën e mbrojtjes sociale.

Modulet përmbajnë informacion shtesë statistikor mbi aspekte të veçanta të mbrojtjes sociale si Moduli i Përfituesit e Pensioneve dhe Përfitimet neto të mbrojtjes sociale.

Rezultatet e pritshme

Me zbatimin e plotë të sistemit ESSPROS, INSTAT do të bëjë të mundur prodhimin e indikatorëve plotësisht të përputhshëm me Sistemin e Intergruar Evropian të Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu, në zbatim të këtij Programi pritet:

- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera për përmirësimin e metodave të transmetimit të të dhënave të mbrojtjes sociale dhe të ESSPROS;
- Zgjerimi i numrit të institucioneve furnizuese me të dhëna administrative;
- Shtimi i treguesve të rinj të mbrojtjes sociale nga burimet ekzistuese të të dhënave administrative dhe i burimeve të reja furnizuese përfshirë ato me fokus fëmijët;
- Përgatitja e një publikimi të dedikuar mbi treguesit e mbrojtjes sociale;
- Klasifikimi i skemave të ESSPROS dhe i përfitimeve sociale, plotësimi i pyetësorit me të dhëna cilësore;
- Hartimi dhe plotësimi i modulit për përfituesit e pensione, sipas metodologjisë së ESSPROS.
- Krijimi i sistemit bazë të ESSPROS;
- Plotësimi i modulit për përfitimet neto të mbrojtjes sociale.

Përputhshmëria me *acquis*

Të dhënat e Sistemit të Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (ESSPROS) bazohen në Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 458/2007 “Mbi sistemin evropian të statistikave të mbrojtjes sociale”. Plotshmëria e të dhënave të ESSPROS në vendin tonë është duke u zhvilluar në mënyrë të tillë që brenda periudhës së parashikuar në këtë Program, të dhënat të jenë në përputhje të plotë me rregulloret dhe rekomandimet e Eurostat-it.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 458/2007 “Mbi sistemin evropian të statistikave të mbrojtjes sociale”	I papërputhshëm	I plotë

Aktivitetet statistikore

1.6 Mbrojtja sociale	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Statistikat të Mbrojtjes Sociale (nga të dhënat administrative)	X	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika mbi ESSPROS	X	x	x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burime administrative:

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.7 DREJTËSIA DHE KRIMI

Përshkrimi

Statistikat mbi drejtësinë dhe krimin pasqyrojnë të dhëna të detajuara dhe cilësore lidhur me sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri. Këto statistika bazohen në të gjitha hallkat e sistemit, me qëllimin kryesor sigurimin e një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbart kjo fushë për përdoruesit.

Situata Aktuale

Aktiviteti statistikor i drejtësisë dhe krimeve ka pasur përmirësime të ndjeshme ndër vite. Numri i treguesve të prodhuar është rritur ndjeshëm, të dhënat tashmë mblidhen në nivel të detajuar veprë penale (sipas neneve të Kodit Penal). INSTAT, për të siguruar një kornizë të qëndrueshme dhe të krahasueshme të statistikave, ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me institucionet kryesore si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Gjatë PSZ 2017-2021 u përgatit për herë të parë nga INSTAT një publikim i detajuar “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2018”.

Për të qenë në linjë edhe me rekomandimet e Eurostat/UNODC, në bashkëpunim me Komisionin Kombëtar për Nomenklaturën, gjatë këtij pesëvjeçari, INSTAT do të angazhohet për zbatimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për qëllime statistikore (ICCS). Kjo punë do të vazhdojë deri në realizimin e raportimit sipas këtij klasifikimi.

Rezultatet e pritshme

- Prodhimi i treguesve cilësorë dhe të krahasueshëm në fushën e drejtësisë dhe krimit;
- Prodhimi i treguesve cilësorë dhe të krahasueshëm për setin e zgjeruar të krimeve me interes në BE;
- Harmonizimi i definicioneve dhe rregullave të numërimit sipas ICCS;
- Formalizimi dhe zbatimi i Klasifikimit Ndërkombëtar ICCS;
- Llogaritja e koeficientëve kryesorë për kriminalitetin dhe personat e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale;
- Finalizimi i një Memorandumi Mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë;
- Hartimi i një publikimi të zgjeruar të treguesve në fushën e drejtësisë dhe krimit çdo 5 vite.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e drejtësisë dhe krimit bazohen në legjislacionin kombëtar dhe normat kombëtare të numërimit të veprave dhe personave në sistemin e drejtësisë. Kjo e bën të vështirë krahasueshmërinë e statistikave. Për këtë arsye, INSTAT po punon për formalizimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Statistikave të Krimeve për qëllime statistikore (ICCS), i cili do të sigurojë një kornizë për prodhimin e statistikave të krahasueshme.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Klasifikimi ndërkombëtar i krimeve për qëllime statistikore (ICCS)	I papërputhshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

1.7 Drejtësia dhe krimi	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistika të Kriminalitetit, Veprave Penale, Procedimeve Penale	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Personave të Dyshuar, të Pandehur dhe të Burgosur	X	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Personave të Dënuar dhe të Pafajshëm	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Zbatimi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (ICCS)	X	x	x	x	x	-	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimi i të dhënave

Burime administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Prokuroria e Përgjithshme
- Ministria e Drejtësisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

1.8 KULTURA

Përshkrimi

Statistikat e kulturës pasqyrojnë një dimension sa social dhe ekonomik. Objektivi kryesor është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm statistikor, duke ndjekur dhe zbatuar rekomandimet evropiane për prodhimin e statistikave të kulturës.

Situata aktuale

Për prodhimin e statistikave të kulturës, INSTAT i siguron të dhënat nga Ministria e Kulturës. Për këtë arsye, synohet forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, si institucioni përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave në kulturë. Duke konsideruar rekomandimet e Eurostatit, ku statistikave të kulturës prodhohen dhe derivohen nga anketat në fusha të ndryshme, në vitin 2021, INSTAT-i përgatiti për herë të parë publikimin vjetor “Statistikat e Kulturës 2020”, i cili përfshiu tregues të rinj nga anketat që ky institucion zhvillon. U shtuan modulet mbi punësimin në kulturë, edukimin kulturor, përdorimin e internetit për qëllime statistikore dhe shpenzimet publike në kulturë.

Rezultatet e pritshme

- Prodhimi i treguesve cilësorë duke u bazuar në burime administrative;
- Përmirësimi i infrastrukturës për mbledhjen e informacionit për statistikave të kulturës;
- Prodhimi i treguesve cilësorë kulturor duke u bazuar në anketat sociale dhe ekonomike që IN-STAT zhvillon;
- Zhvillimi i treguesve sipas përcaktimeve të Eurostatit;
- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së statistikave të sportit.

Përputhshmëria me *acquis*

INSTAT synon zhvillimin e statistikave të kulturës në përputhje të plotë me Rregulloren (EU) Nr. 1295/2013 “Mbi ndërtimin e programit të Evropës krijuese” brenda vitit 2026. INSTAT duhet të ndjekë dhe të konsultohet me metodologjinë e Eurostat për zhvillimin e statistikave në linjë me rregulloren.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
RRreg. e BE Nr. 1295/2013 “Mbi Evropën krijuese”	I pjesshëm	I plotë

Aktivitetet statistikore

1.8 Kultura	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Statistika të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Trashëgimisë Kulturore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Sportit			x	x	x	BA	INSTAT
Statistika të Kulturës nga Anketat Sociale në INSTAT	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistika të Kulturës nga Anketat Ekonomike në INSTAT	x	x	x	x	x	VS	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Prodhimi i statistikave të kulturës bazohet në burime administrative dhe anketat sociale dhe ekonomike që INSTAT zhvillon.

Burimet administrative:

- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve;
- Ministria e Ekonomisë dhe Financës;
- Vrojtimet statistikore;
- Anketa e Forcave të Punës lidhur me punësimin në kulturë, duke u bazuar në sektorët dhe profesionet kulturore;
- Anketa e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët lidhur me përdorimin e internetit për qëllime kulturore;
- Anketa e Çmimeve të Konsumit lidhur me indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit për mallrat dhe shërbimet kulturore.

2. STATISTIKAT EKONOMIKE

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: Statistikat Makroekonomike, Statistikat Financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe Statistikat e Ndërmarrjeve, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

2.1 STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE

Përshkrimi

Statistikat makroekonomike përfshijnë gamën e gjerë të treguesve ekonomiko – financiar, bazë për të treguar zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit, sjelljen dhe vendimmarrjen e ekonomisë si një e tërë. Ato janë shtylla për analizën e stabilitetit ekonomik dhe financiar, si dhe monitorimin e efekteve të politikës monetare. Sistemi Kombëtar Statistikor i ofron përdoruesve tregues kryesorë dhe informacion bazë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Situata Aktuale

Llogaritë Kombëtare luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe janë baza e informacionit për të treguar zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

Baza metodike e të dhënave synohet të jetë e harmonizuar me Rregulloren (KE) të Sistemit Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010), i cili është version evropian i Sistemit të Llogarive Kombëtare në nivel botëror (SNA-2008). Rregullorja përfshin një metodologji të përbashkët përsa i përket standardeve, përkufizimeve, klasifikimeve dhe rregullave të llogaritjes që duhen përdorur nga vendet e BE-së, apo vendet që aderojnë për të qenë pjesë e BE-së, për përpilimin e llogarive dhe tabelave në baza të krahasueshme. Gjithashtu, ajo siguron dhe një program për transmetimin e të dhënave dhe tabelave sipas afateve dhe kërkesave të mirëpërcaktuara.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë një punë intensive në fushën e statistikave të Llogarive Kombëtare për rritjen e nivelit të përputhshmërisë me ESA 2010, konkretisht në përmirësime metodologjike apo edhe në shtimin e treguesve të rinj. Projekte të ndryshme IPA shumë-përfituese, nga BE dhe jo vetëm, kanë ndihmuar në zhvillimin e Llogarive Kombëtare dhe do të vazhdojnë të japin asistencë teknike deri në implementimin e plotë të saj.

Rezultatet e Pritshme

Harmonizimi i mëtejshëm i Llogarive Kombëtare me standardet e BE-së dhe programin e transmetimit ESA 2010.

- Zgjerimi i statistikave makroekonomike me qëllimin plotësimin e kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve kryesorë dhe publikut të gjerë. Bashkëpunimi me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, për përditësimin dhe mbështetjen më të mirë me burime e të dhëna administrative.
- Zbatimi i mëtejshëm i Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010 në përpilimin e treguesve të

Llogarive Kombëtare, në terma vjetorë dhe tremujorë. Në mënyrë të vazhdueshme do të zgjerohet mbulimi dhe cilësia e statistikave të Llogarive Kombëtare për t'i ardhur në ndihmë monitorimit të politikave ekonomike;

- Zgjerimi i programit të transmetimit të të dhënave në Eurostat në terma të shtimit të numrit të tabelave dhe përmirësimit të afateve kohore, me synim rritjen e nivelit të krahasueshmërisë me vendet e tjera të Bashkimit Evropian;
- Zbatimi i platformës SDMX-R në transmetimin e tabelave të Llogarive Kombëtare, sipas programit të transmetimit ESA 2010;
- Në vitin 2024 parashikohet të zhvillohet Revizionimi madhor i Llogarive Kombëtare, i cili do të përfshijë të gjithë përmirësimet metodologjike në kuadër të Programeve Shumë-përfituese IPA. Ky proces do të përfshijë gjithashtu përgatitjen e Inventarit GNI sipas rekomandimeve të udhëzuesit të Eurostatit, si pjesë e listës së kritereve të detyrueshme për tu plotësuar për anëtarësim në BE;
- Përpilimi dhe publikimi i sekuencës së plotë të Llogarive jofinanciare vjetore (duke filluar nga Llogaria e Prodhimit e deri te huamarrja neto), sipas sektorëve institucionalë, duke aplikuar në mënyrë të kombinuar metoda balancuese, në koherencë të plotë me konceptet e ESA2010 (SNA 2008);
- Integrimi i plotë i sistemit të tabelave Burime-Përdorime dhe Input-Output në Sistemin e Llogarive Kombëtare, në vlerësimin final të PBB-së me çmime korrente dhe çmimet e vitit të mëparshëm, duke eliminuar mospërputhjet statistikore që ekzistojnë ndërmjet metodave të vlerësimit dhe duke përmirësuar matjet në volum dhe në çmim të Llogarive Kombëtare nëpërmjet procesit të deflatimit të dyfishtë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i treguesve të Llogarive Rajonale dhe zgjerimi me tregues të rinj si: Formimi Bruto i Kapitalit Fiks sipas rajoneve statistikore, Të Ardhurat e Familjeve sipas rajoneve statistikore si dhe Punësimi sipas rajoneve statistikore;
- Bashkëpunimi ndërsektorial brenda INSTAT (Statistikat Makroekonomike, Statistikat e Biznesit, Statistikat Bujqësore dhe Sociale, regjistrat dhe klasifikimet, Drejtoria e IT-së etj.) për një zbatim të koordinuar të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare (ESA 2010 / SNA 2008), me qëllimin kryesor prodhimin dhe publikimin e të dhënave statistikore në linjë me detyrimet që i lindin Shqipërisë nga Programi i Transmetimit ESA 2010;
- Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve teknike të punonjësve nëpërmjet trajnimeve, pjesëmarrjeve në takime, seminare apo workshop-e të organizuara nga INSTAT, Eurostat dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Përputhshmëria me *acquis*

- Llogaritë Kombëtare janë elementi kryesor i statistikave makroekonomike. Ato duhet të jenë të harmonizuara me standardet evropiane në drejtim të cilësisë, periodicitetit dhe konsistencës, duke ofruar një bazë të qëndrueshme të dhënash jo vetëm për politikëbërjen në nivel vendi por edhe në atë evropian.
- Shqipëria, nën asistencën e Eurostatit, ka rritur në mënyrë të ndjeshme nivelin e përputhshmërisë së statistikave të Llogarive Kombëtare.
- Mbështetur në Programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostatit vlerëson mesatarisht të përputhshëm nivelin e implementimit të ESA 2010 në Llogaritë Kombëtare.
- Me kryerjen e Revizionimit Madhor të treguesve të Llogarive Kombëtare, i parashikuar në vitin 2024, synohet rritja e nivelit të përputhshmërisë me setin e rregulloreve për tu zbatuar në sistemin e Llogarive Kombëtare.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Sistemi evropian i llogarive 2010	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

2.1 Statistikat Makroekonomike	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Instutucionet Përgjegjës
Llogaritë Jo-financiare sipas Sektorëve Institucionalë	x	x	X	x	x	VS+BA	INSTAT
Llogaritë Kombëtare Tremujore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me Metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve	x	x	X	x	x	VS+BA	INSTAT
Llogaritë Kombëtare Vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me Metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve	x	x	X	x	x	VS+BA	INSTAT
Tabelat Burim – Përdorime	x	x	X	x	x	BA	INSTAT
Tabelat Input - Output		x				BA	INSTAT
Llogaritë Rajonale	x	x	X	x	x	VS+BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet administrative:

- INSTAT
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Banka e Shqipërisë
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Të dhënat nga institucionet e tjera mbi pasqyrat financiare të njësive ekonomike, statistikave fiskale të qeverisë, statistika monetare dhe financiare të sistemit financiar.
- Vrojtimit statistikore:
- Vrojtimit pranë njësive ekonomike bujqësore dhe jo-bujqësore, familjeve dhe tregues të tjerë ekonomiko-socialë

2.2 STATISTIKAT FINANCIARE TË QEVERISË, FISKALE DHE TË SEKTORIT PUBLIK

Përshkrimi

Statistikat financiare të qeverisë mbulojnë të dhënat financiare dhe jofinanciare lidhur me shpenzimet, të ardhurat dhe financimet qeveritare. Këto të dhëna aprovohen nga Parlamenti çdo vit, raportohen me frekuencë mujore, tremujore, vjetore dhe publikohen të detajuara çdo muaj për përdorues të ndryshëm. Statistikat Financiare të Qeverisë në Shqipëri përpilohen nga Ministria e

Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. Statistikat Monetare dhe Financiare përpilohen dhe publikohen nga Banka e Shqipërisë.

Situata Aktuale

Ministria e Financave dhe Ekonomisë përpilon dhe publikon çdo vit Statistikat e Financiare të Qeverisë në përputhje me “Manualin e Statistikave të Financave të Qeverisë 2014 (GFSM 2014)”. Statistikat përfshijnë vetëm njësitë buxhetore të konsolidimit të detajuar të qeverisë së përgjithshme sipas nënsektorëve: Qeveria Qëndrore, Qeveria Lokale dhe Fondet e Sigurimeve.

INSTAT ka bërë përpjekje intensive për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë duke ndjekur metodologjinë e ESA 2010. Statistikat përfshijnë njësitë buxhetore dhe njësitë ekstra-buxhetore të sektorit të qeverisjes së përgjithshme (S.13) sipas nënsektorëve: Qeveria Qendrore (S.1311), Qeveria Lokale (S.1313) si dhe Fondet e Sigurimeve (S.1314).

Mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet institucioneve përgjegjëse është mundësuar përpilimi i Statistikave Financiare të Qeverisë dhe transmetimi në mënyrë periodike i tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP – angl.) në Eurostat.

Në këtë kuadër bashkëpunimi, vitet e fundit nën asistencën teknike të Eurostat dhe FMN-së është mundësuar krijimi i tabelave të korespondencës ndërmjet llogarive të qeverisë duke i klasifikuar ato bazuar në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe Manualit të Statistikave Financiare të Qeverisë (GFSM 2014), si dhe është realizuar integrimi i të dhënave në seri kohore në sistemin e ndërtuar për këtë qëllim.

Gjithashtu, për treguesit monetarë dhe financiarë është punuar në drejtim të zhvillimit të metodologjisë dhe hartimit të statistikave të normave të interesit, sipas kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe përshtatja e treguesve të rinj statistikorë, në përputhje me kërkesat dhe standardet e raportimit të institucioneve përkatëse Evropiane (ECB, Eurostat, etj.).

Rezultatet e Pritshme

- Harmonizimi i mëtejshëm i Statistikave Financiare të Qeverisë, Procedurës së Deficitit të Tejkualuar me standardet e BE-së dhe programin e transmetimit ESA 2010.
- Përpilimi dhe publikimi i Llogarive financiare vjetore sipas Sektorëve Institucionalë, gjendje dhe flukse, në koherencë të plotë me konceptet e ESA2010 (SNA 2008);
- Përpilimi dhe publikimi i treguesve monetarë dhe financiarë, në koherencë të plotë me standardet Evropiane (ECB, Eurostat, etj.).
- Zgjerimi i bazës së të dhënave për njësitë ekstra – buxhetore dhe integrimi i tyre në sistemin e të dhënave të Qeverisë së Përgjithshme;
- Integrimi i të gjithë njësive të Qeverisë së përgjithshme në sistemin AGFIS dhe përpilimi i bilancit të llogarive të Qeverisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Llogarive të Sektorit Publik (IPSAS);
- Konsolidimi i të dhënave të njësive buxhetore dhe ekstra – buxhetore;
- Përmirësime metodologjike në vlerësimin dhe transmetimin e setit të plotë të tabelave të Statistikave Financiare të Qeverisë (GFS – eng.) dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP – eng.).

Përputhshmëria me *acquis*

Mbështetur në Programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostat-i vlerëson mesatarisht të përputhshëm nivelin e implementimit të ESA 2010 në Llogaritë Financiare të Qeverisë.

Në pesë vitet e ardhshme synohet të punohet në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së kuadrit ligjor si dhe të intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim përpilimin e tabelave të Statistikave Financiare të Qeverisë (GFS – angl.) dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP – angl.) sipas standardeve Evropiane.

Statistikat monetare hartohen në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare bazuar në Manualin e Statistikave Monetare dhe Financiare, FMN 2016 dhe Manualin e Statistikave të Institucioneve Monetare Financiare, BQE, 2019.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Sistemi evropian i llogarive 2010	I pjesshëm	I pjesshëm
Manuali dhe guida e kompilitimit të statistikave financiare dhe monetare, FMN, 2016	I plotë	I plotë
Manualin e statistikave të institucioneve monetare financiare, BQE, 2019	I plotë	I plotë

Aktivitetet statistikore

2.2 Statistikat Financiare të Qeverisë, Fiskale dhe të Sektorit Publik	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Llogaritë Financiare sipas Sektorëve Institucionalë	x	x	x	x	x	BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat Monetare dhe Financiare	x	x	x	x	x	BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë	x	x	x	x	x	BA	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Statistikat e Borxhit të Sektorit Buxhetor të Qeverisë dhe Borxhit të Garantuar	x	x	x	x	x	BA	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010	x	x	x	x	x	BA	INSTAT, Banka e Shqipërisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

- Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) – Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Sistemi i Analizës Financiare të Menaxhimit të Borxhit (SAFMB) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Të dhënat nga institucionet e tjera mbi pasqyrat financiare dhe bilancin kontabël të njësive ekonomike të klasifikuara pjesë e sektorit publik, statistikat fiskale të qeverisë, statistika monetare dhe financiare të sistemit financiar, etj.

- Banka e Shqipërisë, Bankat e nivelit të dytë, Shoqëritë Kursim – Kreditit, Institucionet Jo-ban-ka, kompanitë e sigurimit, fondet e pensionit, fondet e investimeve dhe institucioneve të tjera financiare.

2.3 STATISTIKAT E BIZNESIT

Përshkrimi

Statistikat e Biznesit përfshijnë Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve, Statistikat e Produkteve Industriale (PRODCOM), Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve dhe Statistikat e Regjistrave të Biznesit.

Statistikat e biznesit janë pjesërisht në përputhje me rregulloren e re Nr. 2019/2152 (të KE), e cila ka filluar implementimin në Janar 2021, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Situata Aktuale

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore me vërtetim vjetor. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht formës ligjore të tyre.

Të dhënat paraprake publikohen 11 muaj pas vitit të referencës; të dhënat finale publikohen 14 muaj pas vitit të referencës në botimin e veçantë “Rezultate të Përgjithshme të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve”, në Vjetarin Statistikor dhe faqen elektronike të INSTAT-it.

Rezultatet publikohen në nivel kombëtar, sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes. Gjithashtu, INSTAT prodhon dhe Statistika Strukturore të Ndërmarrjeve sipas rajoneve, të cilat kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike të tyre.

Prej vitit 2018, mbledhen dhe përpunohen të dhënat për prodhimin e Statistikave të Produkteve Industriale (PRODCOM). Statistikat PRODCOM janë vlerësuar vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk janë publikuar dhe transmetuar në Eurostat. Për përmirësimin e cilësisë së të dhënave nevojitet zhvillimi i infrastrukturës së duhur statistikore për prodhimin e këtyre statistikave.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore. Gjatë viteve të fundit të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe vërtetimit tremujor. Statistikat Afatshkurtra përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht formës ligjore të tyre.

Të dhënat publikohen 60 ditë pas mbylljes së tremujorit referencë për Lejet e Ndërtimit dhe 75 ditë për Statistikat Afatshkurtra. Prej vitit 2018, të dhënat transmetohen rregullisht me bazë tremujore për disa tregues kryesorë dhe raportet e cilësisë për të gjithë anekset e Statistikave Afatshkurtra të Ndërmarrjeve.

INSTAT mirëmban dhe është përgjegjës për përditësimin e regjistrave të biznesit.

Regjistrat përditësohen dhe mirëmbahen me burimet administrative dhe statistikore.

Ky regjistër është baza kryesore për prodhimin e statistikave rajonale.

- I. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, që kryejnë veprimtari ekonomike, duke kontribuar në prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Regjistrat përditësohen dhe mirëmbahen me burimet administrative dhe statistikore. Raporti i cilësisë ESQRS (Struktura Standarde e Raportit të Cilësisë ESS) botohet dhe transmetohet çdo vit në Eurostat.
- II. Regjistri Statistikor i Njësive Lokale është ndërtuar në vitin 2010 dhe përditësohet çdo vit.
- III. Për shkak të globalizimit, krahasueshmëria ndërkombëtare e të dhënave statistikore është bërë shumë e rëndësishme. Regjistri i Grupeve të Ndërmarrjeve dhe Grupet e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe (MNE) është ndërtuar dhe mirëmbahet prej vitit 2018.

INSTAT llogarit dhe publikon çdo tre muaj Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP), Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇI) dhe Indeksin e Kostos në Ndërtim (për Banesa) (IKN), të cilët matin ndryshimin e çmimeve të prodhimit, importit dhe ndërtimit për një shportë të caktuar artikujsh në periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër e konsideruar si periudha bazë. Periudha bazë e llogaritjes së indekseve është viti 2020, (Viti 2020=100) (për IKN është tremujori i katërt 2020). Indekset IÇP dhe IÇI llogariten dhe publikohen duke përdorur Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2). Për llogaritjen e këtyre indekseve INSTAT mbledh dhe përpunon çmimet e artikujve me vrojtim tremujor nëpërmjet intervistës së drejtëpërdrejt me anketues. Vrojtimi kryhet në ndërmarrjet e përzgjedhura për këto vrojtime.

Të dhënat transmetohen në Eurostat rregullisht me bazë tremujore. Raportet e cilësisë përditësohen, transmetohen dhe publikohen çdo vit.

INSTAT aktualisht nuk llogarit Statistikat e Indeksit të Kostos në Ndërtim për Punime Inxhinierike dhe Indekset e Çmimeve të Shërbimeve, por do të punojë për llogaritjen e Statistikave të Indeksit të Kostos në Ndërtim për Punime Inxhinierike dhe Indekset në vitin 2023 duke iu shtuar statistikave të indeksit të Kushtimit në Ndërtim. Për Indeksin e Çmimeve të Shërbimeve, me asistencë të ekspertëve të IPA shumë-përfituese, është studiuar metodologjia dhe burimet e mundshme të të dhënave për implementimin e këtyre statistikave dhe planifikohet të përfshihet në vitin 2023 si pjesë e statistikave të INSTAT.

Rezultatet e Pritshme

- Gjatë këtij 5 – vjeçari do të fokusohemi në përshtatjen dhe zbatimin e aktiviteteve të statistikave të biznesit në përputhje me rregulloren e re Nr. 2019/2152 (të KE). Në këtë kuadër pritet:
- Përmirësimi dhe arritja e një përputhshmërie të plotë me rregulloret e BE-së, duke ndërtuar regjistra të biznesit dhe duke prodhuar statistika të nevojshme për dhënien e indikatorëve afat-shkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike.
- Përdorimi i teknologjive të reja si web form, CAPI etj;
- Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor Vrojtim dhe Burim administrativ;
- Kalimi nga niveli 2-shifror në nivelin 3 dhe 4-shifror të NVE Rev.2 për krijimin e kampionit të vrojtimeve ekonomike;
- Krijimi i skedarit me informacionin e ASN-së dhe Regjistrat të Njësive Lokale;
- Vrojtimi i Listës së Produkteve Industriale (PRODCOM), duke u mbështetur në kërkesat e

- rregulloreve evropiane;
- Tregues të rinj statistikorë dhe përmirësimi i cilësisë së regjistrave të biznesit dhe të grupeve të biznesit.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e biznesit janë pjesërisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 2019/2152 “Mbi statistikën evropiane të biznesit” dhe të tjerat zbatuese të saj, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime.

Projekte të ndryshme IPA shumë-përfituese, kanë ndihmuar në zhvillimin e statistikave të biznesit. Megjithatë, nevojitet akoma asistencë teknike deri në implementimin e plotë të rregullores së re të statistikave evropiane të biznesit.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 2019/2152 “Mbi statistikën evropiane të biznesit”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

2.3 Statistikat e Biznesit	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Produkteve Industriale	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT
Statistikat e Çmimeve në Ndërmarrjet Ekonomike në nivel tremujor	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistika mbi Lejet e Ndërtimit të Miratuara në Territorin e Republikës së Shqipërisë	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT
Regjistri i Njërive Lokale	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT
Regjistri i Grupeve të Ndërmarrjeve	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimev
- Qendra Kombëtare e Biznesit

- Institucionet e vetëqeverisjes vendore, (Bashkitë)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Departamenti i Administratës Publike
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Banka e Shqipërisë

Vrojtimet Statistikore:

- Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
- Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve
- Anketa e Produkteve Industriale
- Anketa e Regjistrimit të Ndërmarrjeve

3. STATISTIKAT SEKTORIALE

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikën e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikën e energjisë, transportit, turizmit, statistikën mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikën e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

Qëllimi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

3.1 BUJQËSIA PYJET DHE PESHKIMI

Përshkrimi

Statistikat e Pyjeve sigurojnë të dhëna të përgjithshme dhe specifike mbi pyjet, kullotat dhe livadhet. Këto të dhëna janë vjetore, në nivel kombëtar. Institucionet përgjegjëse për të grumbulluar këto të dhëna janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Qëllimi i nëntemës së *Statistikave të Produkteve Bimore* lidhet me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave të prodhimit bimor, metodat e prodhimit bimor dhe prodhimet organike. Statistikat e prodhimit bimor japin informacion për drithërat, bimët industriale, rrënjoret, fasulet, perimet, të tjera bimë të arave, frutat, agrumet, ullirin dhe vreshtat. Të dhënat për kulturat e para dhe të dyta mbledhen, përpunohen dhe vlerësohen si në fushë të hapur ashtu dhe në serra. Për prodhimin e statistikave të prodhimit bimor përdoren burime të kombinuara administrative dhe vrojtme të drejtpërdrejta në terren me anketues, si dhe metoda të kombinuara llogaritjeje, të drejtpërdrejta dhe me vlerësim. Statistikat e bimëve përfshijnë statistikën e bimëve të arave (grurë, misër, elb, thekër, tërshërë), sipërfaqe, prodhim dhe rendiment.

- *Statistikat e bimëve të tjera të arave:* patate, fasule, bimë industriale (luledielli, sojë dhe duhan) si dhe bimët foragjere (misër foragjer, jonxhë dhe të tjera foragjere që kositen të gjelbra).
- *Statistikat e perimeve:* perime në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe dytë.
- *Statistikat e drufrutorëve:* pemët frutore, agrumet, ullinjë, rrushi dhe fidanishtet e drufrutorëve.

Të dhënat janë vjetore: Sipërfaqja shprehet në *ha*, rendimenti në *kg/ha*, prodhimi në *ton* dhe lagështia në %. Për pemëtoret në blloqe, të dhënat janë në *ha* dhe në *numër rrënjësh*, ndërsa për pemët e shpërndara, e dhëna është vetëm në *numër rrënjësh*.

Nëntema e *Statistikave të Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve* ka si qëllim të sigurojë të dhëna të harmonizuara rajonale dhe kombëtare lidhur me strukturën e blegtorisë, prodhimin e mishit dhe të vezëve me ato të BE-së. INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën e blegtorisë, mishit dhe vezëve duke shfrytëzuar burimet administrative si dhe vrojtmet statistikore pranë njësive ekonomike blegtorale dhe ndërmarrjeve ekonomike bujqësore. Për prodhimin e statistikave të kësaj natyre, INSTAT mbledh të dhëna në lidhje me therjet e shpendëve dhe prodhimin e vezëve në fermë nëpërmjet vrojtimit vjetor në bujqësi, si dhe të dhëna lidhur me tregtinë e jashtme të shpendëve.

Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij përfshijnë statistikën në nivel rajonal dhe kombëtar në lidhje me prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit nga lopët, delet dhe dhitë. Të dhënat grumbullohen me frekuencë mujore dhe vjetore në ndërmarrjet e përpunimit të qumështit dhe baxhot, të cilat blejnë qumësht të papërpunuar direkt nga fermat ose pikat e grumbullimit,

sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave. INSTAT aktualisht ka fokus përmirësimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave, përpunimin, analizat cilësore dhe shpërndarjen e të dhënave, si dhe përditësimin e metadateve (raporteve të cilësisë).

Statistikat Strukturore të Fermës luajnë një rol të rëndësishëm në implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të përbashkëta bujqësore. Vrojtimi i strukturës së fermës (*Censi i Bujqësisë*) dhe vrojtimit e ndërmjetme me kampion janë shtylla të sistemit statistikor bujqësor. Bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet Vrojtimit të Strukturës së Fermave sintetizohen tregues me anën e të cilëve përcaktohet tipologjia e fermave bujqësore në të gjitha degët e saj, si dhe madhësia ekonomike e tyre. Struktura e fermave bujqësore përfshin të gjitha llojet e organizimit të fermave bujqësore, blegtorale, mikse apo çdo lloj tjetër organizimi që plotëson definicionin për të qenë njësi ekonomike bujqësore. Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë regjistrimet e bujqësisë dhe vrojtimit e strukturës së fermave, 2-3 vrojtme në periudhën 10 vjeçare midis dy Censesve. Objekt vrojtimi për strukturën e bujqësisë do jenë të gjitha njësitë ekonomike bujqësore që kryejnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në periudhën pesëvjeçare 2022-2026 parashikohet të realizohet Censi i Bujqësisë, duke shfrytëzuar informacionin e mbledhur gjatë Censit të Popullsisë dhe Banesave lidhur me ndërtimin e kornizës së Njësiive Ekonomike Bujqësore që do të jenë fokus i tij. Censi i Bujqësisë (i parashikuar nga INSTAT të kryhet në vitin 2024) është prioritet kryesor lidhur me përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj. Përditësimi i regjistrimit statistikor të fermave dhe përgjithësimi i rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar do të bazohet në kriteret metodike të rekomanduara nga Eurostat.

Vrojtimi i Strukturës së Fermave është një vrojtme i gjerë statistikor i planifikuar, organizuar dhe zbatuar duke u mbështetur në kritere të përcaktme shkencore e bashkëkohore, për grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave. Vrojtme ofron të dhëna mikro për aspektet e përgjithshme, të tilla si: struktura e tokës, blegtoria, fuqia punëtore bujqësore dhe aktivitete të tjera fitimprurëse, masat e zhvillimit rural, makineritë dhe pajisjet, ujitja, strehimi i kafshëve dhe administrimi i plehut organik, menaxhimi i tokës, vreshtat dhe drufrutorët. Këto të dhëna janë baza statistikore për statistikë të tjera mbi përdorimin e tokës, të ardhurat nga blegtoria dhe bujqësia.

Për nëntemën e *Llogarive Ekonomike në Bujqësi* synohet sigurimi dhe prodhimi në kohë i Llogarive Ekonomike të Bujqësisë mundësuar në sajë të zbatimit të koncepteve, parimeve dhe rregullave bazë për përpilimin e llogarive të përcaktuara në Manualin mbi Llogaritë Ekonomike të Bujqësisë (angl.-EAA). Klasifikimi i aktivitetit bujqësor është bërë në përputhje me Klasifikimin Evropian NVE Rev2. Sigurimi dhe prodhimi në kohë i çmimeve absolute të prodhimit dhe inputeve për llogaritjen e indekseve të bujqësisë është mundësuar në sajë të zbatimit të koncepteve dhe rregullave bazë sipas Manualit për Statistikat e Çmimeve Bujqësore. Sistemi i llogarive të integruara ekonomike duhet të sigurojë një pasqyrë të aktiviteteve ekonomike, që është e krahasueshme në mënyrë sistematike dhe sa më të plotë, për të shërbyer si bazë për analiza, parashikime dhe masa politike.

Qëllimi i *Indeksit të Çmimeve* është të japë informacion mbi ecurinë e çmimeve të produkteve bujqësore të prodhuesve dhe çmimin e blerjes së mjeteve për prodhimin bujqësor. Mjetet bazë për matjen e ndryshimeve të çmimeve dhe ecurinë e çmimeve janë çmimet absolute bujqësore nga njëra anë dhe indekset e çmimeve bujqësore nga ana tjetër. Përdorimi kryesor i çmimeve absolute bujqësore shërben për të krahasuar nivelet e çmimeve midis shteteve dhe për të studiuar zhvillimet e çmimeve dhe ndikimin mbi të ardhurat bujqësore. Indeksi i çmimeve bujqësore tregon ecurinë e çmimeve sipas muajve dhe sezonit. Çmimet mbledhen sipas vrojtmeve mujore dhe tremujore për produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe Inputet. Çmimet e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale mbledhen rregullisht çdo muaj.

Llogaritë Ekonomike të Bujqësisë dhe Statistikat e Çmimeve Bujqësore luajnë një rol kyç në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të përbashkëta bujqësore si dhe në vlerësimin e PBB-së dhe gjendjes ekonomike të bujqësisë në vend. Llogaritë ekonomike në bujqësi janë llogari satelitore që furnizojnë llogaritë kombëtare me informacione shtesë dhe koncepte që i përshtaten natyrës së veçantë të “industrisë” të bujqësisë dhe pylltarisë. Vlerësimet për mbjelljet e reja në pemëtari për llogaritjen e *Formimit Bruto të Kapitalit Fix* bëhen nga të dhënat statistikore, por dhe nga të dhënat administrative të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat statistikore kanë shërbyer si një burim kryesor për llogaritjen tremujore dhe vjetore të llogarive ekonomike në bujqësi.

Lidhur me *Statistikat e Peshkimit* qëllimi është të sigurohen të dhëna të harmonizuara në lidhje me aktivitetin e peshkimit si: statistikave të zënies së peshkut sipas porteve, numri i anijeve të peshkimit sipas porteve dhe llojit të peshkimit, si dhe statistikave të akuakulturës si degë në zhvillim, ku përfshihet dhe prodhimi i molusqeve. Përsa i takon statistikave zyrtare të peshkimit, programi përqendrohet në përshtatjen e nevojave në përputhje me plotësimin e kërkesave në rritje në lidhje me të dhënat e peshkimit dhe akuakulturës. Rekomandimet e Eurostat për peshkimin lidhen me zbatimin e rekomandimeve të FAO-s dhe kryesisht për të dhënat e zënies së peshkut nga peshkimi detar, sipas porteve. Zbatimi i standardeve, koncepteve dhe përkufizimeve të rekomanduara nga FAO jepen në manualin e Standardeve të Statistikave të Peshkimit, i cili do të jetë bazë për harmonizimin e statistikave shqiptare të peshkimit me ato të BE-së. Ndërkohë, zbatimi i Rregullores (KE) Nr. 762/2008 për akuakulturën do të sigurojë të dhëna mbi prodhimin e peshkut dhe të molusqeve, si dhe mbi strukturën e ndërmarrjeve prodhuese të tyre.

Të dhënat për prodhimin e *Statistikave të Prodhimeve Organike në Bujqësi* mblidhen nga trupat certifikuese, të cilat grumbullojnë të dhëna për fermat organike të certifikuara dhe ato në proces certifikimi si: për prodhimin bimor, blegtoral, akuakulturën dhe produktet e përpunuara bimore dhe shtazore. Certifikimi i fermave organike nga trupat e certifikimit bazohet në legjislacionin shqiptar, i cili është në proces hartimi dhe miratimi, duke iu përshtatur dhe Rregullores së Këshillit të BE Nr 834/2007, 28 Qershorit 2007 mbi Produktet Organike dhe Etiketimin e Produkteve Organike.

Statistikat e Agromjedisit ofrojnë informacion mbi ndikimin e aktiviteteve bujqësore në mjedis.

Situata aktuale

Statistikat e Pyjeve janë të dhënat administrative kadastrale të fondit pyjor dhe kullotat në Shqipëri. Ato i referohen si fondit pyjor bashkiak, ashtu dhe atyre private, strukturës së këtij fondi, formave të mbarështimit, kundërvajtjeve në pyje dhe kullota, shfrytëzimit të pyjeve dhe produkteve kryesore të pyllit. Sa i përket *statistikave të produkteve bimore*, të dhënat administrative merren me periodicitet vjetor, brenda muajit Prill të vitit pasardhës, në nivel vendi, rajoni dhe bashkie. Të dhënat janë gjithpërfshirëse për të gjithë aktivitetin bujqësor që ushtrohet në vend dhe të nevojshme për përpunim dhe publikimin e statistikave të prodhimit bimor. Publikimi i statistikave të prodhimit bimor bëhet brenda muajit Korrik të vitit pasardhës në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe në botimet e dedikuara “Vjetari Statistikor i Bujqësisë”, “Vjetari Rajonal” dhe “Vjetari Statistikor” - kapitulli *Bujqësia*. Të dhënat e publikuara janë në nivel vendi, rajoni dhe bashkie.

Vrojtimit kryhen nga INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Vrojtimit kanë periodicitet vjetor dhe në kampionim përfshihen të gjithë personat fizikë apo juridikë që ushtojnë aktivitet bujqësor. Vrojtimi vjetor pranë Njësisë Ekonomike Bujqësore (Njësitë Ekonomike Blegtoriale) siguron informacion lidhur me strukturën e blegtorisë sipas Rregullores

(KE) Nr. 1165/2008, Aneksi II, dhe harmonizimi i përkufizimeve të kategorive statistikore të blegtorisë, Aneksi I. Prodhimi i mishit llogaritet nëpërmjet të dhënave nga burimi administrativ dhe vrojtimi statistikor vjetor në fermat blegtorale, ku grumbullohet informacion për numrin e kafshëve të therura gjatë vitit kalendarik, pesha mesatare e gjallë dhe pesha mesatare e therur sipas kategorive të kafshëve, si dhe nga anketat mujore në thertore. Statistikat e therjeve janë të harmonizuara dhe prodhohen bazuar në Rregulloren (KE) Nr. 1165/2008, Aneksi IV. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, gjatë këtij pesëvjeçari do të zbatohen përkufizimet sipas Aneksit I. Parashikimi i prodhimit të mishit (për konsum njerëzor), do të llogaritet duke shfrytëzuar të dhënat statistikore të marra nga vrojtimet statistikore për blegtorinë, therjet, tregtinë e jashtme të kafshëve të gjalla dhe burime të tjera informacioni. Për shpendët grumbullohen të dhëna mujore dhe vjetore në lidhje me numrin e shpendëve të therur në thertore dhe për prodhimin e vezëve nga fermat e shpendëve, të cilat rrisin shpendë për prodhim vezësh për konsum njerëzor.

Përsa i përket *Statistikave të Qumështit*, nëpërmjet vrojtimeve mujore sigurohet informacion mbi nënproduktet e qumështit, strukturën e fabrikave dhe baxhove të grumbullimit dhe përpunimit të qumështit.

Vrojtimet vjetore në njësitë ekonomike blegtorale, sigurojnë të dhëna në lidhje me prodhimin e qumështit në fermë, bilancin e përdorimit të qumështit, si dhe nënproduktet e qumështit të prodhuara në fermë nga vete fermerët për vetëkonsum apo për shitje. Statistikat trevjeçare japin të dhëna për strukturën e ndërmarrjeve të grumbullimit dhe përpunimit të qumështit. Vrojtimi i fundit i Strukturës së Fermës (VSF/FSS) është realizuar në Tetor 2012, që përkon me regjistrimin e përgjithshëm në bujqësi.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon *statistikat e llogarive ekonomike të bujqësisë dhe mjedisit* bazuar në informacionin statistikor të marrë nga burimet administrative lidhur me statistikën e blegtorisë dhe peshkimit; statistikën e tokës dhe prodhimit bimor; statistikën e mjedisit dhe informacionin e marrë nga vrojtimet statistikore të zhvilluara nga INSTAT.

Të dhënat e peshkimit grumbullohen duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e *logbook*-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj.

Gjithashtu, INSTAT mbledh të dhëna dhe publikon statistika mbi sasinë dhe llojin e pesticideve dhe plehrave kimike të përdorura në bujqësi.

Rezultatet e pritshme

- Harmonizimi në metodologjinë e llogaritjes së treguesve, klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të EU;
- Ridizenjimi i pyetësorit të vrojtimin vjetor në bujqësi (njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale) si dhe përgatitja e kampionit të veçantë për bujqësinë dhe blegtorinë me qëllim rritjen e cilësisë;
- Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor nga vrojtimi dhe burimi administrativ lidhur me të dhënat për numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale si dhe regjistrin administrativ të kafshëve;
- Llogaritja e treguesve të rinj bazuar në rregulloren evropiane të Statistikave të Blegtorisë dhe Prodhimit të Mishit si: therjet jashtë thertorëve, prodhimi i brendshëm bruto (parashikimi i mishit) etj;

- Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore;
- Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për Llogaritë Ekonomike në Bujqësi;
- Llogaritja e indikatorëve në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Zhvillimi i Cens-it të Bujqësisë

Përputhshmëria me *acquis*

- *Statistikat në fushën e prodhimit bimor* realizohen duke zbatuar metodologjitë sipas standardeve evropiane, konkretisht bazuar në Rregulloren (KE) Nr. 543/2009 “Për statistikat vjetore të bimëve” ku mbulohen anexet 1.2.3.4 dhe vlerësohen si të pjesshme, si dhe në rregulloren e KE Nr. 834/2007 “Statistikat për prodhimet organike” që mbulohet në mënyrë të pjesshme.
- *Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve* përputhen pjesërisht me Rregulloren (KE) Nr. 1165/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për statistikat e blegtorisë dhe të mishit”, ku mbulohen anekset I-IV si dhe synohet mbulimi i aneksit V. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloret e KE-së.
- *Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të qumështit* bazohen dhe janë pjesërisht të përafruara me Rregulloren Nr. 1165/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për Statistikat e Blegtorisë dhe të Mishit”, si dhe Direktiva 96/16/KE në vrojtimet statistikore për qumështin dhe produktet e tij.
- *Statistikat e strukturës së njërive ekonomike bujqësore*, brenda periudhës së këtij Programi, do të bazohen në rregulloren e re: Rregullorja (BE) 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 korrikut 2018 mbi “Statistikat e Integruara të Fermave” dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 1166/2008 dhe (BE) Nr. 1337/201. Përkufizimet që do të përdoren do të jenë në përputhje me rregulloret e KE-së.
- *Llogaritë ekonomike në bujqësi dhe çmimet* bazohen në Rregulloren e (KE) Nr. 138/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Dhjetorit 2003 “Mbi Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë”. Në zbatim të kërkesave të kësaj rregulloreje, llogaritë ekonomike në bujqësi dhe çmimet klasifikohen si pjesërisht të përafruara. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloren e KE-së. *Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore* publikohet në përputhje me rregulloren e KE me periodicitet vjetor dhe tremujor.
- *Statistikat e peshkimit* bazohen në rekomandimet e FAO-s si dhe rregulloret: Rregullorja (KE) Nr. 216/2009 mbi “Statistikat e Zënieve të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut” dhe Rregullorja (KE) Nr. 762/2008 mbi “Statistikat e Akuakulturës”. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloret e KE-së. Çertifikimi i fermave organike nga trupat e çertifikimit bazohet në Ligjin Nr. 106/2016 “Për Prodhimin Biologjik, Etiketimin e Produkteve Biologjike dhe Kontrollin e Tyre” përafrimi me Rregulloren (KE) Nr. 834/2007, 28 Qershorit 2007 mbi “Produktet Organike dhe Etiketimin e Produkteve Organike”.
- *Statistikat e agromjedisit* vlerësohen si pjesërisht të përafruara me Rregulloren (KE) Nr. 1185/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 Nëntorit 2009 në lidhje me Statistikat për Pesticidet.
- Gjatë implementimit të PSZ 2022 – 2026 do të realizohet Censi i Bujqësisë në përputhje të plotë me rregulloren Evropiane (EU) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës”, i cili do të mundësojë përafrimin e mëtejshëm të statistikave të bujqësisë dhe blegtorisë me kërkesat e rregulloreve përkatëse, si dhe rritjen e indikatorëve statistikorë. Gjithashtu, do të realizohet plotësimi i pyetësorit të përbashkët të pyjeve (JFSQ), i cili ofron të dhëna vjetore për prodhimin dhe tregtimin e drurit dhe produkteve të drurit.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg.e KE Nr. 543/2009 "Për statistikën vjetore të bimëve"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 834/2007 "Statistikat për prodhimet organike"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 1165/2008 "Për statistikën e blegtorisë dhe të mishit"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e BE Nr. 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 korrikut 2018 mbi "Statistikën e Integruar të Fermave"	I pjesshëm	I plotë
Rreg. e KE Nr. 138/2004 "Mbi Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 834/2007 "Mbi Produktet Organike dhe Etiketimin e Produkteve Organike"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 216/2009 mbi "Statistikën e Zënive të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut"	I pjesshëm	I plotë
Reg. e KE Nr. 762/2008 mbi "Statistikën e Akuakulturës"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 1185/2009 "Mbi statistikën e pesticideve"	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.1 Statistikat e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat e Pyjeve	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Produkteve Bimore nga Vrojtimi Vjetor në Bujqësi				x	x	VS	Inst Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Statistikat e Produkteve Bimore (administrative)	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Produkteve Bimore nga Vrojtimi mbi Sipërfaqen e Mbjetllë				x	x	VS	INSTAT Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve nga Vrojtimi Vjetor në Bujqësi				x	x	VS	INSTAT Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve (administrative)	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve	x	X	x	x	x	VS	INSTAT

Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve të nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor)	x	X		x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij nga vrojtimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij nga burimi administrativ	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Censi i Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore			x			Cens	INSTAT
Statistikat mbi Llogaritë Ekonomike në Bujqësi	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat mbi Çmimet Bujqësore	x	X	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Peshkimit	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Peshkimit dhe Akuakulturës	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Prodhimeve Organike në Bujqësi	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Agromjedisit	x	X	x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjencia Kombëtare e Ushqimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Vrojtimit statistikore:

- Vrojtimi mbi Përdorimin e Lëndës Drusore në Industri
- Vrojtimi i Sipërfaqës së Mbjellë
- Vrojtimi Vjetor në Bujqësi
- Vrojtimi Mujor në Thertore
- Vrojtimi Mujor në Pulari
- Vrojtimi vjetor në subjektet grumbulluese dhe përpunuese të qumështit (të gjitha llojet)
- Vrojtimi mujor në subjektet grumbulluese dhe përpunuese të qumështit (qumësht lope)
- Vrojtimi i strukturës së fermave (Cens-i i Bujqësisë)
- Vrojtimi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore
- Vrojtimi tremujor i çmimeve të inputeve në bujqësi
- Vrojtimi tremujor i çmimeve të kafshëve për mbarështim

3.2 ENERGJIA

Përshkrimi

Statistikat e Energjisë përfshijnë *Statistikat e Energjisë Elektrike* dhe *Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë*. Statistikat e Energjisë janë pjesërisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1099/2008, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Situata aktuale

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat e Energjisë Elektrike të grumbulluara nga burimet administrative. Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudhën tremujore të siguruar nga burimet administrative.

Gjithashtu, INSTAT mbledh dhe publikon Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë, i cili paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Ai është përmbledhje e gjithë bilanceve të burimeve energjitike të disponueshme dhe është hartuar i plotë që nga viti 1998. Bilanci paraqet origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë dhe përbëhet nga dy pjesë kryesore: furnizimi dhe përdorimi i energjisë.

INSTAT transmeton çdo vit në Eurostat mini-pyetësorë; pyetësorët vjetorë (Energjia Elektrike dhe Ngrohja, Gazi Natyror, Nafta, Qymyri, Energjia e Rinovueshme dhe Mbetjet, Konsumi i Energjisë në Familje dhe Vlerësimi i përmbledhur i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë); pyetësorët mujorë (Nafta, Gazi dhe Energjia Elektrike) dhe çmimet e energjisë (Energjia Elektrike dhe Gazi për Familjet/Industrinë).

Rezultatet e pritshme

- Marrja dhe përpunimi i informacionit me burim administrativ operatorët e energjisë elektrike mbi sasinë e prodhimit të energjisë elektrike në periudha tremujore;
- Marrja dhe publikimi i informacionit me burim administrativ Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë;
- Përmirësimi dhe rritja e cilësisë dhe numrit të indikatorëve të transmetuar në Eurostat.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e Energjisë janë pjesërisht të përafruara me Rregulloren (KE) Nr. 1099/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 22 Tetorit 2008 “Mbi statistikën e energjisë”. Një numër i madh indikatorësh dhe raporti i cilësisë mbi statistikën e energjisë transmetohet aktualisht në Eurostat përmes pyetësorëve të Energjisë. Përmirësimi dhe rritja e cilësisë dhe numrit të indikatorëve të transmetuar në Eurostat dhe statistikën vjetore të konsumit përfundimtar të energjisë janë një nga përparësitë kryesore në të ardhmen.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 1099/2008 "Mbi statistikën e energjisë"	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.2 Energjia	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat e Energjisë Elektrike	X	x	X	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Bilancit të Përgjithshëm të Energjisë	X	x	X	x	x	BA	INSTAT; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Operatorët energjetikë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

3.3 TRANSPORTI**Përshkrimi**

Statistikat e Transportit **përfshijnë** statistikën mbi transportin rrugor, ajror, detar, hekurudhor dhe transportin ujor të brendshëm. Statistikat e Transportit janë pjesërisht në përputhje me rregulloret e KE lidhur me secilën mënyrë transporti (Rregulloret Nr. 2018/643, Nr. 2018/974, Nr. 70/2012, Nr. 437/2003 dhe Direktivën 2009/42/KE), ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Situata aktuale

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistika mbi Transportin. Këto statistika sigurohen nga burimet administrative dhe përfshijnë një sistem të gjerë informacioni mbi llojet e transporteve të mallrave dhe pasagjerëve. INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative në periudha mujore dhe vjetore, të klasifikuara sipas Klasifikimit Standard të Mallrave për Statistikat e Transportit (NST 2007). Të dhënat përfshijnë treguesit statistikorë mbi volumet e mallrave të transportuara me anë të transportit detar, hekurudhor, ajror, treguesit statistikorë të pasagjerëve të transportuar me anë të transportit detar, hekurudhor, ajror, treguesit mbi volumen e postës me ajër, treguesit mbi infrastrukturën në transportin detar dhe hekurudhor, treguesit statistikorë mbi pajisjet e transportit dhe të trafikut në transportin hekurudhor, treguesit statistikorë mbi mjetet rrugore sipas kategorive si dhe treguesit statistikorë mbi sigurinë në transportin rrugor dhe hekurudhor. Të dhënat publikohen në nivel kombëtar dhe rajonal në periudha mujore dhe vjetore. Statistikat e

Transportit nuk përfshijnë statistikën mbi volumet e mallrave dhe pasagjerëve të transportuar me anë të transportit rrugor. INSTAT nuk kryen vërtetime lidhur me transportin rrugor të mallrave dhe pasagjerëve. Disa tregues statistikorë të kësaj fushe dërgohen në Eurostat, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në Shoqatën Ndërkombëtare të Transportit, etj.

Rezultatet e pritshme

- Rritja e numrit të treguesve statistikorë për transportin hekurudhor dhe detar, në përputhje me rregulloret evropiane përkatëse, në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat;
- Prodhimi i treguesve të rinj lidhur me transportin ajror;
- Prodhimi i treguesve mbi mallrat e transportuara sipas NST 2007;
- Prodhimi i statistikave mbi transportin ujor të brendshëm;
- Zhvillimi i vërtetimit të ri “Anketa e transportit rrugor të mallrave”.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat mbi Transportin janë pjesërisht në përputhje me rregulloret e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2018/643 “Mbi Statistikat e Transportit Hekurudhor”, Nr. 2018/974, “Mbi Statistikat e Transportit të mallrave përmes rrugëve ujore brenda vendit”, Nr.70/2012, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë”, Nr. 93/704 “Mbi krijimin e një baze të të dhënave të Komunitetit për aksidentet rrugore”, Nr. 437/2003, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës” si dhe Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2009/42, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave dhe udhëtarëve nga deti”. Disa tregues statistikorë mbi transportin hekurudhor, rrugor dhe ajror dërgohen në Eurostat nëpërmjet pyetësorëve. Gjatë këtij 5 vjeçari do të synohet; marrja e databazave me të dhëna administrative mbi fazat e fluturimeve, të origjinës/destinacionit të fluturimit dhe databazës së aeroporteve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që do të rrisë numrin e treguesve të prodhuar mbi transportin ajror.

Marrja e databazës me të dhëna administrative të regjistrimit të mjeteve rrugore lidhur me transportin rrugor të mallrave dhe pasagjerëve nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor do të rrisë numrin e treguesve të prodhuar mbi transportin rrugor.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg e KE Nr. 2018/643 “Mbi Statistikat e Transportit Hekurudhor”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 2018/974, “Mbi Statistikat e Transportit të mallrave përmes rrugëve ujore brenda vendit”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr.70/2012, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 93/704 “Mbi krijimin e një baze të të dhënave të Komunitetit për aksidentet rrugore”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg e KE Nr. 437/2003, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës”	I pjesshëm	I pjesshëm
Direktiva e KE Nr. 2009/42, “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave dhe udhëtarëve nga deti”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.3 Transporti	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjës
Statistikat e Transportit Ajror, Detar, Rrugor, Ujor i brendshëm dhe Hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve	x	x	x	x	x	BA	INSTAT Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Statistikat mbi Karakteristikat e Mjeteve të Transportit Rrugor	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Transportit Rrugor të Mallrave				x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Sigurisë në Transport	x	x	x	x	x	BA	INSTAT

*SS-Statistical survey; *AS-Administrative source

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Autoritet Portuale dhe Portet detare
- Hekudhura Shqiptare sh.a
- Aeroportet
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Vrojtimet Statistike:

- Anketa mbi transportin rrugor të mallrave

3.4 TURIZMI

Përshkrimi

Statistikat e Turizmit - ana e ofertës përfshijnë statistikën mbi ofertën e akomodimit të turizmit, në Shqipëri, në periudha mujore, trendet e netë qëndrimeve dhe vizitorëve, dhomat, shtretërit, etj. Statistikat e Turizmit janë pjesërisht në linjë me Rregulloren (KE) Nr. 692/2011, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Statistika e Turizmit – ana e kërkesës sigurohen dhe prodhohen nëpërmjet anketës pranë familjeve “Pushime dhe Udhëtime”, e cila kryhet pranë njësisë ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit, të ndarë në katër tremujorë të vitit. Anketa u krye për herë të parë në vitin 2017, përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 10.240 NjEF, përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Situata aktuale

Lidhur me *Statistikat e Turizmit – ana e ofertës* INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikat mbi “Strukturat Akomoduese” me vërtetim të drejtpërdrejtë me anketues. Në Korrik 2017, me mbështetjen e projekteve IPA shumë-përfutuese nisi vërtetimi i turizmit për mbledhjen e informacionit pranë ndërmarrjeve. Në Korrik 2020, u publikuan për herë të parë të dhënat e Anketës së Turizmit mbi “*Strukturat Akomoduese*”, për periudhën kohore 2018-2019. Të dhënat mbledhen me frekuencë mujore, ndërsa publikimi për vitet 2020 dhe 2021 është kryer me frekuencë tremujore. Pas publikimit, të dhënat dhe raporti i cilësisë për Strukturat Akomoduese transmetohet në Eurostat.

Sa i përket *Statistikave të Turizmit – ana e kërkesës*, INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon me baza vjetore statistikat mbi “Statistikat e turizmit në familje nga ana e kërkesës”, në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it. Në vijim të procesit, pyetësorët dhe materialet mbështetëse përditësohen dhe përshtaten sipas rekomandimeve më të fundit të Eurostat-it. Pas publikimit, të dhënat në nivel mikro, agregatët dhe raporti i cilësisë për statistikat e turizmit në familje nga ana e kërkesës transmetohen në Eurostat. Mbledhja e të dhënave realizohet me metodën PAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë.

Rezultatet e pritshme

Statistikat e Turizmit – ana e ofertës

- Mbledhja, përpunimi dhe publikimi periodik i statistikave të Turizmit mbi “Strukturat Akomoduese”;
- Përmirësimi i përputhshmërinë së statistikave të Turizmit me rregulloren (KE) Nr. 692/2011. INSTAT ka planifikuar të kalojë nga publikimi tremujor tek ai mujor dhe transmetimin në afatet kohore të kërkuara, duke nisur nga viti 2022.
- Ndërtimi i një kampioni përfaqësues për nivele të detajuara, duke prodhuar statistika sipas shkallës së urbanizimit të bashkive (klasifikimit DEGURBA), gjithashtu dhe statistika rajonale (sipas klasifikimeve NUTS II dhe NUTS III).
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me Ministrinë e Turizmit dhe institucionet e tjera të lidhura me turizmin, për ndërtimin e regjistrit të njësive akomoduese, strukturave të ngjashme dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me turizmin.
- Statistika e Turizmit – ana e kërkesës
- Publikimi në faqen zyrtare elektronike i të dhënave përfundimtare/finale të Anketës së Turizmit në Familje, 318 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 318 ditë).
- Përfshirja e këtyre të dhënave në botimet: “Vjetari Rajonal”, “Vjetari Statistikor”, “Shqipëria në Shifra”, “Burra dhe Gra” njëkohësisht edhe botimin e dedikuar “Turizmi në Shifra”.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat e Turizmit – ana e ofertës

Statistikat e Turizmit janë pjesërisht në përputhje me rregulloren e KE Nr. 692/2011 “Mbi Statistikat e Turizmit”. Përkufizimet dhe metodologjia e përdorur në vlerësim është në përputhje me rregulloret. Të dhënat dhe raportet e cilësisë transmetohen rregullisht në bazë tremujore në Eurostat.

Gjatë këtij pesëvjeçari do të punohet për publikimin e të dhënave me frekuencë mujore dhe ndërtimin e një kampioni përfaqësues për nivele të detajuara, duke prodhuar statistika sipas shkallës së urbanizimit të bashkive (klasifikimit DEGURBA).

Statistikat e Turizmit –ana e kërkesës

Statistikat për nënfushën e turizmit nga ana e kërkesës janë pjesërisht në përputhje me rregulloren Komisionit Evropian (KE) Nr. 692/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me statistikën mbi kërkesat e turizmit. Dizajni i pyetësorit, përkufizimet dhe metodologjia e përdorur kryhet nga INSTAT në përputhje me këtë rregullore. Të dhënat dhe raportet e cilësisë transmetohen rregullisht në bazë vjetore në Eurostat.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg e KE Nr. 692/2011 "Mbi Statistikat e Turizmit"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg e KE Nr. 692/2011 "Mbi statistikën e Turizmit -kërkesat e turizmit"	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.4 Turizmi	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistika nga Anketa e Strukturave Akomoduese	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistika nga Anketa e Turizmit në Familje	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Lëvizjes së Shtetasve	x	x	x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

Vrojtimet Statistikore:

- Anketa e Strukturave Akomoduese
- Anketa e Turizmit në familje

3.5 TREGTIA E JASHTME

Përshkrimi

Statistikat e investimeve të huaja dhe tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve janë pjesë integrale e statistikave të bilancit të pagesave. Investimet e huaja përfshijnë vlera të realizuara nga transaksionet e krijimit, mbajtjes, zgjerimit ose reduktimit të kapitalit të gjithë operatorëve ekonomikë në ekono-

minë e vendit, kur përqindja e pronësisë të kapitalit të huaj është më shumë se 10 për qind. Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve, pjesë e llogarisë korrente (shërbime), mbulon të gjitha shërbimet që rezidentët e një ekonomie kryejnë për jo-rezidentët (kredi), si dhe shërbimet e kryera nga jo-rezidentët për llogari të rezidentëve (debi). Në përgatitjen e këtyre statistikave, Banka e Shqipërisë zbaton kërkesat dhe standardet e manualeve metodologjike të FMN-së BPM6-2009 (manuali i bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare), OECD BD4 (manuali për investimet e huaja direkte –edicioni 4), manualit të statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve dhe Kodit evropian të statistikave.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave kanë qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave në Shqipëri. Për këtë qëllim statistikave të tregtisë së mallrave llogarisin treguesit e eksportit (FOB) dhe importit (CIF) në total, si dhe disa tregues të tjerë më të detajuar, si p.sh. eksport-importi sipas vendeve, grupvendeve, grupmallrave, etj.

Situata aktuale

Në vitet e fundit, vëmendje e veçantë i është kushtuar automatizimit të sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të Sektorit të Jashtëm (bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, investimet e huaja direkte, tregtia ndërkombëtare e shërbimeve, statistikave të rezervës ndërkombëtare dhe statistikave të borxhit të jashtëm), për të rritur konsistencën mikro-makro dhe për të lejuar vlerësimin e treguesve të rinj, në përgjigje të kërkesave të transmetimit të të dhënave statistikore për rritjen e nivelit të detajimit të këtyre statistikave, për ti bërë ato të krahasueshme midis vendeve, si dhe transmetimin e të dhënave nëpërmjet implementimit të platformës SDMX, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga BE. Gjithashtu, është punuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve të informacionit, përmirësimeve metodologjike dhe përafrimit të afateve të publikimit me afatet e programit të transmetimit VADEMECUM, e-GDDS ose SDDS.

Projekte nga FMN dhe IPA shumë-përfutuese, kanë ndihmuar dhe do të vazhdojnë të ndihmojnë në implementimin dhe harmonizimin e plotë të treguesve statistikore me standardet ndërkombëtare.

INSTAT-i përpilon statistikave të tregtisë së jashtme sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara të përshkruara në Manualin “Konceptet dhe Definicionet e Statistikave të Tregtisë së Jashtme” 2010, në të cilin mbështetet edhe metodologjia e Eurostat-it. Burimi i sigurimit të të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme të mallrave është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (burim administrativ). Të dhënat grumbullohen nëpërmjet dokumentit administrativ të vetëm (deklarata doganore), i cili është sipas standardeve të BE-së. Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave përpunohen duke u mbështetur në principet e sistemit të tregtisë speciale.

Nomenklaturat e përdorura për llogaritjen e statistikave të tregtisë së mallrave janë:

- Sistemi i Harmonizuar i mallrave dhe kodeve (HS)
- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave (CN),
- Klasifikimi Standard i Tregtisë Ndërkombëtare SITC, rev.4,
- Klasifikimi i vendeve dhe territoreve ISO – 3166 alpha-2code
- Nomenklatura e vendeve dhe territoreve
- Nomenklatura të tjera që përdoren për nevojat brendshme të INSTAT-it, si p.sh. Klasifikimi i Produkteve (CPA) dhe i Aktiviteteve (NACE) për nevojat e drejtorisë së llogarive kombëtare dhe statistikave të biznesit.

Të dhënat përpunohen në bazë mujore duke u mbështetur në kontrollet që aplikohen në DPD, e cila përdor sistemin *Asycuda World*, që lejon një sërë kontrollesh cilësore për të dhënat, si edhe disa kontrolle vizuale nga ana e INSTAT-it. Statistikat e përfutuara publikohen në bazë mujore dhe vjetore (publikime të veçanta dhe specifike për tregtinë e jashtme të mallrave dhe publikime të tjera të INSTAT-it), si dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al. Të dhënat mujore të detajuara të eksport-importit dërgohen në Eurostat në bazë të formatit të përcaktuar në dokumentin Doc. Coop 400 Rev 1.2 që nga viti 1998. Këto të dhëna tani dërgohen nëpërmjet aplikacionit E-Damis. Të dhënat publikohen 17 ditë pas mbylljes së muajit, në botimin mujor “Tregtia e jashtme” si dhe publikohen edhe në botimet vjetore si “Tregtia e jashtme dhe ndërmarrjet”, “Shqipëria në Shifra”, “Vjetari Statistikor”, si edhe faqen elektronike të INSTAT.

Rezultatet e pritshme

- Implementimi i plotë i metodologjisë së FMN-së BPM6 dhe standardet e tjera ndërkombëtare;
- Transmetimi i të dhënave të detajuara në Eurostat, me synim rritjen e nivelit të krahasueshmërisë me vendet e tjera të Bashkimit Evropian;
- Përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore;
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në sektorë të veçantë të statistikave.
- Prodhimi i statistikave të tregtisë së jashtme në periudha mujore dhe vjetore sipas kapitujve HS, seksioneve të HS dhe grup mallrave
- Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas shteteve dhe grup-shteteve;
- Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas karakteristikave të ndërmarrjeve;
- Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas mënyrave të transportit.

Përputhshmëria me *acquis*

Mbështetur në Programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostat vlerëson mesatarisht të përputhshëm nivelin e implementimit të metodologjisë së *investimeve të huaja direkte* dhe *tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve*, si dhe kritereve të transmetimit të këtyre të dhënave.

Statistikat e tregtisë së jashtme janë përafëruar pjesërisht me Rregulloren (KE) Nr. 471/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 6 majit 2009 “Mbi statistikën e Komunitetit në lidhje me tregtinë e jashtme me vendet jo anëtare”. Të dhënat e hollësishme të tregtisë së jashtme transmetohen rregullisht në Eurostat çdo muaj. Statistikat e tregtisë sipas monedhës së faturës (tabelat TIC) dërgohen rregullisht në Eurostat një herë në dy vjet.

Statistikat e tregtisë së jashtme do të zbatojnë plotësisht sistemin statistikor në formatin e ri të transmetimit të detajuar në vitin 2022. Statistikat e tregtisë së jashtme planifikojnë të përgatisin dhe transmetojnë në Eurostat statistikën e tregtisë sipas karakteristikave të ndërmarrjes (të dhënat TEC) duke filluar nga 2023.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 471/2009 "Mbi statistikën e Komunitetit në lidhje me tregtinë e jashtme me vendet jo anëtare"	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.5 Tregtia e jashtme	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat tremujore të Fluksit dhe Stokut të Investimeve Direkte	x	X	x	x	x	VS+BA	Banka e Shqipërisë
Tregtia Ndërkombëtare e Shërbimeve	x	X	x	x	x	VS+BA	Banka e Shqipërisë
Statistika mbi Eksportet/Importet e Mallrave	x	X	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat mbi Eksportet/Importet e Mallrave sipas Karakteristikave të Ndërmarrjeve	x	X	x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimi i të dhënave

Burime Administrative:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Institucionet financiare banka dhe jo-banka;
- Njësitë brenda institucionit të Bankës së Shqipërisë;
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Njerëzore
- INSTAT;
- Informacion nga shkëmbime të ndërsjella dypalëshe me Kosovën.

Vrojtime statistikore:

- Vrojtmet statistikore pranë kompanive private dhe individëve;

3.6 BILANCI I PAGESAVE

Përshkrimi

Statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare janë të rëndësishme dhe nevojiten për të mbështetur analizat dhe vendimarrjen e politikës monetare të Bankës së

Shqipërisë, në raport me objektivat strategjike të vendit në fushën e ekonomisë dhe financave. Si të tilla, objektivi kryesor është prodhimi i këtyre statistikave, objektive, të besueshme, të detajuara dhe të krahasueshme. Statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare prodhohen në bazë të manualeve metodologjike të FMN-së BPM6-2009 (manuali i bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare), OECD BD4 (manuali për investimet e huaja direkte –edicioni 4), Manualit të statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve dhe Kodit evropian të statistikave.

Situata Aktuale

Në vitet e fundit, vëmendje të veçantë i është kushtuar automatizimit të sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të Sektorit të Jashtëm (bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, investimet e huaja direkte, tregtia ndërkombëtare e shërbimeve, statistikat e rezervës ndërkombëtare dhe statistikat e borxhit të jashtëm), për të rritur konsistencën mikro-makro dhe për të lejuar vlerësimin e treguesve të rinj, në përgjigje të kërkesave të transmetimit të të dhënave statistikore për rritjen e nivelit të detajimit të këtyre statistikave për t'i bërë ato të krahasueshme midis vendeve si dhe transmetimin e të dhënave nëpërmjet implementimit të platformës SDMX, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga BE. Gjithashtu, është punuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve të informacionit, përmirësimeve metodologjike dhe përafrimit të afateve të publikimit me afatet e programit të transmetimit VADEMECUM, e-GDDS ose SDDS.

Projekte nga FMN dhe IPA shumë-përfituese, kanë ndihmuar dhe do të vazhdojnë të ndihmojnë në implementimin dhe harmonizimin e plotë të treguesve statistikore me standardet ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme

- Gjatë periudhës 2022-2026, sigurimi i statistikave dhe analizave cilësore do vazhdojë të jetë parësor në informimin për qëllime politikëbërëse, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe në shpjegimin e zhvillimeve të tregjeve financiare. Do synohet vazhdimësia në harmonizimin e plotë me standardet ndërkombëtare, përmirësimet metodologjike si dhe transmetimin e të dhënave të detajuara me ndarje gjeografike dhe sektorë institucionalë.
- Prioritet e zhvillimit të statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare gjatë pesë viteve të ardhshme do të jenë:
- Implementimi i plotë i metodologjisë së FMN-së BPM6 dhe standardet e tjera ndërkombëtare;
- Harmonizimi i statistikave me praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me llogaritjen e vlerësimit të depozitave të emigrantëve;
- Transmetimi i të dhënave në EUROSTAT të detajuara me synim rritjen e nivelit të krahasueshmërisë me vendet e tjera të Bashkimit Evropian;
- Manuale metodike ndërkombëtare të përshtatura në shqip;
- Përf forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore;
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në sektorë të veçantë të statistikave.

Përputhshmëria me *acquis*

Mbështetur në Programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostat vlerëson mesatarisht të përputhshëm me Rregulloren (KE) Nr. 184/2005 “Mbi statistikën e Komunitetit lidhur me bilancin e

pagesave, tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve dhe investimet e huaja direkte” nivelin e implementimit të metodologjisë së bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare BPM6, si dhe kriteret e transmetimit të të dhënave.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 184/2005 “Mbi statistikën e Komunitetit lidhur me bilancin e pagesave, tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve dhe investimet e huaja direkte”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.6 Bilanci i Pagesave	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat tremujore të Bilancit të Pagesave	x	x	x	x	x	VS+BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat mujore të Bilancit të Pagesave	x	x	x	x	x	VS+BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat tremujore të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare	x	x	x	x	x	VS+BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat mujore të Rezervës Ndërkombëtare	x	x	x	x	x	BA	Banka e Shqipërisë
Statistikat tremujore të Borxhit të Jashtëm	x	x	x	x	x	BA	Banka e Shqipërisë

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet administrative:

- Institucionet financiare banka dhe jo-banka;
- Njësitë brenda institucionit të Bankës së Shqipërisë;
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave,
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN);
- Komisioni Europian për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (ECFIN);
- Informacion nga institucionet e Kosovës.

Vrojtimet statistikore:

- Vrojtime statistikore pranë kompanive private dhe individëve

3.7. ÇMIMET

Përshkrimi

Statistikat e çmimeve përfshijnë indeksin e çmimeve të konsumit, indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit, statistikat e banesave dhe matjen e paritetit të fuqisë blerëse. Statistikat e çmimeve janë tregues ekonomikë që matin ndryshimin me kalimin e kohës të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të konsumit, të blera nga familjet për qëllim të përmbushjes së drejtpërdrejtë të nevojave të konsumit. Gjithashtu, statistikat e çmimeve matin fuqinë blerëse si dhe çmimet e banesave. Me fjalë të tjera ato janë një sërë indeksesh të llogaritura sipas një qasjeje të harmonizuar dhe një grupi të vetëm përkufizimesh. Indeksi i Çmimeve të Konsumit përdoret si bazë e inflacionit zyrtar të publikuar nga Banka Qendrore, duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Situata aktuale

INSTAT llogarit dhe publikon çdo muaj Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK), të cilët matin ndryshimin e çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh në periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër e konsideruar si periudha bazë. Periudha bazë e llogaritjes së indeksit është muaji Dhjetor 2020, (Dhjetor 2020=100). Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së *Klasifikimit të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit* (ECOICOP), i përputhshëm plotësisht me strukturën e shpenzimeve që përdor Eurostat. Bazuar në këtë klasifikim, shpenzimet janë klasifikuar në 12 grupe kryesore. Për llogaritjen e indeksit, INSTAT mbledh dhe përpunon çmimet e mallrave dhe shërbimeve me vërtetim mujor nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë me anketues. Vërtetimi kryhet në njësitë e tregtimit me pakicë, të përzgjedhura për këtë vërtetim. Çmimet mbledhen vetëm në zonën urbane. Shporta e mallrave dhe peshat përditësohen me të dhënat e ABF-së. Të dhënat e IÇK dhe IHÇK publikohen çdo muaj, përkatësisht 8 dhe 18 ditë pas përfundimit të muajit. Të dhënat transmetohen në Eurostat rregullisht, me bazë mujore që nga viti 2016. Inventari dhe raportet e cilësisë përditësohen, transmetohen dhe publikohen çdo vit.

Republika e Shqipërisë është përfshirë në Projektin Pilot të Programit Evropian të Krahimit (PPP) që në vitin 2003. Në kuadër të këtij projekti, INSTAT-i është përgjegjës për kryerjen e gjashtë vërtetimeve të çmimeve të konsumit brenda një cikli trevjeçar, vërtetimin e çmimeve të ndërtimit, vërtetimin e spitaleve, vërtetimin e makinerive dhe pajisjeve dhe vërtetimin e qirave. INSTAT, gjithashtu, është përgjegjës për të siguruar një herë në vit për Eurostat-in disa të dhëna të tjera shtesë për nevojat e projektit “Pariteti i Fuqisë Blerëse”, që përdoren për krahasimin e volumit të PBB-së ndërmjet vendeve.

Çmimet e produkteve dhe shërbimeve mbledhen vazhdimisht në harmonizim të plotë me listën e produkteve dhe specifikimeve të caktuara nga koordinatorët e projektit dhe Eurostat. Gjithashtu, çdo vit INSTAT përditëson dhe dërgon në Eurostat Inventarin e Matjes së Fuqisë Blerëse.

Aktualisht, INSTAT nuk llogarit Statistikat e Çmimeve të Banësive. Me asistencë të ekspertëve të huaj, mbështetur nga programi IPA shumë-përfituese, janë studiuar burimet e mundshme të të dhënave për implementimin e statistikave të banësive. Burimi kryesor i të dhënave është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Rezultatet e pritshme

- Përmirësime metodologjike të statistikave të çmimeve të konsumit, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë me rregulloret e BE-së duke zbatuar të gjitha rregulloret specifike që lidhen me trajtimin e elementeve të shportës, përditësimin e peshave dhe produkteve të shportës;
- Përmirësime metodologjike të Statistikave të Matje së Fuqisë Blerëse, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë me rregulloret e BE-së duke zbatuar të gjitha rregulloret specifike që lidhen me trajtimin e elementeve të veçantë të vrojtimit;
- Marrja e skedarit të transaksioneve të banesave nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për IN-STAT-in.

Përputhshmëria me *acquis*

Statistikat Çmimeve të Konsumit janë pjesërisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 2494/95 “Lidhur me indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit”, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Të dhënat e çmimeve transmetohen rregullisht në Eurostat çdo muaj. INSTAT ndjek dhe zbaton rregullisht ndryshimet metodologjike të regullores dhe i zbaton në trajtimin dhe llogaritjen e treguesit.

Përsa i përket statistikave të Matjes së Fuqisë Blerëse, të gjitha aktivitetet që lidhen me këtë nëntemë statistikore kryhen në përputhje të plotë me rregulloren e BE Nr. 193/2011 “Mbi përdorimin e sistemit të kontrollit të cilësisë për matjen e fuqisë blerëse”.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 2494/95 “Lidhur me indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit”	I pjesshëm	I plotë
Rreg. e BE Nr. 193/2011 “Mbi përdorimin e sistemit të kontrollit të cilësisë për matjen e fuqisë blerëse”.	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.7 Çmimet	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Indeksi i Çmimeve të Konsumit	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) me taksa konstante	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Vrojtimet e Paritetit të Fuqisë Blerëse	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Indeksi i Çmimeve të Banesave			x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtim Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative:

- Bashkitë
- Ujësjetllës Kanalizime Tiranë
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- Universitetet
- Spitalet
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Vrojtimet Statistikore:

- Anketa mujore e Çmimeve të Konsumit
- Anketa e Çmimeve të Ndërtimit
- Anketa e Çmimeve të Makinerive dhe Pajisjeve
- Anketa e Qirave

3.8. SHKENCA, TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

Përshkrimi

Statistikat e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit **përshkrujnë** statistikën mbi Shkencën në sektorët si: Bizneset private, Organizata private jo-fitimprurëse, Qeveria, Institucionet e Arsimit të Lartë si dhe statistikën lidhur me fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për këtë aktivitet, statistika mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ndërmarrjet dhe nga individët dhe familjet si dhe Statistikat e Inovacionit.

Statistikat e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, janë pjesërisht në linjë me rregulloren e Bashkimit Evropian Nr. 2019/2152 “Mbi statistikën evropiane të biznesit”, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Gjatë këtij 5 – vjeçari INSTAT do të fokusohet në përshtatjen dhe zbatimin e aktiviteteve të statistikave të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me rregulloren e re Nr. 2019/2152 (të KE). Lidhur me këto statistika është kryer progres i vazhdueshëm, duke rritur gamën e treguesve të prodhuar si dhe duke rritur numrin e tabelave të transmetuara në Eurostat.

Statistikat mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit sigurohen dhe prodhohen nëpërmjet anketës mbi “Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)”, e cila ka si objekt studimi të gjitha NjEF dhe individët e grupmoshës 16 - 74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Anketa mbledh të dhëna mbi çështje në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në familje dhe nga individët, si: të dhënat mbi pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që zotëron familja/individët (telefon, pajisje kompjuterike, mbi aksesin dhe përdorimin në internet (e-blerje, e-qeverisje, etj). Gjithashtu, të dhënat e TIK përdoren për të pasuruar në mënyrë të vazhdueshme treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (4 dhe 17).

Anketa u krye për herë të parë në vitin 2018 përfaqësues për të gjithë Shqipërinë me një kampion prej 7.200 NjEF. Anketa mbi përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët ka një shtrirje kohore 2 mujore çdo vit.

Situata Aktuale

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën mbi Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin me anë të vrojtimeve vjetore dhe dyvjetore, me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Statistikat mbi Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive që zhvillojnë aktivitet ekonomik në Shqipëri, pavarësisht formës së tyre ligjore, si dhe sektorin e organizatave jofitimprurëse, sektorin qeveritar si dhe institucionet e arsimit të lartë. Kjo fushë statistikore ndahet në tre nënfusha: Statistikat mbi Shkencën, Statistikat mbi Teknologjinë dhe Statistikat mbi Inovacionin.

Statistikat mbi Shkencën përfshijnë vrojtimet dyvjeçare në të gjithë sektorët ku ky aktivitet potencialisht zhvillohet: Sektori i biznesit, i organizatave jofitimprurëse, qeveritar, institucionet e arsimit të lartë si dhe statistikën lidhur me fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për këtë aktivitet, metodologjia e ndjekur bazohet në Rregulloren (KE) Nr. 995/2012 për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të BE-së për Shkencën dhe Teknologjinë, Aneksi I si dhe të përcaktuara në Manualin e Frascat-it 2015. Aktualisht, INSTAT mbledh të dhëna nëpërmjet vrojtimeve në të gjithë sektorët e përfshirë për këto statistika, por nuk prodhohen tregues statistikorë për këtë nënfushë si pasojë e të dhënave të mbledhura jo të plota dhe jo cilësore. INSTAT është në fazën e ngritjes së sistemit për prodhimin e këtyre statistikave sipas sektorëve specifikë dhe në nivel kombëtar.

Statistikat mbi Teknologjinë përfshijnë treguesit statistikorë mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ndërmarrjet dhe nga individët dhe familjet. Treguesit statistikorë të përdorimit të TIK në ndërmarrje përfshijnë vrojtimin vjetor në ndërmarrje me 10 dhe me shumë të punësuar. Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me tabletë. Metodologjia e ndjekur dhe pyetësi i përdorur është në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 808/2004, Aneksi I, për të cilin mblidhen dhe prodhohen të dhënat për secilin vit referencë. Statistikat e përdorimit të TIK në ndërmarrje prodhohen nga viti 2015 e në vazhdim dhe prej vitit 2021, prodhohen dhe publikohen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në rregullore. Treguesit statistikorë për këtë nënfushë publikohen në nivel kombëtar sipas aktiviteteve ekonomike të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2) dhe madhësisë së ndërmarrjes.

Gjithashtu, INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon me baza vjetore statistikën mbi “Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)” në përputhje të plotë me metodologjinë, rekomandimet dhe pyetësin model të Eurostat-it. Pas publikimit, të dhënat në nivel mikro dhe raporti i cilësisë për statistikën e përdorimit të TIK në familje dhe nga individë transmetohen në Eurostat. Mbledhja e të dhënave realizohet me metodën PAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë.

Statistikat e Inovacionit përfshijnë vrojtimin dyvjeçar në ndërmarrje ku mblidhet informacion për tre vite referencë. Metodologjia e ndjekur është në përputhje me botimin e katërt të Manualit të Oslos dhe Rregulloren (KE) Nr. 995/2012 për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të BE-së për Shkencën dhe Teknologjinë, Aneksi II. INSTAT prodhon tregues për aktivitetet e Inovacionit në ndërmarrje prej periudhës referuese 2017-2019 duke u bazuar në pyetësin e harmonizuar të BE-së. Për të qënë në përputhje me periudhën referuese të mbledhjes së të dhënave me vendet e BE-së, vrojtimi i fundit u krye nga INSTAT në vitin 2020 për periudhën referuese 2018-2020. Treguesit statistikorë për këtë nënfushë u publikuan në nivel kombëtar sipas aktiviteteve ekonomike të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2) dhe madhësisë së ndërmarrjes. Disa treguesë statistikorë të kësaj fushe dërgohen në Eurostat, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), etj.

Rezultatet e pritshme

- Përmirësimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave për prodhimin e treguesve mbi Shkencën.
- Shtimi i numrit të treguesve TIK në ndërmarrje të prodhuar, të kërkuar sipas Rregullores (KE) Nr. 808/2004, Aneksi I, shkronja “e”, në nivel seksioni dhe në nivel rajonal sipas NUTS II; si dhe transmetimi në EUROSTAT.
- Prodhimi i treguesve të rinj për nënfushën Inovacioni, të kërkuar sipas Rregullores (KE) Nr. 995/2012, Aneksi II, seksioni 2.

Përthpushmëria me *acquis*

Statistikat mbi *Inovacionin* dhe *Teknologjinë* janë pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 995/2012 “Lidhur me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave mbi shkencën dhe teknologjinë” dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 808/2004 “Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi Shoqërinë e Informacionit”.

Të dhënat mbi *Shkencën* mbledhen për secilin sektor që kjo nënfushë mbulon, por për shkak të mungesës së cilësisë dhe shkallës së ulët të përgjigjes nga njësitë statistikore nuk prodhohen statistika. Ndonëse ndiqet Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 995/2012, Aneksi I dhe Manuali i Frascatit për përkufizimet dhe mbledhjen e të dhënave, mosprodhimi i treguesve për këtë fushë bën të pamundur vlerësimin me përputhshmërinë me Rregulloret përkatëse. Gjatë periudhës 5-vjeçare, INSTAT do të fokusohet në prodhimin e treguesve mbi fondet e alokuara për Kërkimin Shkencor në buxhetin e shtetit.

Statistikat për nënfushën e Teknologjisë janë pjesërisht në përputhje me Aneksin I të Rregullores. Disa statistika nuk prodhohen të detajuara sipas seksioneve përkatëse të përcaktuara në NVE Rev.2 dhe sipas madhësisë së ndërmarrjes. Statistikat sipas rajoneve duhet të prodhohen për këtë nënfushë. Statistikat e përdorimit të TIK në ndërmarrje nuk transmetohen në Eurostat.

Statistikat për nënfushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga familjet dhe individë janë pjesërisht në përputhje me Aneksin II të Rregullores. Rezultatet e vrojtimit mbi përdorimin e TIK-ut në familje dhe nga individët prodhohen duke zbatuar rregulloret e Komisionit Evropian (KE): Rregullore (KE) Nr. 808/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit, Aneksi II. Dizenjimi i pyetësorit, përkufizimet dhe metodologjia e përdorur është në përputhje me rregulloret. Të dhënat dhe raportet e cilësisë transmetohen rregullisht në bazë vjetore në Eurostat.

Treguesit statistikorë për nënfushën e Inovacionit janë pjesërisht të përputhshme me Rregulloren (KE) Nr. 995/2012, Aneksi II i saj. INSTAT prodhon 4 variabla të kërkuara nga Aneksi II i Rregullores nga 10 variabla, të cilët duhet të prodhohen për të arritur një përputhshmëri të plotë. Lidhur me seksionin 3 dhe 4 të Aneksit II, INSTAT është në përputhje të plotë me kërkesat e këtyre seksioneve. INSTAT prodhon tregues statistikorë sipas grupaktiviteteve ekonomike të NVE Rev.2, por sipas Aneksit II, seksioni 6, treguesit statistikorë duhet të prodhohen në nivel aktiviteti. Disa nga treguesit statistikorë të Inovacionit të kërkuar në rregullore nuk prodhohen dhe nuk transmetohen në Eurostat. Gjatë periudhës 5-vjeçare, planifikohet që të rritet numri i treguesve të kërkuar nga rregullorja si dhe të transmetohen disa nga këto tregues në Eurostat.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e BE Nr. 995/2012 "Lidhur me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave mbi shkencën dhe teknologjinë"	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 808/2004 "Lidhur me statistikën e Komunitetit mbi Shoqërinë e Informacionit"	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

3.8. Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat e Shkencës	x	x	x	x	x	VS+BA	INSTAT; Ministria e Financës dhe Ekonomisë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat nga Anketa e TIK në Familje	x	x	x	x	x	VS	INSTAT
Statistikat e Inovacionit		x		x		VS	INSTAT

*VS-Vrojtimit Statistikor; *BA-Burim Administrativ

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Vrojtimet Statistikore

- Anketat mbi Kërkimin dhe Zhvillimin Shkencor pranë ndërmarrjeve, organizatave jo-fitimprurëse, sektorit qeveritar dhe institucioneve të arsimit të lartë
- Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje
- Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në familje dhe individë
- Anketa mbi Aktivitetet e Inovacionit në ndërmarrje

4. STATISTIKAT E MJEDISIT DHE MULTIDOMAIN

Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikën e mjedisit, në kuadër të të cilave prodhohen statistikën mbi Llogaritë Monetare Mjedisore, Statistikat mbi Llogaritë Fizike Mjedisore; Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme; "Statistikat e ujit; Statistika e Biodiversitetit. Përsa i përket temës së informacionit statistikor gjeohapësinor, INSTAT me anë të sistemit GIS krijon, mirëmban dhe zhvillon informacionin gjeohapësinor, për qëllime statistikore.

Qëllimi kryesor i statistikave të Mjedisit dhe Multidomain është sigurimi i të dhënave në kohë dhe me cilësi të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mjedisore dhe socio-ekonomike, si dhe monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave. Gjithashtu, qëllim i kësaj fushe statistikore është dhe integrimi i informacionit statistikor dhe atij gjeohapësinor, me anë të të cilit synohet sigurimi i numrit më të madh të mundshëm të statistikave të gjeoreferuara në kohë dhe cilësi nga fusha të ndryshme të statistikave në një nivel territorial të detajuar.

4.1 MJEDISI

Përshkrimi

Nëntema mbi *Llogaritë monetare mjedisore* që ka si qëllim kryesor zhvillimin dhe implementimin e moduleve të llogarive monetare mjedisore të përcaktuara në Rregulloren (BE) Nr. 691/2011 dhe në Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore. Tre modulet kryesore të Llogarive Monetare Mjedisore janë: Taksat Mjedisore sipas Industrive, Sektori i të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore dhe Llogaritë e Shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit.

Përsa i përket nëntemës së *Statistikave mbi Llogaritë fizike mjedisore* qëllimi kryesor lidhet me zhvillimin dhe implementimin e moduleve të llogarive fizike mjedisore. Tre modulet kryesore të Llogarive Fizike Mjedisore janë: Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore, Llogaritë e emetimeve në ajër dhe Llogaritë e flukseve fizike të energjisë.

Nëntema e Statistikave mbi *Menaxhimin e Mbetjeve dhe Substancave të Rrezikshme* siguron të dhëna të harmonizuara për mbetjet në mbështetje të zbatimit dhe monitorimit të politikave mjedisore të BE-së në fushën e mbetjeve. Statistikat e mbetjeve urbane i referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi dhe qarku për prodhimin e treguesve statistikorë standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar dhe atë komunitar, duke implementuar të njëjtat klasifikime dhe përkufizime sipas rregulloreve përkatëse.

Nëntema e Statistikave të ujit ofron informacion statistikor mbi burimet ujore, përdorimin e ujit dhe gjenerimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin. INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën mbi cilësinë e ujërave, të cilat japin informacion për cilësinë e ujit të lumenjve, ndotjen bakterologjike të ujit të detit në plazhe, furnizimin e popullsisë me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura.

Statistikat e qytetit ofrojnë informacion lidhur me cilësinë e ajrit dhe ndotjet.

Nëntema e Statistikave të Biodiversitetit siguron të dhëna të përgjithshme dhe specifike për zonat e mbrojtura, speciet e kercënuara, florën dhe faunën. Këto të dhëna janë vjetore në nivel kombëtar. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të mbrojtura.

Situata aktuale

Lidhur me *Llogaritë monetare mjedisore*, INSTAT aktualisht publikon të dhëna vetëm rreth Taksave Mjedisore, megjithatë të agreguara sipas industrive. Sa i përket *Llogaritë fizike mjedisore*, publikohen të dhëna vetëm rreth Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore. INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon *statistikat mbi mbetjet e ngurta urbane* të cilat japin informacion për gjenerimin, menaxhimin përbërjen dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane, të cilat vijnë nga shërbimet komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara, qoftë dhe përkohësisht.

Gjithashtu, mbledhet informacion mbi shkallën e mbulimit me shërbime për mbetjet urbane, mbetjet inerte nga ndërtimet, informacioni mbi mbetjet industriale në fushat e industrisë minerare dhe hidrokarbureve. Publikimi i statistikave të mbetjeve të ngurta urbane bëhet 9 muaj mbas përfundimit të vitit, në publikime të dedikuara faqen elektronike të INSTAT-it si dhe në publikimet vjetore “*Vjetari Rajonal*”, “*Vjetari Statistikor*” “*Shqipëria në Shifra*”. Të dhënat e publikuara janë në nivel kombëtar dhe rajonal. Aktualisht raportohen në OECD dhe Eurostat të dhëna mbi ujërat e brendshëm, nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm të ujrave JQ-IW.

Gjithashtu INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën mbi *ndotësit e ajrit dhe ndotjen akustike* në qytetet kryesore të Shqipërisë.

Përsa i përket *statistikave të biodiversitetit*, INSTAT mbledh përpunon dhe publikon statistikën mbi rrjetin e zonave të mbrojtura, speciet e kërcënuara të florës dhe faunës, speciet e mbrojtura të florës dhe faunës dhe të dhëna për zonat e mbrojtura sipas kategorive.

Rezultatet e Pritshme

- Disagregimi i Taksave Mjedisore sipas Industrive;
- Prodhimi i të dhënave të Llogarive të Shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Sektorit të të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore;
- Prodhimi i indikatorëve mbi Llogaritë Ekonomike në Mjedis në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Studimi i të gjitha burimeve të mundshme administrative në lidhje me mbledhjen dhe publikimin e të dhënave mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore, Llogaritë e Emetimeve në Ajër dhe Llogaritë e Flukseve Fizike të Energjisë;
- Prodhimi në kohë e me cilësi i statistikave mbi mbetjet industriale sipas burimeve gjeneruese referuar NVE- Rev.2;
- Statistika shtesë;
- Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative të mbledhura;
- Teknika të avancuara të grumbullimit dhe editimit të të dhënave;
- Mbledhja e të dhënave mbi mbetjet industriale në fushat e industrisë minerare dhe hidrokarbureve;
- Statistika të reja për ujërat, sipas standardeve të Eurostat-it;
- Prodhimi në kohë e me cilësi i statistikave të ndotësve të ajrit dhe atyre akustikë në zonat urbane sipas kërkesave të BE-së.

Përputhshmëria me *acquis*

Llogaritë Monetare në Mjedis bazohen në Rregulloren (KE 691/2011) “Mbi Llogaritë Ekonomike Evropiane Mjedisore”.

Llogaritë Fizike Mjedisore bazohen në Rregulloren (KE) 691/2011. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me këtë rregullore. *Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore* publikohen nga INSTAT me periodicitet vjetor dhe në përputhje me metodologjinë e BE-së. INSTAT nuk prodhon dy modulet e tjera të Llogarive Fizike Mjedisore, Llogaritë e Emetimeve në Ajër dhe Llogaritë e Flukseve Fizike të Energjisë, megjithatë puna ka nisur që gjatë zbatimit të këtij programi pesëvjeçar, këto module të prodhohen dhe të jenë të përafëruara me kërkesat e rregullorës specifike.

Statistikat në fushën e mbetjeve të ngurta urbane realizohen duke zbatuar metodologjitë dhe standardet e parashikuara në rregulloret: Rregullorja (KE) Nr. 2150/2002 “Për statistikën e mbetjeve”, Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. b2008/98/EC “Për mbetjet dhe raportimin e detyrueshëm të statistikave për mbetjet”, Rregullorja (KE) Nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në statistikën e mbetjeve, Rregullorja (KE) Nr. 783/2005 “Për kufizimin e përdorimit të disa derivateve që synojnë të jenë në kontakt me ushqimin”, Shtojca II për rregulloren e mbetjeve, Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. 2150/2002 “Për kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikën e mbetjeve”, Rregullorja (KE) Nr. 849/2010 “Për menaxhimin e mbetjeve urbane” dhe Manuali i Eurostatit për statistikën e mbetjeve, i amenduar.

Statistikat në fushën e ujërave realizohen duke zbatuar metodologjitë sipas standardeve evropiane bazuar në rregulloret dhe direktivat e BE, Rregullorja (KE) 2017/1951 “Për amendimin e rregullores Nr. 99/2013 mbi Programin evropian statistikor 2013-2017 duke e zgjeruar deri në 2020”.

Në kuadër të rritjes së nivelit të përputhshmërisë me *acquis*, gjatë zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2020 – 2026 INSTAT do të prodhojë indikatorët mbi Llogaritë Ekonomike në Mjedis (LL.E.M) në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe do të ndërtojë sistemet për fillimin e prodhimit të të dhënave të Llogarive të Shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Sektorit të të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore. Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm lidhur me llogaritë fizike mjedisore me synim rritjen e përputhshmërisë me Rregulloren e (BE) Nr. 691/2011 dhe Strategjinë Evropiane për Llogaritë Mjedisore do të ngrihen sistemet për prodhimin e të dhënave të Llogarive të Emetimeve në Ajër dhe Llogarive të Flukseve Fizike të Energjisë.

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE 691/2011 “Mbi Llogaritë Ekonomike Evropiane Mjedisore”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 2150/2002 “Për statistikën e mbetjeve”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 783/2005 “Për kufizimin e përdorimit të disa derivateve që synojnë të jenë në kontakt me ushqimin”	I pjesshëm	I pjesshëm
Direktiva e KE Nr. 2150/2002 “Për kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikën e mbetjeve”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE Nr. 849/2010 “Për menaxhimin e mbetjeve urbane”	I pjesshëm	I pjesshëm
Rreg. e KE 2017/1951 “Për amendimin e rregullores Nr. 99/2013 mbi Programin evropian statistikor 2013-2017 duke e zgjeruar deri në 2020”	I pjesshëm	I pjesshëm

Aktivitetet statistikore

4.1 Mjediti	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Statistikat mbi Taksat Mjedisore sipas industrive	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Ndërtimi i sistemit për prodhimin e Llogarive të Shpenzimeve për Mbrojtjen Mjedisore				x	x	BA	INSTAT
Ndërtimi i sistemit për prodhimin e modulit të Sektorit të të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore				x	x	BA	INSTAT
Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Ndërtimi i sistemit për prodhimin e Llogarive të Emetimeve në Ajër		x	x	x	x	BA	INSTAT
Ndërtimi i sistemit për prodhimin e Llogarive të Flukseve Fizike të Energjisë		x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat mbi Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat mbi Mbetjet të Ngurta Industriale	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Ujit	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat mbi Cilësinë e Ajrit, Zhurmat dhe mbi Automjetet sipas vjetërsisë në përdorim	x	x	x	x	x	BA	INSTAT
Statistikat e Biodiversitetit	x	x	x	x	x	BA	INSTAT

*VS-Vrojtje Statistikore; *BA-Burime Administrative

Burimet e të dhënave

Burimet Administrative

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Llogaritë Kombëtare
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- Llogaritë Kombëtare
- Bashkitë
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Vrojtjet statistikore

- Vrojtimi 2 vjetor mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta industriale
- Anketa 2 vjetore e përdorimit të ujit në industri.

4.2 INFORMACIONI STATISTIKOR RAJONAL DHE GJEOHAPSINOR

Përshkrimi

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) krijon, mirëmban dhe zhvillon informacionin gjeohapësinor për qëllime statistikore dhe në mbështetje të prodhimit të statistikave, për planifikimin, mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të referuara gjeografikisht, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe rekomandimet evropiane. Në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” (NSDI), dhe në zbatim të Direktivës Evropiane INSPIRE - si pjesë e promovimit, rritjes dhe shkëmbimit të informacionit statistikor, INSTAT ofron shërbimin e hartave online me informacionin e gjeo-referuar tek Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Autoriteti është përgjegjës për të administruar informacionin gjeohapësinor të mbledhur, përpunuar dhe azhurnuar nga institucionet publike dhe për të siguruar koordinimin përmes iniciativave dhe aktiviteteve që lidhen me informacione gjeohapësore në sektorin publik dhe privat.

Situata aktuale

Përsa i përket informacionit Gjeohapësinor, INSTAT disponon infrastrukturën e këtij informacioni të organizuar në sistemin GIS, i cili mbulon gjithë territorin e Shqipërisë. Databaza gjeohapësore, e krijuar për herë të parë në vitin 2011, është përditësuar gjatë vitit 2019 dhe në zona të përzgjedhura gjatë viteve 2020-2021, kryesisht zona urbane me densitet të lartë ndërtimi, për të qenë sa më afër realitetit të fondit të ndërtesave dhe banesave, deri në momentin e kryerjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave. Përditësimi i të dhënave gjeohapësore ka për qëllim mbështetjen e këtij Censi për fazat e planifikimit, realizimit dhe publikimit të rezultateve.

Njëkohësisht, GIS është një komponent i rëndësishëm në realizimin e anketave/vrojtimeve të IN-STAT në funksion të objektivave vjetore ose si shërbim për të tretët (bashkëpunimi me institucione, organizata, etj). Kombinimi i të dhënave gjeohapësore me të dhënat statistikore në funksion të publikimeve të rezultateve dhe analizave tematike ka rritur rolin e gjeostatistikave.

Në kuadër të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI), është përgatitur dokumentacioni me specifikimet teknike në bashkëpunim me ASIG mbi standardet e temave ku INSTAT është përgjegjës, “Demografia” dhe “Njësitë Statistikore”, duke ndjekur direktivën INSPIRE. Në mbështetje të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, INSTAT është përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe harmonizimin e dy temave në gjeoportalin kombëtar.

Gjatë periudhës 2022 - 2026, në përputhje edhe me strategjinë e Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS), synohet:

- zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve të Sistemit të Informacionit Gjeografik dhe gjeoportalit të INSTAT si dhe integrimi i të dhënave statistikore me ato gjeohapësore;
- harmonizimi i temave të INSPIRE;
- dizenjimi i regjistrit të ndërtesave dhe banesave për qëllime statistikore;
- zbatimi i topologjisë territoriale (TERCET) dhe NUTS.

Rezultatet e Pritshme

- Gjeokodifikimi i të dhënave gjeohapësinore (ndërtesë, hyrje, Zonë Censi), për Censin e Popullsisë dhe Banesave;
- Integrimi i të dhënave gjeohapësinore me të dhëna statistikore;
- Publikimi, shpërndarja dhe analiza të thelluara të rezultateve të Censit nëpërmjet hartave tematiko-statistikore.
- Përmirësimi i gjeoportalit të INSTAT-it dhe pasurimi me indikatorë socio-ekonomik;
- Harmonizimi dhe transformimi i temave “Demografia” dhe “Njësitë Statistikore” duke ndjekur rekomandimet e Direktivës INSPIRE. INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me ASIG në kuadër të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI);
- Ndërtimi i regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave për qëllime statistikore, duke përdorur si bazë të dhënat e Censit.
- Formalizimi dhe bashkëpunimi me institucione të cilët do të kontribuojnë në përditësimin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave si: Drejtoria e Përgjithshme e Gendjes Civile (DPGJC); Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), Agjencia e Shtetërore e Kadastrës (ASHK); Bashkitë etj.
- Harmonizimi i klasifikimit të nomenklaturave statistikore (NUTS) në përputhje me rishikimet e Rregullores së Komisionit Europian.
- Zbatimi i topologjisë territoriale (TERCET), duke aplikuar metodologjitë e hartuara nga Eurostat, si: Rishikimi i tipologjisë së rrjetit 1km² sipas klasifikim urban-rural; tipologjia e Njësisë Vendore sipas klasifikimeve: Shkalla e urbanizimit (Degurba), Zonat Urbane Funksionale (FUA); Zonat e vijës bregdetare etj.
- Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të organizuara nga INSTAT, Eursostat dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Përputhshmëria me *acquis*

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore zhvillohet dhe mirëmbahet për të gjithë Republikën e Shqipërisë. Baza e të dhënave gjeohapësinore për qëllime statistikore do të përditësohet dhe mirëmbahet për të mbështetur aktivitetet statistikore (cense, vrojtime, anketa, etj), për të qenë në përputhshmëri të plotë me Sistemin e Informacionit Gjeografik të Eurostat-it (GISCO).

Mbështetur në Programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostat vlerëson të lartë përputhshmërinë e sistemit gjeografik të INSTAT, si dhe mbështet iniciativën e ndërtimit të regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave.

Klasifikimi i Nomenklaturave Statistikore (NUTS) vlerësohet me përputhshmëri të lartë nga Eurostat. Për të qenë në përputhshmëri të plotë edhe me Rregulloren e KE-së Nr. 2017/2391, 12 dhjetor 2017, për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 1059/2003 “*Në lidhje me tipologjitë territoriale (Tercet)*”, INSTAT synon të zbatojë metodologjitë e hartuara nga Eurostat mbi krijimin e topologjisë territoriale (TERCET).

Përputhshmëria me *acquis*

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Niveli aktual i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë në fund të Programit
Rreg. e KE Nr. 2017/2391, 12 dhjetor 2017, për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 1059/2003 "Në lidhje me tipologjitë territoriale (Tercet)"	I pjesshëm	I plotë

Aktivitetet statistikore

4.2 Informacioni statistior rajonal dhe Gjeohapsinor	2022	2023	2024	2025	2026	Burimet e të dhënave	Institucionet Përgjegjëse
Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistike	x	x	x	x	x	-	INSTAT
Harmonizimi i temave "Demografia" dhe "Njësitë Statistike" sipas direktivës INSPIRE	x	x	x	x	x	-	INSTAT; ASIG
Ndërtimi i Regjistrat Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave të Shqipërisë	x	x	x	x	x	-	INSTAT
Klasifikimi Statistikor i Njësitë Territoriale	x	x	x	x	x	-	INSTAT

Burimet e të dhënave

- Censi i Popullsisë dhe Banesave, INSTAT
- Përditësim i vazhdueshëm i të dhënave gjeohapësinore
- Burimet Administrative
- ASIG
- Institucionet për ndërtimin e Regjistrat Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave të Shqipërisë

IV. STATISTIKAT RAJONALE

Realiteti rajonal dhe lokal i një vendi është shumë më tepër kompleks sesa mund të konceptohet dhe kontrollohet zhvillimi politik, ekonomik dhe social në nivel kombëtar. Si rezultat, informacioni statistikor duhet të jetë i disponueshëm në nivele të ndryshme gjeografike. Në Shqipëri, Reforma Territoriale dhe Administrative e Pushtetit të Vetëqeverisjes Vendore dhe procesi i tij i decentralizimit ka rritur veçanërisht kërkesën për statistika të besueshme dhe të përditësuara rajonale dhe lokale për të monitoruar dhe kontrolluar zhvillimin e Shqipërisë dhe rajoneve të saj.

Në vitet e ardhshme, shpërndarja e statistikave rajonale dhe vendore do të jetë një sfidë e madhe për Sistemin Kombëtar Statistikor. INSTAT synon të sigurojë informacion statistikor koherente dhe të krahasueshme kudo që të jetë e mundur, në të gjitha nivelet gjeografike (kombëtare, rajonale dhe lokale) në Shqipëri. Për të arritur këtë qëllim, statistikat zyrtare do të intensifikojnë bashkëpunimin me institucionet publike të nivelit kombëtar dhe vendor. Fokusi do të jetë në të dhënat dhe treguesit kryesorë statistikorë në fusha të veçanta tematike. Informacioni duhet të sigurohet dhe shpërndahet në atë mënyrë që t'i përshtatet të gjithë përdoruesve të informacionit statistikor (siç janë: administrata publike, politikanët, studiuesit dhe publiku në përgjithësi).

Statistikat rajonale dhe koordinimi i tyre

Kërkesa për informacion statistikor në nivel rajonal dhe veçanërisht vendor është rritur me shpejtësi me Reformën Territoriale dhe Administrative të Pushtetit Vendor në Shqipëri. Sistemi Kombëtar Statistikor synon të mbështesë autoritetet vendore në nevojën e tyre për statistika të detajuara rajonale dhe lokale.

INSTAT-i ka diskutuar me partnerët përkatës kombëtarë dhe vendorë një listë të të dhënave dhe treguesve kryesorë statistikorë të nevojshëm për tu përshtatur me strukturën e re territoriale dhe administrative (Njësitë Administrative / Bashkitë) të Shqipërisë. Si rezultat, janë identifikuar fushat e mëposhtme:

- Popullsia dhe dinamika e popullsisë
- Punësimi / papunësia (përbërja e fuqisë punëtore)
- Ndihma sociale
- Përbërja e familjes dhe buxheti i familjes
- Mbetjet
- Shërbimet shëndetësore
- Mbulimi i tokës dhe përdorimi i tokës.

Hapja e negociatave për integrim në BE të rrisë më tej kërkesën për informacion statistikor në Shqipëri jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në atë rajonal. INSTAT synon të përmirësojë disponueshmërinë e të dhënave për statistikat rajonale që do t'i dorëzohen Eurostat-it në temat specifike statistikore të mëposhtme: popullsia, arsimi dhe statistikat e tregut të punës.

Gjithashtu, në përpunje me legjislacionin për statistikat zyrtare, INSTAT synon të forcojë më tej koordinimin e statistikave rajonale dhe vendore me institucionet përkatëse kombëtare dhe vendore gjatë periudhës së këtij programi. Objektivi është të arrihet një koordinim efikas i disponueshmërisë së informacionit statistikor në nivel rajonal dhe lokal mes të gjithë partnerëve, përmes një përpun-

imi të përbashkët të parimeve për mbledhjen e statistikave bazuar në të dhënat administrative dhe regjistrat.

Statistikat rajonale sipas tipologjive

Statistikat zyrtare në Shqipëri përfshijnë statistika rajonale dhe vendore duke përdorur tipologji dhe klasifikime të ndryshme. Për koherencën dhe krahasueshmërinë e statistikave rajonale në kontekstin ndërkombëtar, INSTAT zbaton klasifikimin NUTS (Nomenklatura e Njërive Territoriale për Statistikat). Klasifikimi NUTS është tipologji referimi për mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave rajonale në Sistemin Statistikor Evropian dhe bazohet në një hierarki rajonesh.

Për Shqipërinë:

- NUTS I: Niveli kombëtar
- NUTS II: Rajone të mëdha (Veri, Qendër, Jug)
- NUTS III: Niveli rajonal (12 Qarqe)

Shumica e statistikave rajonale në BE publikohen në nivelin NUTS 2. Megjithatë, statistikat rajonale dhe vendore në Shqipëri duhet të pasqyrojnë edhe njësitë dhe strukturën administrative dhe territoriale të vendit. Reforma Territoriale dhe Administrative e Pushtetit Vendor ka krijuar Bashkitë e reja. Komunitat përbëjnë një nivel më të detajuar të klasifikimit, i cili është me rëndësi qendrore. Informacioni gjeohapësinor përcaktohet më tej nga rajonet, qytetet dhe fshatrat. Të gjitha këto struktura administrative dhe territoriale janë shumë të rëndësishme për statistikën zyrtare. INSTAT synon të sigurojë rregullisht informacione gjeohapësinore bazuar në klasifikimin ndërkombëtar dhe kombëtar dhe tipologjitë për të përshkruar diversitetin lokal dhe rajonal të Shqipërisë. Gjatë periudhës së programit, klasifikimi dhe tipologjitë do të shqyrtohen me kujdes dhe, nëse është e nevojshme, mund të rishikohen edhe tipologji të caktuara.

V. AGJENCITË STATISTIKORE

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, parashikon qartësisht përkufizimin e agjencive statistikore si autoritetin përgjegjës, përveç Institutit të Statistikave, të autorizuar sipas Programit të Statistikave Zyrtare për të ndërmarrë veprimtari për prodhimin e statistikave zyrtare.

Aktualisht, Sistemi Kombëtar Statistikor përbëhet nga INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë.

Duke u bazuar në informacionin e mbledhur nga institucionet prodhuese të statistikave zyrtare, si dhe përpunimin e të dhënave që përmban *database* i këtij programi, është arritur të listohen aktivitetet statistikore që do të kryhen gjatë periudhës pesëvjeçare 2022-2026 për prodhimin e treguesve zyrtarë.

Pasqyra e mëposhtme liston këto agjenci si dhe numrin e aktiviteteve statistikore zyrtare pjesë e Programit.

Tabela nr.9 Agjencitë statistikore dhe numri i aktiviteteve statistikore

Agjencia Statistikore	Numri i aktiviteteve statistikore
Instituti i Statistikave	107
Banka e Shqipërisë	9
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2

VI. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Kuadri ligjor mbi të cilën mbështetet veprimtaria e institucioneve që mbulojnë prodhimin e statistikave zyrtare, është e përbërë nga dy kategori: akte ligjore/nënligjore kombëtare dhe akte ndërkombëtare.

Në kategorinë e parë përfshihen:

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare”, i cili në nenin 7 dhe 8 të tij parashikon detyrimin e hartimit të Programit të Statistikave Zyrtare, si përcaktues i strategjisë së zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor në tërësinë e tij dhe përmbajtjen analitike ku duhet të përfshihen përshkrimi i objektivave zhvillimorë të statistikave zyrtare, përshkrimi i aktiviteteve statistikore kryesore për secilën fushë, frekuenca dhe niveli i përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, institucionet përgjegjëse për furnizimin me të dhëna administrative, si dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, analizën e burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme për përmbushjen e aktiviteteve dhe analizën e risqeve dhe problemeve të pritshme.

Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026, i cili, sipas neneve 7 dhe 8 të ligjit të mësipërm, mbulon të dhënat statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqendruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare. Për realizimin e programit mbahet parasysh parimi i kosto-efektivitetit.

Rekomandimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit të statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbështesë INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikave zyrtare, rekomandimet e marra nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore, si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor, duke garantuar që programi të pasqyrojë nevojat parësore të përdoruesve për informacion statistikor.

Marrëveshjet e Mirëkuptimit. Janë akte të nënshkruara mes dy ose më shumë palëve institucionale, të cilat marrin përsipër përmbushjen e detyrimeve të ndërsjella për shkëmbimin e informacioneve statistikore, format dhe afatet e shkëmbimit të tyre, në mënyrë që të garantohet përmbushja e aktiviteteve statistikore të parashikuara në Program. INSTAT këtë formë bashkëpunimi e ka shtrirë si me institucione publike mbajtës të të dhënave administrative ashtu dhe me institucione akademike.

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSAsë).

INSTAT, së bashku me agjencitë statistikore, ka për detyrë të prodhojë statistika transparente, të paanshme dhe në kohë, duke ndihmuar përdoruesit të gjykojnë mbi ecurinë e proceseve transformuese drejt integritimit në BE. Ky mision ushtrohet në përputhje me mandatin publik dhe institucional që ka INSTAT, duke synuar ngritjen e një sistemi funksional statistikor, i cili të shfrytëzojë maksimalisht burimet e informacionit.

Gjithashtu, në kategorinë e akteve kombëtare futen edhe aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe përcaktojnë detyrat që duhet të mbulojnë agjencitë statistikore, pjesë përbërëse të sistemit statistikor shqiptar. Një listë e plotë e akteve ligjore dhe nënligjore është pasqyruar në Aneksin 1 të këtij Programi.

Në kategorinë e dytë përfshihen:

Konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë

Aktet komunitare të BE-së, të cilat shteti shqiptar i ka marrë përsipër t'i përafrojë në zbatim të nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA-së). Përafrimi i legjislacionit vendas në fushën e statistikave me *acquis communautaire* mbetet një ndër objektivat prioritare, në mënyrë që të garantohej zbatimi i parimeve të statistikave zyrtare, si dhe cilësia e prodhimit statistikor.

VII. SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË

INSTAT synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. INSTAT është angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e statistikave. Në përputhje me Ligjin e Statistikave, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikatat të jenë sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

Në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, në përputhje me parimin nr. 4 “Cilësia Statistikore” të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT nga 2017-2021 ka ndërmarrë iniciativat e mëposhtme:

Publikimin e Deklaratës së Cilësisë dhe Angazhimit për cilësinë të INSTAT- ku përcaktohen parimet, praktikatat dhe angazhimet në lidhje me menaxhimin e cilësinë në statistika, në përputhje me qëllimet e përcaktuara e Misionin dhe Vizionin e INSTAT.

Ngritjen e strukturave për menaxhimin e cilësisë, Komiteti i Cilësisë dhe Sektori i Cilësë, si mekanizma të rëndësishëm për menaxhimin e cilësisë së proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore, në zbatim edhe të rekomandimeve të Eurostat.

Përgatitjen dhe publikimin e Udhëzuesit të Cilësisë si një nga dokumentat kryesore për përshkrimin, pritshmëritë dhe rekomandimet e përgjithshme që duhet të ndiqen në lidhje me proceset statistikore dhe ndërvarësinë midis tyre. Për këtë qëllim INSTAT ka adaptuar versionin GSBPM (Generic Statistics Business Process Model) si një klasifikim referencë në mënyrë që të përshkruajë modelin e prodhimit të secilit aktivitet statistikor.

Rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërgjegjësimin të punonjësve të sistemit statistikor për menaxhimin e cilësisë, INSTAT ka mundësuar zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme mbi këtë fushë.

- Menaxhimin e kujdesshëm të risqeve, si dhe planifikimi në kohë i masave përkatëse parandaluese janë thelbësore për PSZ.
- Auditin statistikor dhe vetë-vlerësimi i përcaktuar si rruga konkrete për identifikimin e pikave të forta dhe mundësive për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo produkti statistikor. Ky është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin për të rritur përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, në vitin 2019 INSTAT nisi zbatimin konkret.
- Implementimin e GSBPM si një model reference. Nëpërmjet këtij modeli monitorohen afateve kohore të të gjitha proceseve statistikore, dokumentimin e tyre si dhe matjen e kosto efektivitetin për aktivitetet statistikore.
- Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, INSTAT ka ofruar Raportet e Cilësisë në nivelin e produkteve statistikore. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion dhe metadat referenciale/strukture me format standard në metodat dhe përkufizimet e aplikuara dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raportëve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS-SIMS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

- Orientimin ndaj përdoruesit - INSTAT përpiqet që të prodhojë statistika sa më afër nevojave të përdoruesve, përpiqet të njohë dhe të përmbush pritshmëritë e tyre dhe në këtë mënyrë të sigurojë përmbushjen e plotë të nevojave për të dhëna statistikore zyrtare. Matja e pritshmërisë së përdoruesve realizohet nëpërmjet Vrojtimit të Kënaqësisë së Përdoruesve;
- Orientimin ndaj punonjësit- INSTAT kujdeset për kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të tyre, duke ndikuar kështu në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së punonjësve të cilët kontribuojnë efektivisht në proceset e punës nëpërmjet Vrojtimit të Kënaqësisë së Punonjësve;

Në Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026, puna do të fokusohet:

- Në përputhje me parimin nr. 1 “Koordinimi dhe bashkëpunimi”, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT dhe Eurostat sigurojnë koordinimin e të gjitha aktiviteteve për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e Statistikave Evropiane në nivel të sistemit kombëtar statistikor dhe sistemit statistikor evropian, përkatësisht. Autoritetet statistikore bashkëpunojnë në mënyrë aktive në kuadër të partneritetit të Sistemit Statistikor Evropian, në mënyrë që të sigurojnë zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane.
- Në përputhje me parimin nr. 4 “Cilësia Statistikore”, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT do të punojë në kuadër të përmirësimit të cilësisë statistikore. Puna do të fokusohet në: hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë dhe metadatave për përdoruesit, dokumentimin e proceseve statistikore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërgjegjësimin të punonjësve të SKS, auditin statistikor dhe vetë-vlerësimin, orientimin ndaj përdoruesit dhe punonjësve.
- Në përputhje me parimin nr. 9 “Ngarkesa ndaj të intervistuarve”, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.
- Në përputhje me parimin nr. 10 “Kosto dhe Efektiviteti”, të Kodit të Praktikave Evropiane, si edhe në përmbushje të rekomandimit nr. 19 të Peer Review, për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe produkteve të aktiviteteve statistikore dhe për përdorimin e informacionit që rezulton për qëllime menaxhimi duke përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit, INSTAT ka ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe produkteve të aktiviteteve statistikore.

Tabelat me poshtë paraqesin informacion mbi indikatorët e performancës për secilën fushë statistikore.

Tabela nr. 10 Menaxhimi i Cilësisë për fushën e statistikave Sociale dhe Demografike

Aktivitetet	2017-2021	2022	2023	2024	2025	2026
Dokumentimi sipas standartit GSBPM	18	16	16	16	15	15
Matja e kostonë së aktiviteteve statistikore	18	0	0	16	15	15
Auditi Statistikor	2	0	0	0	1	0
Pyetësi i vetëvlerësimit	2	1		1	0	1
Raportet e cilësisë/metadatave sipas fushave	16	15	15	15	14	14
Raportet e cilësisë/metadatave sipas fushave të reja		0	0	2	1	1

Tabela nr. 11 Menaxhimi i Cilësisë për fushën e statistikave Ekonomike

Aktivitetet	2017-2021	2022	2023	2024	2025	2026
Dokumentimi sipas standartit GSBPM	12	12	12	12	12	12
Matja e koston së aktiviteve statistikore	12	0	0	12	12	12
Auditi Statistikor	1	0	1	0	1	0
Pyetesori i vetëvlerësimit	2	1	0	1	0	1
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	5	5	5	5	5	5
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja		0	2	0	0	0

Tabela nr. 12 Menaxhimi i Cilësisë për fushën e statistikave Sektoriale

Aktivitetet	2017-2021	2022	2023	2024	2025	2026
Dokumentimi sipas standartit GSBPM	26	23	23	24	24	23
Matja e koston së aktiviteve statistikore	26	0	0	24	24	23
Auditi Statistikor	2	1	0	1	0	2
Pyetesori i vetëvlerësimit	4	0	2	0	2	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	17	15	16	16	17	16
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja		1	0	1	0	0

Tabela nr. 13 Menaxhimi i Cilësisë për fushën e statistikave të Mjedisit dhe Multidomain

Aktivitetet	2017-2021	2022	2023	2024	2025	2026
Dokumentimi sipas standartit GSBPM	4	4	4	4	4	4
Matja e koston së aktiviteve statistikore	4	0	0	4	4	4
Auditi Statistikor	0	0	0	0	0	0
Pyetesori i vetëvlerësimit	0	0	0	0	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	4	4	4	4	4	4
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja				2		2


Tabela nr. 14 Indikatorë të përgjithshëm

Indikatorët	2017-2021	2022	2023	2024	2025	2026
Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT	3,87 (77,3%)	0,0001	0,0001	0,0001	0,0001	0,0001
Përqindja e përdoruesve që shprehin besim/besueshmëri në statistikat kombëtare (në një Anketë)	0,776	0,777	0,778	0,78	0,785	0,79
Ngarkesa e të intervistuarve prane familjeve	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Ngarkesa e të intervistuarve prane ndermarrjeve	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta	33,73	33,63	33,53	33,43	33,33	33,23

Reagimi i përdoruesve gjatë periudhës 2017-2020

Cilësia e proceseve dhe rezultateve statistikore vlerësohet më së miri përmes anketës së kënaqësisë së përdoruesve. Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve, organizuar nga INSTAT, është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, aty ku është e mundur, në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Anketa është realizuar për herë të parë në vitin 2017 dhe kryhet çdo vit. Me qëllim përfaqësimit sa më të gjerë të publikut, linqet për plotësimin e pyetësorit web janë vendosur në faqen online të INSTAT, në faqen zyrtare të INSTAT, si dhe në Facebook. Sipas raundit më të fundit të anketës (2020), niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT në vitin 2020 është rritur me 0,5 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë. Grafiku i mëposhtëm përshkruan krahasimin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve përgjatë viteve 2017-2020.

Figura nr. 6: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT sipas viteve 2017-2020



Gjatë vitit 2020 ka pësuar gjithashtu rritje kënaqësia me faqen e internetit të INSTAT me 0,7 pikë përqindje dhe indikator i besimit se INSTAT ka të dhëna të besueshme me 0,9 pikë përqindje.

INSTAT, gjithashtu, për të matur perceptimin e përdoruesve përdor edhe *Page views*. *Page views* – Shikimi i faqeve është numri i faqeve të shikuara nga vizitorët. Me përjashtim të temave “Bujqësia dhe Peshkimi”, “Censet” dhe “Ekonomi dhe Financë”, temat kryesore të faqes së INSTAT paraqiten me rritje. Në tabelën më poshtë janë renditur temat për nga numri i shikimeve gjatë viteve 2017-2020:

Tabela nr. 15 Page views sipas temave kryesore sipas viteve 2017-2020

Tema	Gjithsej 2017	Gjithsej 2018	Gjithsej 2019	Gjithsej 2020
Shkencë, Teknologji dhe Shoqëria Dixhitale	972	5.189	7.548	8.166
Çmimet	6.202	41.263	31.879	91.016
Bujqësia dhe Peshkimi	3.418	18.800	26.622	25.849
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	2.612	13.961	16.399	16.907
Tregtia e Jashtme	3.357	17.891	22.508	46.558
Kushtet Sociale	5.105	25.463	42.049	48.659
Tregu i Punës dhe Arsimi	14.266	61.446	114.113	130.851
Censet	3.697	14.936	19.050	18.390
Mjedisi dhe Energjia	5.053	11.921	14.725	15.138
Industria, Tregtia dhe Shërbimet	29.469	68.291	74.284	91.851
Ekonomi dhe Financë	73.165	79.014	83.394	72.279
Treguesit Demografikë dhe Socialë	64.233	100.697	133.713	195.443

VIII. BURIMET FINANCIARE DHE NJERËZORE

Për planifikimin e kostove të mbulimit të aktiviteteve statistikore që do të kryhen gjatë periudhës 2022-2026, janë marrë parasysh dokumentet e planifikimit buxhetor, të hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

Në INSTAT funksionon Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipi për Menaxhimin e Programit (EMP), të cilat operojnë jo vetëm për orientimin e strategjive sektoriale, por edhe për planifikimin dhe monitorimin e ekzekutimit të fondeve buxhetore afatmesme për institucionin.

Gjithashtu, dokumente të rëndësishme të planifikimit financiar janë edhe projekt-fishat e plotësuar nga INSTAT për fondet IPA kombëtare dhe me shumë përfitues, marrëveshjet e nënshkruara me Qeverinë Shqiptare dhe asaj Suedeze, të cilat do të mbulojnë një pjesë të madhe të zërave për aktivitetet mëdha statistikore gjatë periudhës pesëvjeçare, si dhe asistencën teknike përkatëse, shumë të nevojshme për garantimin e ecurisë së proceseve në përputhje me standardet e duhura.

Ndërkohë, brenda buxhetit vjetor janë përfshirë edhe zërat e aktiviteteve që janë në proces implementimi, të cilat përfshijnë periudha të Programit paraardhës dhe gjejnë vazhdimësinë në këtë Program.

Një element që ndikon në buxhetin e INSTAT-it është mënyra e mbledhjes së të dhënave. Duke qenë se pjesa më e madhe e tyre kryhet duke përdorur intervistues, atëherë një pjesë e konsiderueshme e buxhetit shërben për mbulimin e shpenzimeve për pagat, dietat dhe të tjera operative.

Në vitin 2022 parashikohet kryerja e Censusit të Popullsisë dhe Banesave dhe për vitin 2024 parashikohet kryerja e Censusit të Regjistrimit të Bujqësisë. Për rrjedhojë, në vitin 2022 dhe vitin 2024 parashikohet përsëri shtesë progresive e buxhetit të INSTAT. Megjithatë, shtesa është relative duke patur parasysh ofrimin e donatorëve, ku mbështetjen më të madhe do ta mbulojë Bashkimi Evropian.

Sa i takon fondeve nga donatorët e huaj, për vitet e ardhshme INSTAT do të përfitojë nga fondet dhe grantet e BE-së (IPA Kombëtare dhe me shumë përfitues), Kombeve të Bashkuara (UNFPA, UNDP) si dhe qeverisë së Zvicrës dhe Suedisë kryesisht për mbulimin e Censusit të Popullsisë dhe Banesave dhe Censusit të Regjistrimit të Bujqësisë.

Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e buxhetit të INSTAT-it për periudhën 2022-2026, i cili është në përputhje me tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, ndërkohë që për vitet pasardhëse është i përafërt.

Tabela nr. 16 Parashikimi i buxhetit 2022-2026 për INSTAT në 000/lek

Produkti	2022	2023	2024	2025	2026
1 Njësi statistikore të vrojtura	890.863	223.639	235.968	235.968	235.968
A Statistikat Sociale dhe Demografike	691.719	78.215	83.130	83.130	83.130
B Statistikat Ekonomike	86.215	60.025	64.050	64.050	64.050
C Statistikat Sektoriale	69.597	43.640	46.922	46.922	46.922
d Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	3.683	2.110	2.217	2.217	2.217
e Shërbime për të tretë (B.SH)	39.649	39.649	39.649	39.649	39.649
2 Personel i trajnuar	377.537	348.361	355.282	355.282	355.282
3 Blerje paisje, sisteme, makineri të ndryshme	300.000	15.600	15.600	15.600	15.600
4 Financim i huaj	400.000				
Totali	1.968.400	587.600	606.850	606.850	606.850

*Shënim: Për vitet 2022-2024 sipas tavanëve buxhetore

Ndërkohë, një pjesë e temave statistikore parashikon burimet shtesë që i duhen Sistemit Kombëtar Statistikor për të garantuar jo vetëm zbatimin e aktiviteteve, por edhe cilësinë e produkteve statistikore. INSTAT duhet të mbështetet me burime njerëzore dhe financiare për përmirësimin e statistikave të domeneve statistikore kryesore si: Statistikat Sociale dhe Demografike, Statistikat Ekonomike, Statistikat Sektoriale, Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain, si dhe për realizimin e aktiviteteve të përfshira për herë të parë në Programin e Statistikave Zyrtare si: Revizionimi Madhor i Llogarive Kombëtare, Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS), Anketa e Arsimit të Rriturve (EAS), Anketa e Shëndetit EHIS; Statistikat mbi cilësinë e jetës etj.

Programi parashikon që brenda vitit 2026 stafi i INSTAT të rritet me 43 punonjës, ndërsa stafi i Bankës së Shqipërisë me 2 punonjës.

Tabela nr. 17 Nevojat për staf shtesë gjatë viteve 2022-2026

Staf shtesë	2022	2023	2024	2025	2026
INSTAT	13	18		12	
Banka e Shqipërisë				2	

IX. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT (pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet) është një kornizë e përdorur për të vlerësuar pozicionin e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare dhe për të zhvilluar programin nga ana strategjike. Analiza vlerëson faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe potencialin aktual dhe të ardhshëm. Ky instrument është krijuar për të lehtësuar vështirimin realist, të bazuar në fakte, të drejtuar nga të dhënat në pikat e forta dhe të dobëta të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe institucioneve mbështetëse.

Analiza SWOT përfshin klimën në të cilën funksionon Sistemi Kombëtar Statistikor, duke vënë në qendër INSTAT-in, si institucioni përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e ecurisë dhe performancës së këtij sistemi. Duke marrë parasysh kuadrin ligjor, ambientin dhe kulturën statistikore të institucioneve prodhuese dhe atyre furnizuese me të dhëna administrative, INSTAT-i ka vlerësuar kapacitetin, mekanizmat dhe burimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara në program.

Një ndihmë të madhe për analizën kanë dhënë dhe japin raportet periodike të vlerësimit, të hartuara nga ekspertët e Eurostatit (*Peer Reviews*), përfshirja e statistikienëve në forumet ndërkombëtare dhe asistenca e huaj për aktivitete të veçanta statistikore.

Në këtë këndvështrim, analiza SWOT hartohet si vijon:

PIKAT E FORTA

- **Legjislacion i përafruar.** Ligji nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” është përafruar me Rregulloren (BE) 223/2009 “Për statistikën Evropiane”, e ndryshuar, në interes të formalizimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, rolit aktiv të përdoruesve dhe ndërtimit të instrumenteve monitoruese/raportuese. Kjo kornizë mundëson zbatimin e parimeve themelore të statistikave zyrtare, duke garantuar besueshmërinë dhe konfidencialitetin statistikor.
- **Staf i kualifikuar, i njohur për profesionalizmin dhe eksperiencën.** Personeli i sistemit statistikor, veçanërisht i INSTAT-it, gëzon kapacitetet profesionale jo vetëm në fushat statistikore, por edhe në ato mbështetëse, si teknologji informacioni dhe administrative.
- **Strukturë trajnimi.** Qendra e Trajnimit, sipas kërkesave të ligjit për statistikën zyrtare, ka mundur përgatitjen e trajnerëve dhe moduleve më të rëndësishme për të rritur kapacitetet profesionale të statistikienëve. Trajnimet ofrojnë njohuri mbi harmonizimin dhe standardet e akteve ndërkombëtare, njohuri teknike për disa fusha statistikore dhe njohuri themelore në aspektin menaxherial/lidership.
- **Mbështetje ndërkombëtare.** Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet nga programet e Bashkimit Evropian dhe të disa vendeve anëtare për kryerjen e sukseshme të aktiviteteve statistikore si dhe modernizimin e fazave të ndryshme të procesimit. Njëkohësisht, mbështetja ka ndihmuar në proceset e vlerësimit të performancës për të evidentuar pikat që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në të ardhmen.
- **Mandat i konsoliduar për aksesin në të dhëna.** Legjislacioni për statistikën zyrtare ngarkon çdo institucion publik, mbajtës i të dhënave administrative, të furnizojë prodhuesit e statistikave zyrtare me informacionin e duhur vetëm për qëllime statistikore.

- **Infrastrukturë moderne IT.** Me mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve është mundësuar ndërtimi i sistemeve IT në përputhje me kërkesat e kohës, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale të stafit IT. Aftësia e stafit IT dhe monimtorimi i vazhdueshëm i përparimeve teknologjike mundësojnë vendosjen në të njëjtin nivel me më të përparuarit.
- **Marrëdhënie ndërkombëtare.** Prodhuesit e statistikave zyrtare janë në gjendje të bashkëpunojnë me partnerët e huaj për projekte të ndryshme rajonale dhe më gjerë si dhe të kontribuojnë në nxjerrjen e udhëzimeve përmirësuese për prodhim statistikor. Nga ana tjetër, bashkëpunimet kanë ndikuar në rritjen e njohurive nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave.
- **Konfidencialiteti i të dhënave.** Për të rritur besueshmërinë e individëve, INSTAT dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare kanë ndërtuar infrastrukturën e duhur ligjore dhe teknike për të garantuar trajtimin e të dhënave të tyre si konfidenciale dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Këshilli i Statistikave si zëri i përdoruesve.** Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klienti i produkteve statistikore. Këshilli i Statistikave përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve kryesorë në vend. Zëri i tyre ndihmon në proceset e planifikimit statistikor dhe monitorimit të performancës së sistemit.
- **Cilësia statistikore.** Përdorimi i instrumenteve GSBPM, Metadata, SIMS dhe Raportet e Cilësisë, shërbejnë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve statistikore, por edhe për rritjen e transparencës së prodhuesve në lidhje me publikun.
- **Plani i vazhdimësisë.** Për arsye të eksperiencës negative të shkaktuar nga shkaqet madhore, tërmetet dhe pandemia, INSTAT ka hartuar Planin e Vazhdimësisë për reagimin e institucionit në rast të ndeshjes së pengesave të tilla në të ardhmen.
- **Mbështetje e qeverisë mbi besueshmërinë në të dhënat statistikore zyrtare.** Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM nr. 650, datë 10.11.2017, ka shprehur angazhimin e tij për të respektuar kërkesat e standardeve evropiane dhe parimet statistikore, ka garantuar ruajtjen e pavarësisë profesionale të INSTAT-it dhe alokimin e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore për kryerjen e aktiviteteve statistikore të programit.

PIKAT E DOBËTA

- **Burime të pamjaftueshme.** Burime të pamjaftueshme njerëzore nuk mundësojnë përmbushjen e kërkesave në rritje për statistika zyrtare.
- **Lëvizja e stafit.** Politikat e motivimit të institucionit nuk mjaftojnë për të minimizuar lëvizjet/largimet e stafit, të cilat ndikojnë në vonesa në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.
- Duke patur parasysh kapacitetet e sektorit privat, institucionet publike të cilat merren me prodhim statistikor nuk janë në gjendje të mbajnë stafin për të cilët është investuar në vite për aftësi profesionale.
- **Sistemi i trajnimit jo i konsoliduar.** Sistemi nuk është i zhvilluar akoma në formë të tillë që të ndikojë sa duhet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe menaxheriale.

- **Auditi statistikor.** INSTAT, nën cilësinë e institucionit përgjegjës për të garantuar zbatueshmërinë e parimeve statistikore, nuk zotëron kontroll të mjaftueshëm mbi cilësinë e të dhënave të ofruara nga institucionet publike dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, kryesisht mbi saktësinë, përpikmërinë, afatin kohor, etj.
- **Edukimi statistikor.** Mangësitë në njohuritë statistikore ndikojnë negativisht në interpretimin e drejtë të treguesve statistikore nga grupet e interesit, siç janë përdoruesit dhe media. Për këtë, trajnimi i përdoruesve për fusha të ndryshme të statistikës do të ndikonte në rritjen e shkallës së interpretimit dhe analizave të informacionit statistikor.
- **Forma të pamjaftueshme komunikimi me aktorët.** Format e komunikimit me aktorët kryesorë duhet të zhvillohen më tej. Duhet punuar veçanërisht për një komunikim më të mirë me institucionet që sigurojnë të dhënat administrative.
- **Shpërndarja e informacionit statistikor.** Disponimi i një kalendari publikimi nuk është i mjaftueshëm për të patur një politikë të qartë shpërndarjeje të statistikave zyrtare. Prandaj, duhen ndërmarrë veprime të tjera zhvilluese për të përcaktuar mënyrat më të mira të publikimit dhe transmetimit prodhimit statistikor, për të vendosur në format PDF të gjitha të dhënat e prodhuara, etj.

MUNDËSITË

- **Integrimi Evropian.** Hapja e negociatave për anëtarësim në BE do të rrisë nevojën për më shumë statistika reale dhe të besueshme. Parneriteti midis INSTAT-it dhe Eurostatit në këtë drejtim, krijon dhe premton mundësi për shkëmbime frytdhënëse të eksperiencave më të mira. Procesi i integritetit ndihmon gjithashtu personelin të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit drejt standardeve evropiane. Nga ana tjetër, përafrimi me *acquis communautaire* ndikon në forcimin e legjislacionit të statistikave zyrtare dhe konsolidimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.
- **Modernizimi i teknologjisë.** Përparimet në teknologjitë e informacionit sjellin përmirësime në sistemet e komunikimit midis INSTAT-it, furnizuesve me të dhëna administrative dhe përdoruesit.
- **Procesi zhvillimor për cilësinë statistikore.** Përmirësimet në aspektin e cilësisë së statistikave që prodhon sistemi, ndikojnë në zbatimin e parimeve statistikore si dhe transparencën e besueshmërinë e publikut në to.
- **Përmbytje e kërkesave.** Statistikat zyrtare të prodhuara do të mbështesin politikbërësit për hartimin e dokumenteve strategjike, politikave makroekonomike dhe sociale si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.

KËRCËNIMET

- **Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky Program** nga të gjithë aktorët, si: mosrespektimi i afateve kohore për dërgimin e të dhënave dhe informacioni jo i plotë nga njësitë statistikore dhe siguruesit e të dhënave administrative, do të sillte vonesë në zbatimin e aktiviteteve statistikore sipas afateve të parashikuara dhe mangësi në sasinë dhe cilësinë e treguesve.

- **Mungesa e strukturave statistikore** si dhe rishikimi i herëpashershëm i strukturës organizative në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera që sigurojnë të dhënat administrative, rrezikon zbatimin cilësor të këtij programi.
- **Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore** mund të rrezikojë moskryerjen e vërtetimeve të parashikuara në këtë Program.
- **Mospërdorimi i klasifikimeve të njëjta në të gjitha institucionet.** Nëse nuk do të arrihet përdorimi i klasifikimeve të parashikuara të implementohen gjatë zbatimit të këtij programi, atëherë kjo do të sillte mospërputhshmërinë e të dhënave për të njëjtët tregues.
- **Sulmet kibernetike** mund të çojnë në cënim të konfidencialitetit statistikor (cënim të sigurisë së mbrojtjes së të dhënave/ dhe në sistemin SIMONA).
- **Mospërafrimi i akteve me *acquis communautaire*** cënon mosrealizimin e programit sipas standardeve evropiane, duke penguar/vonuar procesin e integritetit në fushën e statistikave.

X. ANALIZA E RISQVE DHE PROBLEMEVE TË PRITSHME


Menaxhimi i kujdesshëm i risqeve, si dhe planifikimi në kohë i masave përkatëse parandaluese janë thelbësore për zbatimin me sukses të PSZ 2022-2026. Në këtë kapitull në zbatim të gërmës d, të nenit 8, të ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, është kryer analiza e risqeve dhe problemeve të pritshme që mund të çënojnë realizimin e objektivave strategjike të PSZ 2022 – 2026 dhe rrjedhimisht realizimin e aktiviteteve statistikore. Analiza ka si qëllim evidentimin, vlerësimin e risqeve dhe më tej bazuar në Planin e Menaxhimit të Riskut përcaktimin e masave që do të merren për eliminimin apo reduktimin e riskut gjatë kohëzgjatjes së programit. Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve është kryer duke mbajtur në konsideratë objektivat strategjike të INSTAT të përcaktuar në kapitullin III të PSZ 2022-2026, të cilat janë si më poshtë:

1. Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian;
2. Plotësimi i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare;
3. Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare;
4. Rritja e numrit të institucioneve pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor;
5. Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare;
6. Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur.

Bazuar në këto gjashtë objektiva, nëpërmjet një procesi të strukturuar për vlerësimin e riskut në bazë të mundësisë së ndodhjes dhe vlerësimit të impaktit për çdo risk, është kryer përcaktimi i risqeve duke analizuar shkaqet, si dhe pasojat e mundshme në rast se këto risqe materializohen.

Nga analiza e identifikimit dhe vlerësimit të riskut është konstatuar se risqet kryesore të cilat mund të materializohen dhe ndikojnë në realizimin e objektivave të parashikuara në PSZ 2022 – 2026 janë gjithsej 26 (të cilat janë të përfshira në regjistrin e riskut të INSTAT). Këto risqe të identifikuara tregojnë se INSTAT ka kryer një analizë të detajuar për secilin objektiv, duke identifikuar risqet që mund të ndeshen duke impaktuar objektivat.

Sikurse konstatohet në matricat e mëposhtme Matrica nr. 1 (Vlerësimi i riskut para kontrolleve) dhe Matrica nr. 2 (Vlerësimi i riskut pas kontrolleve), vihet re se kemi një rënie të konsiderueshme përse i përket mundësisë dhe impaktit të risqeve, si rrjedhojë e kontrolleve efiente dhe efektive, të cilat janë të vendosura në institucion.



Një tregues i qartë që vërteton përmirësimin e dukshëm dhe reagimin e INSTAT janë risqet me nivel të lartë. Tek kjo kategori para kontrolleve ekzistuese ishin 9 risqe (të përshkruara në vijim), ndërsa pas kontrolleve ekzistuese mbetet 1 risk me nivel të lartë.

Duke qenë se risku është dinamik strukturat menaxheriale do t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë monitorimit të risqeve me qëllim që të mos ndikojnë në objektivat e përcaktuara. Një tjetër tregues i cili vërteton që ekziston një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm janë risqet me nivel të ulët në Matricën nr. 1 (para kontrolleve), ku janë identifikuar 6 risqe, ndërsa në Matricën nr.2 (pas kontrolleve) janë 19 risqe me nivel të ulët, duke pësuar një rritje si rrjedhojë e aktiviteteve të kontrollit që synojnë minimizimin e tyre.

Risqet me impakt të lartë

Risqet kryesore me impakt të lartë që mund të hasen gjatë zbatimit të PSZ 2022-2026, si dhe masat që do të ndërmerren nga INSTAT për minimizimin e tyre bazuar në Planin e Menaxhimit të Riskut janë të përshkruara si më poshtë:

- 1. Vonesa ose mospublikim të statistikave zyrtare, si pasojë e pezullimit/vonesës së mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit të të dhënave për shkak të Fatkeqësive Natyrore dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme.**

Duke mbajtur në konsideratë këtë risk INSTAT do të vijojë të përditësojë dhe zbatojë planet e vazhdimësisë për aktivitetet statistikore, duke ndjekur të gjitha fazat e parashikuara për situatat e fatkeqësive natyrore dhe ngjarjeve të tjera të jashtëzakonshme.

Nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit të disponueshme do të ndiqet një komunikim periodik si brenda strukturave përgjegjëse në INSTAT (qendër dhe zyra rajonale), ashtu dhe me agjencitë statistikore apo institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative, për përmbushjen e fazave

sipas kalendarit të punës në varësi të situatës. Gjithashtu, do të ndiqen konsultime të vazhdueshme mbi zbatimin e koncepteve dhe metodologjive me qëllim përpunimin cilësor të informacionit në përputhje me rekomandimet e EUROSTAT në kushtet e situatave të krijuara në nivel Global.

2. Vonesa në marrjen e të dhënave nga institucionet furnizuese, sjell vonesa/mos publikim në kohë të rezultateve të vrojtimeve.

INSTAT mban një komunikim të vazhdueshëm dhe bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative, nëpërmjet organizimit të mbledhjeve periodike në nivel institucionesh, për evidentimin e problemeve që mund të sjellin riskun e mospublikimit në kohë të rezultateve. Gjithashtu, ndiqen komunikime të vazhdueshme zyrtare (elektronike ose shkresa zyrtare) me personat e kontaktit në institucione, të cilët janë përgjegjës për dërgimin e informacionit. Njëkohësisht, INSTAT monitoron periodikisht zbatimin e memorandumeve të bashkëpunimit në kuadër të shkëmbimit të të dhënave administrative.

3. Vonesa e dërgimit të informacionit nga agjensitë statistikore sjell mangësi/mosplanifikim dhe mosraportim në kohë të aktiviteteve statistikore në nivel Sistemi Kombëtar Statistikor.

Programi i Statistikave Zyrtare dhe Raporti Vjetor janë dokumente të hartuara me input nga i gjithë sistemi statistikor në Shqipëri (INSTAT dhe agjencitë statistikore). Me qëllim minimizimin e riskut të mosdërgimit në afat të të dhënave mbahet një komunikim i vazhdueshëm me institucionet e përfshira, si nëpërmjet takimeve periodike ashtu edhe nëpërmjet dërgimit të shkresave zyrtare tek Agjencitë Statistikore. Gjithashtu, kryhen dhe kontrole të cilësisë strukturore dhe përmbajtësore të inputeve, me qëllim planifikimin e statistikave cilësore.

4. Sulmet kibernetike mund të çojnë në cënim të konfidencialitetit statistikor (cënim të sigurisë së mbrojtjes së të dhënave/ dhe në sistemin SIMONA).

Për të minimizuar këtë risk INSTAT kryen kontrole fizike ditore të datacenter, testime paraprake për funksionimin e sistemit SIMONA. Janë marrë masat për ngritjen e një sistemi backup jashtë godinës, në mënyrë që të ruhen të dhënat në rast katastrofash natyrore, si dhe mirëmbajtja e sistemit Backup në vazhdimësi. Gjithashtu, do të vijohet të kryhen monitorime periodike (mujo-re, 6 mujo-re), si dhe trajnime të stafit në fushën e sigurisë së informacionit.

5. Mosmiratimi i burimeve financiare të nevojshme sjell si pasojë mosrealizimin e aktiviteteve statistikore të parashikuara në PSZ.

Miratimi i burimeve financiare të nevojshme (lidhur me sigurimin e infrastrukturës, si dhe rekrutimin e burimeve njerëzore të nevojshme) është element kyç për realizimin e aktiviteteve statistikore. Në këtë kontekst INSTAT në programin buxhetor 2022-2024 ka parashikuar financimin e nevojshëm për aktivitetet statistikore.

6. Vonesa në përafrimin e akteve rregullatore përkatëse të statistikave me Acquis Communautaire, si rezultat i mosidentifikimit të akteve prioritare që duhet të përafrohen, si dhe vonesat në procesin e miratimit të akteve përkatëse.

Për të minimizuar këtë risk nga INSTAT do të merren masa për përgatitjen në kohë të propozimeve konkrete për harmonizimin e acquive, ndjekjen e miratimit dhe adaptimit të tyre nga institucioni.

Gjithashtu, do të organizohen takime të vazhdueshme ndërsektoriale me qëllim zgjidhjen e situatave penguese gjatë procesit.

7. Mosrespektimi i kalendarit të publikimeve sjell si pasojë mosshpërndarjen në kohë të informacionit statistikor tek përdoruesit, si dhe cënimin e imazhit të INSTAT.

Me qëllim publikimin në afat të statistikave zyrtare dhe informimin në kohë të përdoruesve, INSTAT do të vijojë të kryejë monitorim të vazhdueshëm të kalendarit të publikimeve, nëpërmjet kujtesës së vazhdueshme për respektimin e afateve.

8. Lëvizjet/largimet e stafit (kryesisht stafit me eksperiencë) shkaktojnë ndërprerje/ngadalësim të proceseve të punës, si pasojë pezullim/vonesa në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.

Stafi i kualifikuar dhe me eksperiencë është kyç për prodhimin e statistikave zyrtare cilësore. Për arsye të mungesës së motivimit/pamundësisë së rritjes profesionale/pagës së stafit të INSTAT, ekziston risku i lëvizjes së stafit me eksperiencë, kryesisht në fushën e zhvillimit të programeve kompjuterike. Në këtë kontekst, do të merren masa për motivimin e stafit nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve, parashikimit për shtimin gradual të stafit. Gjithashtu, do të vijohet me caktimin e stafit mbështetës (*backup*) për procese të caktuara, si dhe automatizimin e mëtejshëm të proceseve të punës.

9. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimeve, sjell si pasojë mungesën e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktiviteteve statistikore.

Bazuar në buxhetin vjetor të miratuar INSTAT detajon çdo vit investimet e nevojshme në fushën e teknologjisë dhe informacionit, si dhe shërbimet që nevojiten për mbarëvajtjen e aktiviteteve statistikore. Bazuar në legjislacionin në fuqi ndiqen të gjitha procedurat për garantimin e infrastrukturës së nevojshme.

Pavarësisht kontrolleve që janë në zbatim, të cilat ndihmojnë në minimizimin e nivelit të riskut, strukturat e INSTAT në vazhdimësi do të analizojnë dhe evidentojnë mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, me qëllim realizimin e objektivave në mënyrë efikase dhe efektive, si dhe minimizimin e risqeve. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm i risqeve dhe masat përkatëse në zbatim apo të parashikuara për të mbajtur nën kontroll risqet, mund të shprehem se INSTAT ka një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm, i cili garanton zbatimin e suksesshëm të PSZ 2022-2026.

SHTOJCA

Aneksi nr. 1 Plani i aktiviteteve statistikore

ANEKSI NR. 1 PLANI I AKTIVITETEVE STATISTIKORE

Kodi i Fushës Statistikore	Fusha Statistikore	Kodi i Temës	Tema	Kodi i nëntemës	Nëntema	Kodi i Aktivitetit statistikor	Aktiviteti	Periodiciteti i aktivitetit	Viti i realizimit të aktivitetit	Përshkrimi i Aktivitetit	Afati i publikimit	Niveli minimal i Publikimit të të dhënave	Agjencia Statistikore	Ofruesi i të dhënave
1	Statistikat Sociale dhe Demografike													
		1.1	Popullsia me Vendbanim të Zakonshëm në Shqipëri dhe Jashtë saj											
				1.1.1		Demografi, Migracion dhe Projektione								
						1.1.1.1	Statistikat e Popullsisë	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i statistikave të popullsisë prodhon të dhëna mbi popullsinë më 1 Janar të çdo viti, popullsinë sipas grup-moshës dhe gjinisë, popullsinë sipas qarqeve dhe komponentët bazë të cilët përbëjnë popullsinë (Lindjet, Vdekjet, Migracion Neto).	V + 84 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
						1.1.1.2	Projeksionet e Popullsisë	Çdo 5 vite	2024	Aktiviteti i Projektioneve të Popullsisë jep informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljet demografike.	V - 293 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
						1.1.1.3	Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Migracionit Ndërkombëtar prodhon të dhëna për: Emigrantët, Imigrantët, Migracionin Neto, Lëvizjet e brendshme dhe Indiktorë të tjerë të migracionit.	V + 84 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
						1.1.1.4	Statistikat e Diasporës shqiptare	Çdo 5 vite	2025	Aktiviteti i statistikave të diasporës shqiptare prodhon të dhëna për diasporën më 1 Janar, destinacionet kryesore, piramiden e diasporës etj.	V+ 335 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
						1.1.1.5	Statistikat Vitale	Tremujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i statistikave vitale prodhon të dhëna për: Lindjet, Vdekjet, Martesat, Divorcet, si dhe indikatorë të tjerë lidhur me statistikat vitale.	T + 45 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

					1.1.1.6	Statistikat nga Anketa MICS	I vazh- dueshëm	2024	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë të Shqipërisë është një studim përfaqësues kombëtar me bazë kampioni tek familjet, gratë dhe fëmijët. Me anë të kësaj ankete syno- het të sigurohet informacion i ri për vlerësimin e situatës së fëmijëve dhe grave në Shqipëri dhe për të siguruar të dhënat e nevojshme për monitorimin e progresit drejt synimeve të përcaktuara.	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	
				1.1.2	Censi i Popullsisë dhe Banesave, Azil-kërkuesit dhe të huajt								
					1.1.2.1	Censi i Popullsisë dhe Banesave	Çdo 10 vite	2022	Censi i Popullsisë dhe Banesave ofron të dhëna mbi numrin zyrtar të popullsisë në një vend, në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë. Në mënyrë të ngjashme, Censi i Banesave ofron numërimin zyrtar të të gjitha banesave në vend në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave të banesave.	V + 273 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
					1.1.2.1. a	Lançimi i rezultateve paraprake të Censit				Dhjetor 2022			
					1.1.2.1. b	Lançimi i rezultateve përfundimtare të Censit në nivel kombëtar				Qershor 2023			
					1.1.2.1. c	Lançimi i rezultateve përfundimtare të Censit në nivel qarku/ bashkie				Tetor 2023			

[illegible]

[illegible]

					1.3.1.3	Statistika të Arsimit sipas Fushave të Studimit në Arsimin e Lartë	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i statistikave të arsimit prodhon të dhëna mbi arsimin zyrtar në Shqipëri, publik dhe privat, si dhe statistika të detajuara lidhur me regjistrimet dhe diplomimet sipas niveleve arsimore, dhe programeve të studimit në arsimin e lartë.	V + 150 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	
					1.3.2	Trajnimin Profesional dhe të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës								
					1.3.2.1	Statistika nga Anketa e Arsimit të të Rriturve	Çdo 5 vite	2023	Anketa siguron informacion mbi karakteristikat e trajnimeve, vështirësitë e pjesëmarrjes në trajnime, qasjen në informacion mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit, aftësitë mbi gjuhët e huaja, pjesëmarrjen në eventet kulturore etj.	V + 365 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	
					1.4	Shëndetësia								
					1.4.1	Shëndeti Publik								
					1.4.1.1	Statistika mbi Shkaqet e Vdekjeve	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave mbi Shkaqet e Vdekjeve prodhon të dhëna mbi vdekjet e regjistruara në një vit të dhënë në Shqipëri. Këto statistika analizohen dhe publikohen duke u bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, ICD-9	V + 140 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	

						1.4.1.2	Statistika të Shëndetit Publik	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Shëndetësisë mbi Treguesit e Shëndetit Publik prodhon të dhëna mbi: shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor, në të cilin pasqyrohet një informacion mbi aktivitetin e qendrave shëndetësore, numrin e vizitave, konsultoret e gruas, konsultoret e fëmijëve, mbulimin vaksinal etj; shërbimit spitalor dytësor në të cilin pasqyrohet një informacion mbi numrin e spitaleve, numrin e pacientëve të shtruar dhe të dalë gjatë vitit, numri i operacioneve si dhe shfrytëzimi i shërbimit spitalor (ditë qëndrimi mesatar, xhiro e shërbimit në vit etj.	V + 201 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Instituti i Shëndetit Publik Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
						1.4.1.3	Statistika nga Anketa e Shëndetit EHS	I vazhdueshëm	2026	Aktiviteti i Statistikave nga Anketa e Shëndetit EHS synon të prodhojë të dhëna të plota për gjendjen shëndetësore; përdorimin e kujdesit shëndetësor; përcaktuesit e shëndetit.			Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
						1.4.2 Statistika të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë								
						1.4.2.1	Statistika të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë	Vjetor	2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë prodhon të dhëna mbi ndodhjen e aksidenteve gjatë punës, e cila çon në dëmtime fizike ose mendore. Aksidentet fatale në punë janë ato që çojnë në vdekjen e viktimës nga aksidenti që ka ndodhur.		Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Sigurimeve Shoqërore

							1.5.3	Cilësia e Jetës	Aktiviteti i Statistikave të Cilësise së Jetës prodhon të dhëna mbi faktorë objektivë si: burimet materiale, shëndeti, statusi i punësimit, kushtet e jetesës dhe shumë të tjerë dhe mbi perceptimin subjektiv që dikush ka për këto faktorë.	V + 180 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
							1.6	Mbrojtja Sociale					
							1.6.1	Statistikat e Mbrojtjes Sociale	Aktiviteti i Statistikave të Mbrojtjes Sociale prodhon të dhëna mbi numrin e personave përfitues të pagesës së papunësisë, familjet dhe personat përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, personat përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar, përfituesit e pensioneve urbane dhe rurale në skemën e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu ne statistikën e mbrojtjes sociale përfshihen edhe shume tregues që vlerësojnë mireqenien dhe kujdesin ndaj fëmijëve në nevojë.	4M + 60 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shërbimi Social Shtetëror Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësie
							1.6.1.1	Statistika të Mbrojtjes Sociale (të dhëna administrative)	2022 2023 2024 2025 2026	I vazhdueshëm			
							1.6.1.1.a	Ndihma ekonomike		4-mujor			
							1.6.1.1.c	Aftësia e kufizuar		4-mujor			
							1.6.1.1.d	Pagesa e papunësisë		Tremujor			
							1.6.1.1.e	Pensionet		Vjetor			
							1.6.1.1.f	Kujdesi për fëmijët në nevojë		Vjetor			

						Statistika të Personave të Dyshuar, të Pandehur dhe të Burgosur	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026		Aktiviteti i Statistikave të Drejtësisë dhe Krimit prodhon të dhëna për çdo halikë të sistemit të Drejtësisë, jo vetëm të çështjeve të trajtuara dhe regjistruara, por edhe të personave të përfshirë në sistemin e drejtësisë si: të dhënat mbi një veprë penale; të dhënat mbi të pandehurit; të dhënat mbi të burgosurit që përfshijnë personat e mitur (nën 18 vjeç), të rritur (mbi 18 vjeç) sipas gjinisë, të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë si edhe të paraburgosurit ndër vite.	V + 119 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prokuroria e Përgjithshme Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
						Statistika të Personave të Dënuar dhe të Pafajshëm	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026		Statistikat e personave të dënuar dhe të pafajshëm sigurohet nga Ministria e Drejtësisë dhe përfshijnë të dhëna mbi të dënuarit nga gjykatat e shkallës së parë sipas gjinisë dhe grupmoshës, të dënuarit sipas llojit të krimit të kryer, dhe numrin e të dënuarve sipas gjinisë.	V + 305 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Ministria e Drejtësisë
						Zbatimi i Klasifikimit ndërkombëtar i krimeve për qëllime statistikore (ICCS)	I vazhdueshëm	2022 2023 2024 2025 2026		Klasifikimi ndërkombëtar i krimeve është një nomenklaturë e cila klasifikon veprat penale bazuar në koncepte, përkufizime dhe parime të pranuar ndërkombëtarisht për të rritur konsistencën dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare të statistikave të krimeve dhe për të përmirësuar aftësitë analitike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.			Instituti i Statistikave	Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prokuroria e Përgjithshme Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

2	Statistikat Ekonomike									
	2.1	Makroekonomike								
		2.1.1	Llogaritë Sektoriale Vjetore							
			2.1.1.1	Llogaritë jo-financiare sipas Sektorëve Institucional	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Llogarive Jo-financiare të Sektorëve Institucionalë prodhon të dhëna mbi transaksionet ekonomike midis sektorëve institucionalë brenda ekonomisë dhe transaksionet e sektorëve vendas me pjesën tjetër të botës, duke i ndarë ato në burime, përdorime dhe një zë balancues, i cili kalon nga njëra llogari në tjetrën, duke krijuar lidhjen ndërmjet tyre.	V + 881 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave Instituti i Statistikave Instituti i Statistikave Banka e Shqipërisë
		2.1.2	Llogaritë Kombëtare Tremujore dhe Vjetore, Agregatët kryesorë							
			2.1.2.1	Llogaritë Kombëtare Vjetore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i statistikave të Produktit të Brendshëm Bruto me frekuencë vjetore mat prodhimin e të gjithë ekonomisë së një vendi përmes metodës së prodhimit si dhe shpenzimet e realizuara nga të katërt këta sektorë të ekonomisë: Familjet, Ndërmarrjet, Qeveria dhe Sektori i Jashtëm përmes metodës së shpenzimeve. Vlerësohen disa indikatorë si: vlera e shtuar bruto, prodhimi dhe konsumi ndërmjetes, shpenzime për konsum final të popullatës, formimi bruto i kapitalit fiks, eksport-importet etj me cmime korrente dhe konstante, rritja reale e PBB, PBB për frymë, të ardhurat kombëtare bruto etj.	V + 455 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave Banka e Shqipërisë Drejtoria e Tatimeve Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

[illegible]

[illegible]

					2.3.3.3	Statistika mbi Lejet e Ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë	Tremujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Lejeve të Ndërtimit prodhon të dhëna mbi lejet e ndërtimit të miratuara në Republikën e Shqipërisë lidhur me Numrin, Sipërfaqjen, Vlerën e përafërt dhe Tipin e klientit.	T + 57 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Bashkitë
Regjistrat e Bizneseve													
			2.3.4		2.3.4.1	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve shërben për qëllime statistikore dhe identifikon qartësisht njësitë në mënyrë që: Të lejojë marrjen e informacionit për njësitë ekonomike nëpërmjet burimeve administrative; Të lejojë përgatitjen e kampioneve, koordinimin e vrojtmeve statistikore dhe grupimin e rezultateve të tyre; Të lejojë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësiave lidhur me to. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve është bazë për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e treguesve afatshkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike.	V + 150 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Qendra Kombëtare e Biznesit
					2.3.4.2	Regjistri i Njësiave Lokale	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Regjistri i Njësiave Lokale përmban të gjitha vendndodhjet e biznesit, aktivitetet ekonomike e të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.). Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj (p.sh manufakturë, fabrike, magazinë, zyrë, minierë apo depo) të ndodhura në zona të identifikuara gjeografikisht. Tek ky apo nga ky vend ushtrohet aktiviteti ekonomik për të cilin punojnë një ose më shumë persona (edhe pse me kohë të reduktuar) për një ndërmarrje të vetme.	V+150 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

										Aktiviteti i Statistikave administrative të Prodhimit bimor dhe metodave të prodhimit bimor prodhon të dhëna mbi sipërfaqen e mbjellë kulturë e parë, sipërfaqen e kultivuar, prodhimin, rendimentin, përmbytjen e lagështisë, sipërfaqen prodhuese sipas grup-kulturave (kultura në tokë arë, drufrutore, dhe livadhe), në sipërfaqe të hapura apo në serra dhe prodhimet organike në bujqësi.	V + 175 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	
										Aktiviteti i Statistikave të Sipërfaqes së Mbjetllë prodhon të dhëna mbi sipërfaqen e mbjetllë kulturë e parë, për kulturat në tokë arë/të punueshme: drithërat; bimë industriale; bimët hortikulturore, patate, fasule dhe kulturat foragjiere, si dhe të dhëna mbi sipërfaqet e drufrutoreve si: sipërfaqja gjithsej, në prodhim dhe mbjetlljet e reja.			Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	
										Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve					
										Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve nga Vrojtimi Vjetor në Bujqësi	2025 2026	Vjetor		Instituti i Statistikave	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
										3.1.2.b.1					
										3.1.2.b.2					

						3.1.2.c.2	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij nga vërtetimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Qumështit dhe nënprodukteve të tij prodhon të dhëna në nivel kombëtar në lidhje me prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit nga lopët. Të dhënat grumbullohen në ndërmarrjet e përpunimit të qumështit dhe baxhot, të cilat blejnë qumësht të papërpunuar direkt nga fermat ose pikat e grumbullimit, sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave.	M + 45 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave		
						3.1.2.c.3	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij nga burimi administrativ	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij të gjeneruara nga të dhënat administrative prodhon të dhëna lidhur me prodhimin dhe përdorimin në fermë të qumështit dhe produkteve të qumështit nga lopët, delet dhe dhitë.	V + 175 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		
						3.1.2.d	Statistikat Strukturore të Fermës									
						3.1.2.d.1	Censi i Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore	Çdo 10 vite	2024	Aktiviteti i Statistikave Strukturore të Fermës synon përditësimin e regjistrit statistikor të fermave dhe prodhimin e të dhënave statistikore në nivel rajonal dhe kombëtar, bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga Rregulloret e BE-së dhe Eurostat. Censi i Bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e Politikave të Përbashkëta Bujqësore. Vërtetimi i strukturës së fermës (Censi i Bujqësisë) dhe vërtetimet e ndërmjetme me kampion janë shtylla të sistemit statistikor bujqësor.	V + 450 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave		

[illegible]

3.4	Turizmi	Statistikat e Turizmit - ana e ofertës										
		3.4.1		3.4.1.1	Statistikat e Strukturave Akomoduese	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Turizmit mbi Strukturat Akomoduese prodhon treguesit e kapacitetit akomodues dhe shfrytëzimit të tyre, vizitorët dhe netë-qëndrimet, ndryshimet vjetore, etj.	M + 45 D	Rajonale	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
		3.4.2			Statistikat e Turizmit - ana e Kërkesës							
				3.4.2.1	Statistika nga Anketa e Turizmit në Familje Pushime dhe Udhëtime	Tremujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave nga Anketa e Turizmit në Familje Pushime dhe Udhëtime prodhon të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda / jashtë vendit.	V + 320 D	Qarku	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
		3.4.3			Statistikat e Lëvizjes së Shtetasve							
				3.4.3.1	Statistikat e Lëvizjes së Shtetasve	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Lëvizjes së Shtetasve paraqesin të dhëna të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë); Pikave kufitare; Qëllimit të udhëtimit të shtetasve të huaj; Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve.	M + 23 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave

[illegible]

Çmimet										
3.7	Çmimet	3.7.1	Statistikat e Çmimeve të Konsumit							
			3.7.1.1	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Çmimeve të Konsumit prodhon Indeks in e Çmimeve të Konsumit, ndryshimin mujor dhe vjetor të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, etj.	M + 8 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave
			3.7.1.2	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit prodhon Indeks in e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, ndryshimin mujor dhe vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, etj.	M + 18 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave
			3.7.1.3	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) me taksa konstante	Mujor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Çmimeve të Harmonizuata të Konsumit me taksa konstante prodhon indeks in e çmimeve të harmonizuata të konsumit me taksa konstante, ndryshimin mujor dhe vjetor të tij, etj.	M + 18 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave
		3.7.2	Indeksi i Nivelit të Çmimeve, PBB për frymë në MFB							
			3.7.2.1	Statistikat nga Vrojtimet e Matjes së Fuqisë Blerëse	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave nga Vrojtimet e Matjes së Fuqisë Blerëse prodhon të dhëna të çmimeve të konsumit brenda një cikli trevjeçar, çmimeve të ndërtimit, spitaleve, makinerive e pajisjeve dhe vrojtimit e qirave.	V + 180 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave

[illegible]

4	Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain														
		4.1	Mjedis	Llogaritë Monetare Mjedisore											
				4.1.1											
						4.1.1.1	Statistikat mbi Taksat Mjedisore sipas Industrive	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave mbi Taksat Mjedisore sipas industrive prodhon të dhëna mbi të ardhurat nga taksat mjedisore (sipas kategorisë së taksave - energjia, transporti, ndotja dhe taksat e burimeve), të ndara sipas aktivitetit ekonomik (paguesi i taksave), duke përdorur klasifikimin NVE për aktivitetet e prodhimit të zgjeruara për të mbuluar taksat e pagueshme nga familjet dhe jo-rezidentët.	V + 563 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave
									2025 2026	Nga ndërtimi i sistemit synohet prodhimi i Llogarive të Shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit (EPEA), përcaktimi i shpenzimeve kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, analiza e financimit të kombëtaresh-penzim, analiza e prodhimit tëshërbimet e mbrojtjes së mjedisit.	V + 548 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave Ministria e Financave dhe Ekonomisë
						4.1.1.3	Ndërtimi i Sistemit për Prodhimin e Modullit të Sektorit të të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore	Vjetor	2026 2026	Nga ndërtimi i sistemit synohet prodhimi i Llogarive të Sektorit të të Mirave dhe Shërbimeve Mjedisore (EGSS), ku do të përcaktohen aktivitetet ekonomike të cilat rezultojnë në produkte të lidhura me mbrojtjen mjedisore dhe menaxhimin e burimeve natyrore.	V + 548 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave	Instituti i Statistikave Ministria e Financave dhe Ekonomisë

[illegible]

						4.1.3.2	Statistikat mbi Mbetjet e Ngurta Industriale	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave mbi Mbetjet e Ngurta Industriale prodhon të dhëna mbi gjen-erimin, menaxhimin dhe tra-jtimin e mbetjeve industriale.	V + 294 D	Bashkia	Instituti i Statistikave	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Agjencia Kombëtare e Mjedisit
						4.1.4	Statistikat e ujit							
						4.1.4.1	Statistikat e Ujit	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Ujit prodhon të dhëna mbi bilancin e përgjithshëm të ujërave, të dhëna mbi ujërat e lumenjëve, të dhëna për ujërat e liqeneve, të dhëna mbi ndotjen bakte-riologjike të ujërave të deteve në plazhe, etj.	V + 299 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar Agjencia Kombëtare e Mjedisit Instituti i Gjeoshkencave Ujësjellës Kanalizime Tiranë
						4.1.5	Statistikat e Qytetit							
						4.1.5.1	Statistikat mbi Cilësinë e Ajrit, Zhurmat dhe mbi Automjetet sipas Vjetërsisë në Përdorim	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Qytetit prodhon të dhëna të përgjithshme dhe specifike mbi mjedisin si të dhënat mbi cilësinë e ajrit, ndotjen akustike, mjetet e transportit rrugor etj.	V + 299 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit

					4.1.6	Statistikat e Biodiversitetit		4.1.6.1	Statistikat e Biodiversitetit	Vjetor	2022 2023 2024 2025 2026	Aktiviteti i Statistikave të Biodiversitetit prodhon të dhëna mbi zonat e mbrojtura sipas kategorive, specieve të kërcënuara dhe të mbrojtura, për florën dhe faunën.	V + 252 D	Kombëtar	Instituti i Statistikave	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
					4.2	Informacioni statistikor rajonal dhe gjeohapësinor										
					4.2.1	Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistike										
						4.2.1.1	Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistike			I vazhdueshëm	2022 2023 2024 2025 2026	Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistike mbledh, përpunon, lizon databazën e të dhënave gjeohapësinore për të gjithë territorin e Shqipërisë. Këto të dhëna luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të Cense-ve dhe realizimit të anketave/vrojtimeve të INSTAT në funksion të objektivave vjetorë ose si shërbim për të tretët. Njëkohësisht, GIS synon përmirësimin e integritetit të të dhënave statistikore me atë gjeohapësinore në funksion të publikimeve të rezultateve dhe analizave tematike.			Instituti i Statistikave	
						4.2.1.2	Ndërtimi i Regjistrat Statistikor të Ndërtësive dhe Banesave të Shqipërisë			I vazhdueshëm	2022 2023 2024 2025 2026	Ky aktivitet lidhet me inicimin e zhvillimit të një regjistri statistikor të ndërtësive dhe banesave, duke përdorur si bazë të dhënat e Censit të ardhshëm.			Instituti i Statistikave	

					4.2.1.3	Klasifikimi statistikor i njësive territoriale	I vazh- dueshëm	2022 2023 2024 2025 2026	Ky aktivitet lidhet me zbatimin e topologjisë territoriale (TERCET), duke aplikuar metodologjitë e hartuara nga Eurostat, për të patur një klasifikim statistikor të njësive territoriale të përbashkët me vendet Evropiane, si dhe për të mundësuar mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave në nivele të ndryshme territoriale.			Instituti i Statistikave	
					4.2.2	Harmonizimi i temave "Demografia" dhe "Njësitë Statistike" sipas direktivës INSPIRE							
					4.2.2.1	Harmonizimi i temave Demografia dhe Njësitë Statistike sipas direktivës INSPIRE	I vazh- dueshëm	2022 2023 2024 2025 2026	Harmonizimi dhe transformimi i temave Demografia dhe Njësitë Statistike, në kuadër të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI), si dhe duke ndjekur rekomandimet e Direktivës INSPIRE			Instituti i Statistikave	Autoriteti i Sigurimit të Informacionit Gjeohapësinor Institucionet për ndërtimin e Regjistrimit Statistikor të Ndërrësive dhe Banesave të Shqipërisë.

Explanation:

- * The activity does not have a fixed periodicity.
- ** The activity generates indicators with different periodicities.
- *** The activity is a continuous process from the beginning to the end of the Program.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

The Official Statistics Program 2022–2026 ; Albania

INSTAT ; drejt. bot. Elsa Dhuli. - Tiranë :
INSTAT, 2023

... f. : me il. ; ... cm.

ISBN

1.Statistika 2.Shqipëri



PROGRAMI I STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026